



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE
KRIMIN E ORGANIZUAR

NR. 97 AKTI

NR. 48 VENDIMI

V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
me trup gjykues të përbërë prej:

GJYQTAR: ERJON BANI

Me pjesëmarrjen e sekretares gjyqësore **Enkeleda Luga**, në Tiranë, sot më datë 16.09.2022, pasi mori në shqyrtimin në seancë gjyqësore, çështjen penale me Nr. 97 Akti, me palë:

KËRKUES:

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokuroria **Enkeleda Millonai**.

E PANDEHUR:

Etleđa Çiftja, e bija e Rustem dhe e Suzana, e datëlindjes 17.02.1976, lindur në Kryevidh, Durrës dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga "{***}", përballë {***}, Kompleksi {***}, Kulla {***}, Ap. {***}, me shtetësi shqiptare, gjendja gjyqësore "*E padënuar*", gjendja civile "*E martuar*", me arsim të lartë, hetuar dhe gjykuar në gjendje të lirë, mbrojtur nga **Av.Ermal Yzeiraj**, me Nr. 10407 Liçense dhe NIPT N01411034T dhe **Av.Artemida Hoxhaj** me Nr. 10975 Liçense anëtarë të Dhomës së Avokatis Tiranë.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprave penale "*Falsifikim i dokumentave*", në formën e përdorimit, dhe "*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë*", parashikuar nga nenet 186/1 dhe 257/a/2 i Kodit Penal.

Në përfundim të gjykimit zhvilluar në prani të **prokurores Enkelda Millonai, në prani të të pandehurës Etleda Çiftja**, si dhe në prani mbrojtësve të saj, **Av.Ermal Yzeiraj dhe Av.Artemida Hoxhaj**, Gjykata, pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes dhe çmoi dhe vlerësoi në tërësi provat e marra në seancë gjyqësore nënshtruar rregullave të gjykimit të shkurtuar dhe dëgjoi në fazën e konkluzioneve përfundimtare palët, në të cilën u kërkua:

Prokuroria: 1. Deklarimin fajtores të të pandehurës **Etleda Çiftja**, për kryerjen e veprës penale të "*Falsifikimi të dokumentave*", parashikuar nga neni 186 paragrafi i parë i Kodit Penal, duke e denuar me **1 (një) vit burgim**. **2.** Deklarimin fajtores të të pandehurës **Etleda Çiftja**, për kryerjen e veprës penale të "*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim*", parashikuar nga neni 257 /a paragrafi i dytë i Kodit Penal, duke e denuar me **1 (një) vite 6 (gjashtë) muaj burgim**. **3.** Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, bashkimin e dënimeve në një dënim të vetëm prej **1 (një) vite 6 (gjashtë) muaj burgim**. **4.** Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, t'i zbritet 1/3 nga masa e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **1 (një) vit burgim**. **5.** Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë për një afat prej 2 (dy) vitesh, me kushtin që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprën tjetër penale dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës. **6.** Në zbatim të nenit 391 të K.Pr.Penale të deklarohet falsiteti i kontratës së shitblerjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006 (*data 10 e korrigjuar*) për shitblerjen e pasurisë me nr. {***} ZK {***}, sip prej 3440 m2. **7. Në bazë të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale dhe 36 të Kodit Penal, në lidhje me provat, si më poshtë vijon: T'i kthehen noteres Luljeta Kongoli: 1)** Kontratë Huaje nr. Rep {***} Nr. Kol {***} datë 29.09.2006 lidhur ndërmjet Bankës Emporiki dhe shtetasve Etleda dhe D.Ç; **2)** Kontratë Hipotekimi Nr. {***} Rep., Nr. {***} Kol., datë 28.09.2006 në gjuhën angleze dhe shqip; **3)** Deklaratë Nr. {***} Rep., datë 29.09.2006; **4)** Deklaratë Nr. *** Rep., datë 29.09.2006; **5)** Kontratë Shitblerje Nr. {***} Rep., Nr. {***} Kol., datë 06.07.2006; **6)** Kartelë pasurie për pasurinë me Nr. {***} datë lëshimi 10.07.2006; **7)** Çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 21.06.2006, hartë treguese e regjistrimit, vërtetim datë 29.06.2006 lëshuar nga Komuna Kryevidh; **8)** Çertifikatë familjare e shtetasit Rustem Kaja datë 29.06.2006; fotokopje të pasaportave të shtetasve Rustem dhe Suzana Kaja; **9)** Kontratë Shitblerje Nr. {***} Rep., Nr. {***} Kol., datë 06.07.2006; **10)** Kartelë pasurie për pasurinë me nr. {***} datë lëshimi 10.07.2006; **11)** Çertifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë me nr. {***} datë lëshimi 21.06.2006, hartë treguese e regjistrimit, vërtetim i Komunës Kryevidh datë 29.06.2006, çertifikatë përbërje familjare e shtetasit Rustem Kaja datë lëshimi 29.06.2006, fotokopje të pasaportave të shtetasve Rustem dhe Suzana Kaja. **Të kthehen pranë ASHK, Tirana Veri, Arkiva vendore: 1.** Kontratë shitblerje nr. 15214/94, dy fletë; **2)** Planimetri bodrumi dhe apartamenti, dy fletë; **3)** Plan vendosje; **4)** Kontratë për privatizimin e banesës datë 15.09.1993; **5)** Çertifikatë përbërje familjare datë lëshimi 11.06.1993; **6)** Treguesit kryesorë për apartamentin, formulari nr. 2 datë 15.09.1993; **7)** Treguesit tekniko

ekonomikë të banesës formulari nr. 1, Inventari i brendshëm i dosjes me ref {***} ZK {***} nr. pasurie 3/103+1-6 vol 2 faqa 18.19; **8)** Kartelë e pasurisë së paluajtshme kodin unik 8370002019, çertifikatë regjistrimi datë lëshimi 10.11.2021, dy copë; **9)** Kartelë pasurie kodin unik 8370002018; **10)** Kërkesë nr. 65846; **11)** Shkresë datë 16.09.2021; **12)** Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore Nr. Rep {***}, Nr. Kol {***}, datë 04.08.2021; **13)** Çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 23.07.2001, dy copë; **14)** Shkresë kthim përgjigje për shtetasen F.Ç; **15)** Kërkesë nr. 56827; **16)** Kartelë e pasurisë së paluajtshme kodin unik 8370002018; **17)** Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore Nr. {***} Rep., Nr. {***} Kol., datë 04.08.2021; **18)** Çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 21.07.2001; **19)** Shkresë për shtetasen Fatmire Çiftja; **20)** Kërkesë nr. 48304; **21)** Vendim Nr. {***} Rep., Nr. {***} Kol., datë 04.08.2021; **22)** Çertifikatë për vërtetim pomësie datë lëshimi 23.07.2001; **23)** Mandat pagese ref 29363853. **Të kthehen pranë ASHK, Tirana Veri:** **1)** Inventari i brendshëm i dosjes, ref {***} ZK {****} nr pasurie 1/312+ 1-43; **2)** Kartela e pasurisë; **3)** Kërkesë nr. 118444; **4)** Kontratë shitblerje Nr. {***} Rep., Nr. {***} Kol., datë 30.11.2016; **5)** Çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 21.04.2010; **6)** Aplikim i noteres One stop shop; **7)** Kartela e pasurisë së paluajtshme; **8)** Kontratë Sipërmarrje Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 08.09.2006, planimetri; **9)** Fotokopje pasaporte e shtetasve D. dhe Etlea Çiftja, ekstrakt i regjistrimit tregtar të shoqërisë {***} sh.p.k. **Të kthehen pranë ASHK, Dega Kavajë:** **1)** Inventari i brendshëm i dosjes nr ref 0000099; **2)** Aplikim datë 31.07.2006; **3)** Kontratë shitblerje Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006; **4)** Kartelë pasurie për pasurinë me nr. {***} datë lëshimi 10.07.2006; **5)** Çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 21.06.2006, hartë treguese e regjistrimit, vërtetim datë 29.06.2006 lëshuar nga Komuna Kryevidh; **6)** Çertifikatë familjare e shtetasit R.K datë 29.06.2006; **7)** Hartë treguese e regjistrimit; **8)** Inventari i brendshëm i dosjes ref 0000194; **9)** Aplikim datë 31.07.2006; **10)** Kontratë Shitblerje Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006; **11)** Kartelë pasurie për pasurinë me nr. {***} datë lëshimi 10.07.2006; **12)** Çertifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë me nr. {***} datë lëshimi 21.06.2006, hartë treguese e regjistrimit, vërtetim i Komunës Kryevidh datë 29.06.2006, çertifikatë përbërje familjare e shtetasit R.K datë lëshimi 29.06.2006, hartë treguese e regjistrimit. **Të kthehen pranë Bankës Amerikane të Investimeve:** **1)** Aplikim deklarate për kredi hipotekare; **2)** Çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 23.07.2001 bashkë me kartelën e pasurisë për pasurinë me nr. {***}; **3)** Kontratë Shitblerje Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006 pasi të bëhet shënimi si pjesë e pandarë e kontratës e deklarimit të falsifiketit të kësaj kontrate; **4)** Çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 21.06.2006, hartë treguese e regjistrimit; kartelë pasurie, çertifikatë e përbërjes familjare, çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 15.09.2006; kartelë pasurie; **5)** Kontratë Shitblerje Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006, çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 21.06.2006; kartelë pasurie; hartë treguese regjistrimi, vërtetim datë 29.06.2006, çertifikatë e përbërjes familjare; **6)** Vërtetim datë 12.06.2006 e Gardës së Republikës; **7)** Vërtetim i muajit korrik 2006 i shoqërisë {***}; **8)** Vërtetim i muajit qershor 2006 i shoqërisë {***}; **9)** Referencë e shoqërisë {***} e muajit shtator 2006;

10) Kontratë individuale e punës Nr. {***} Prot., datë 01.03.2001; 11) Vërtetim Nr. {***} Rep., datë 06.06.2006; 12) Çertifikata NIPT për shoqërinë {***}; çertifikatë për regjistrim në organin tatimor; vërtetim nr. {***} rep datë 06.06.2006; 13) Vendim i gjyqtarit të vetëm nr. {***} datë 31.10.2000; 14) Vërtetim i njësisë me origjinalin Nr. {***} Rep., datë 06.06.2006; 15) Liçencë e subjektit {***}; 16) Vërtetim i njësisë me origjinalin Nr. {***} Rep., datë 24.05.2006; 17) Kontratë hipotekimi Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 28.09.2006; 18) Çertifikatë për vërtetim pornësie datë lëshimi 15.09.2006, kartelë pasurie nr. {***}, hartë treguese regjistrimi; 19) Çertifikatë për vërtetim hipotekimi; 20) Kartelë pasurie e paluajtshme; 21) Kontratë Huaje Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 29.09.2006; 22) Deklaratë Nr. {***} Rep., datë 29.09.2006; Nr. {***} Rep., datë 29.09.2006; 23) Kalendari i detyrimeve, 4 fletë; 24) Njoftim për tërheqjen e huasë; 25) Njoftim për shlyerje pjesore të kredisë; 26) Dokument sigal; 27) Policë sigurimi jete; formulari i miratimit të kredisë., urdhër kalimi, mandat pagese, customer position, account details dy fletë; transferim fondesh i brendshëm, Jurnal Multi Offset Input 4 fletë; 28) Policë sigurimi datë 29.09.2006; 29) Urdhër kalimi, mandat pagese; 30) Policë sigurimi datë 29.09.2006 dy fletë; 31) Customer Position, urdhër kalimi, mandat pagese, urdhër kalimi, mandat pagese; 32) Policë sigurimi datë 29.09.2006 dy fletë, urdhër kalimi, mandat pagese; 33) Policë sigurimi tre fletë; 34) Formular i miratimit të kredisë; 35) Account Details; 36) Transferim fondesh; 37) Journal Multi Offset Input; 38) Account Details dy fletë; 39) Transferim fondesh; Jpurnal Multi Offset, transferim fondesh, Jorunal "Multi Offset; nr llogarie; 40) Policë sigurimi tre fletë, nr llogarie, Journal Multi Offset, dy fletë; nr llogarie; 41) Deklaratë noteriale Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 28.04.2020; 42) Njoftim për shyerje totale të parakohshme kredie. *Të kthehet pranë ASHK Dega Kavajë:* 1) Akt i marrjes së tokës në pronësi Nr. {***} datë 15.09.1995. 7. Shpenzimet proceduriale të kryera në hetim paraprak si dhe ato të kryera gjatë gjykimit, t'i ngarkohen solidarisht te pandehurëve.

Mbrojtësi i të pandehurës: Marrjen nga Gjykata të vendimit për pafajësinë e të pandehurës Etleda Çiftja, si pasojë e ekzistencës së njëkohshme të disa prej rasteve të parashikuara në nenin 388, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale.

E pandehura: Dakord me avokatin. Kërkojë deklarinimin e pafajshëm.

VËREN:

I. Procedura.

1. Se, pranë Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është paraqitur kërkesa me Nr. 97 Akti, me objekt: Dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal me Nr. 202, datë 13.07.2021, në ngarkim të të pandehurës **Etleda Çiftja**, e cila akuzohet për kryerjen e veprave penale "*Falsifikim i dokumentave*", në formën e përdorimit, dhe "*Refuzimi për deklarinimin, mosdeklarimi,*

fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, parashikuar nga nenet 186/1 dhe 257/a/2 i Kodit Penal.

2. Më datë 04.07.2022 trupi gjykues i çështjes objekt gjykimi paraqiti pranë Kryetares në detyrë të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kërkesën për heqje dorë nga gjykimi i kësaj çështje. Kjo për faktin pasi e pandehura Etleda Çiftja ka qenë anëtare e trupës gjykuese në procesin e rivlerësimit kalimtar ndaj trupit gjykues të kësaj çështje, duke disponuar me vendimin Nr. 402, datë 24.05.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka marrë formë të prerë më datë 08.07.2021. Në kërkesën për heqje dorë, trupi gjykues, ka theksuar se marrëdhëniet me të pandehurën Etleda Çiftja kanë qenë dhe janë indiferente. Pra, në aspektin e **testit subjektiv** të paanshmërisë në kërkesën e dorëheqjes është theksuar se: “...vlerësoj me ndërgjegje se, unë nuk kam asnjë llojë pëgese për dhënien e një vendimi të drejtë, pasi nuk kam asnjë interes personal në këtë çështje, përveç dhënies së drejtësisë që është detyra ime funksionale.”. Ndërkohë përsa i përket **testit objektiv** është theksuar se: “Ndërsa përsa i përket testit objektiv të paanshmërisë kjo nuk varet nga ndërgjegjja e gjyqtarit, por nga përceptimi që kanë palët në proces mbi paanësinë e gjyqtarit. Edhe pse me ndërgjegje vlerësoj se, gjatë punës time si gjyqtar i trajtoj palët me barazi dhe paanshmëri, vlerësoj se në rastin konkret për mua si gjyqtar është shumë e rëndësishme që vendimarrja ime në përfundim të gjykimit të mos paragjykohet si e njëanshme, por të vijë si rezultat i një procesi ku përceptimi i palëve në proces mbi paanësinë e gjyqtarit të mos vihet në dyshim, pasi në të kundërt në cilësinë e gjyqtarit nuk do të kontribuojë në rritjen e besimit të publikut në dhënien e drejtësisë për palët në gjykim, sepse drejtësia jo vetëm që duhet të bëhet por edhe duhet të duket si e tillë.”. Ndodhur në këto kushte, në bazë dhe për zbatim të nenit 17 të K.Pr.Penale, i është kërkuar Kryetares së Gjykatës pranimit i kërkesës për përjashtim nga çështja penale në ngarkim të të pandehurës Etleda Çiftja, pasi mund të vihet në dyshim “paanësia në dukje”.

2.1. Me vendimin Nr. {***} Prot., datë 13.07.2022 “Mbi kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes” Kryetarja e Gjykatës vendosi: “1. Refuzimin e kërkesës se gjyqtarit Erjon Bani, për heqje dorë nga gjykimi i kërkesës penale nr. 97 Akti, datë 30.06.2022, me të pandehur Etleda Çiftja, akuzuar për kryerjen e veprave penale “Falsifikim i dokumenteve” dhe “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, parashikuar nga nenet 186 dhe 257/a/2 të Kodit Penal, me objekt: Dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal me Nr. 202 të vitit 2021, në ngarkim të të pandehurës Etleda Çiftja akuzuar për kryerjen e veprave penale “Falsifikim i dokumenteve” dhe “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, parashikuar nga nenet 186 dhe 257/a/2 të Kodit Penal. 2. Njoftimin e gjyqtarit Erjon Bani, për refuzimin e dorëheqjes.”. Në arsyetimin e vendimit të Kryetarit të Gjykatës, ndër të tjera arsyetohet se: “Arsyeja e referuar nga gjyqtari, për ndodhjen e tij përballë situatës së “paanësisë në dukje”, për shkak të rrethanës së sipërcituar, çmohet se nuk përlligj dhe nuk përbën shkak për heqjen dorë të gjyqtarit nga gjykimi i kërkesës penale, si dhe nuk përbën pengesë

ligjore për gjykimin me objektivitet dhe paanësi të kësaj kërkesë nga gjyqtari. Procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarit Erjon Bani, është një proces tashmë i përfunduar, me vendim të formës së prerë, ndaj në këto rrethana çmohet se lidhur me gjykimin e kësaj çështje në fjalë, gjyqtari Erjon Bani nuk ka konflikt interesi, ndërmjet ushtrimit të detyrave të tij funksionale të përcaktuara me ligj dhe interesave private të tij, të cilat nuk janë prezente në rastin konkret dhe që mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të këtyre detyrave. Për sa më sipër shkak i paraqitur nga gjyqtari i dorëhequr nuk përbën shkak për papajtueshmëri me funksionin e gjyqtarit në gjykim, sipas nenit 17 të K.Pr.Penale, për të cilin gjyqtari është i detyruar të heqë dorë.”.

2.2. Në seancën gjyqësore të datës 15.07.2022, trupi gjykues bëri me dije kërkesën për heqje dorë, motive e saj si dhe për vendimin e marrë nga Kryetarja e Gjykatës. Ndodhur në këto kushte, prokuroria e çështjes kërkoi përjashtimin e trupit gjykues pasi sipas saj çënohet “paanësia në dukje”. Kjo kërkesë u shqyrtua nga një tjetër trup gjykues, ku me vendimin Nr. {***}, datë 17.07.2020 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vendosi: **“1. Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, me nr. regj. them. 315, datë regjistrimi 15.07.2022, me objekt "Përjashtimi i gjyqtarit Erjon Bani, nga shqyrtimi në seancë paraprake të kërkesës për dërgimin e çështjes për gjykim të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë, në lidhje me procedimin penal nr. 202 të vitit 2021 në ngarkim të të pandehurës Etleda Çiftja, konkretisht çështje gjyqësore me nr. 97 akti e vitit 2022", si të pabazuar në ligj dhe në prova. 2. Një kopje e vendimit t'i komunikohet gjyqtarit Erjon Bani, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe të pandehurës Etleda Çiftja. 3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi së bashku me vendimin përfundimtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. U shpall në Tiranë, sot më datë 17.07.2022, ora 09.10”.**

2.2.1. Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi lidhur me shkaqet e përjashtimit ndër të tjera arsyetohet se: [...]

18. Referuar praktikës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, kjo gjykatë ka arsyetuar në shumë raste paanshmërinë e gjyqtarit në drejtim të anës objektive (pra paanshmërisë në dukje të gjyqtarit) dhe në kuptim të kësaj përqasje, paanshmërinë në dukje mund ta kategorizojmë në dy drejtime, në paanshmërinë funksionale dhe atë personale.

18.1. Paanshmëria funksionale. Kjo lloj paanshmërie ka të bëjë me përbërjen e gjykatës dhe me funksionet që ushtron një gjyqtar. Paanshmëria funksionale ka të bëjë me ekzistencën e atyre rrethanave, kur gjyqtari që ushtron në të njëjtën kohë funksion si gjyqtar, ushtron edhe funksione të tjera ekstra-gjyqësore ose ato raste kur gjyqtari ushtron funksione të ndryshme në të njëjtin procedim ose në procedime të lidhura¹

¹ Si p.sh., në çështjen Meznaric k. Slovenisë, në vitin 2005, kur një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese po gjykonte një çështje, kur në fazat më të hershme të procesit kishte qenë avokat i palës kundërshtare.

18.2. Paanshmëria personale. Kjo lloj paanshmërie ka të bëjë me sjelljet personale të një gjyqtari, për shembull me deklaratat që gjyqtari bën gjatë kohës që procesi gjyqësor është ende në gjykim, vërejtjet lidhur me median, ose lidhje të tjera personale që gjyqtari mund të kenë në një çështje, ose me palët në një proces gjyqësor. Kjo kërkon analizë të fakteve nëse gjyqtari shfaq ndonjë paragjykim personal ndaj ose kundër një pale në proces. Këtu mund të përfshihen: sjella në një proces nëpërmjet gjuhës apo vërejtjeve të përdorura nga ana e gjyqtarit; deklaratimet publike lidhur me çështjen; interesat personale në një çështje/lidhja me palët/miqësia/armiqësia. Lidhjet profesionale, financiare ose personale midis një gjyqtari dhe një pale në proces, ose edhe me avokatin e njëres palë në proces, edhe këto janë rrethana që mund të ngrenë pikëpyetje lidhur me paanshmërinë e gjyqtarit në një gjykim, megjithatë kjo do të varet nga rrethanat e çështjes dhe natyra e lidhjes në fjalë,² duke u vlerësuar rast pas rasti.

19. Të gjitha këto rrethana, si ato që lidhen me paanshmërinë funksionale të gjyqtarit dhe ato që lidhen me paanshmërinë personale, janë parashikuar nga legjislacioni ynë procedural penal në nenet 15, 16 dhe 17 të K.Pr.Penale, sikurse është cituar në pikën 10 të këtij vendimi.

20. Çështja në fjalë ka të bëjë pikërisht me vënien në diskutim të paanshmërisë së gjyqtarit për shkak se e pandehura në këtë rast, çështjen e së cilës ka për gjykim gjyqtari Erjon Bani në cilësinë e gjyqtarit të seancës paraprake, më herët ka qenë anëtare e trupës së KPK-së që ka konfirmuar atë në detyrë (në unanimitet) në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë. Në vlerësim të kërkuarit, Prokurorisë së Posaçme, gjyqtari Erjon Bani duke qenë gjyqtar i çështjes në fjalë cenon parimin e gjykimit nga një gjyqtar i paanshëm, për shkak se në dukje ai nuk mund të jetë i paanshëm, përse kohë e pandehura e ka "gjykuar" atë më parë lidhur me tre kriteret e vlerësimit, përfshirë edhe atë të pasurisë, sikurse sot është sjellë për gjykim vetë e pandehura Etleda Çiftja lidhur me deklaratimet e bëra nga vetë ajo në ILDKPKI.

21. Në vlerësim të Gjykatës, shkak i referuar nga ana e kërkuarit, duke pretenduar se në këtë rast gjyqtari Erjon Bani nuk garanton paanshmërinë në dukje të gjyqtarit për shkak se ka një konflikt interesi në dukje për gjyqtarin, nuk gjendet i bazuar nga ana e Gjykatës, pasi nuk është i tillë që të kualifikohet në rrethana të rëndësishme njëanshmërie, referuar gjërmës "ë" të nenit 17 të K.Pr.Penale.

22. Rezulton e provuar se, procesi i rivlerësimit kalimtar ndaj gjyqtarit Erjon Bani, është finalizuar me vendimin nr. 390 vendimi, datë 24.5.2021 të KPK-së, i

² Çështja Pescador Valero k. Spanjës, viti 20030-gjyqtari ishte në të njëjtën kohë profesor në universitet dhe ishte duke gjykuar një çështje kundër universitetit; Çështja Micallafk. Maltës, 2009-lidhje të afërta familjare midis avokatit të palës kundërshtarë dhe Kryetarit të Gjykatës (nip e dajë); Çështja Buscemi k. Italisë, viti 1999-Drejtuesi i Gjykatës së të Rinjve, në një artikull. përdori shprehje të cilat krijojnë dyshimin se ai kishte krijuar tashmë një qëndrim jo në favor të çështjes së kërkuarit; Çështja Olujic k. Kroacisë, viti 2009-anëtarët e Këshillit përdorën terma përcjues, në një intervistë për shtypin, lidhur me një gjyqtar, për të cilin do të vendosnin në një procedurë disiplinore.

cili është bërë përfundimtar më datë 07.07.2021, pa iu nënshtruar ankimit nga ana e Institucionit të Komisionerit Publik. Ky vendim rezulton të jetë marrë në unanimitet nga ana e trupës së komisionerëve të KPK-së.

23. Në këto rrethana, Gjykata çmon se gjyqtari Erjon Bani nuk gjendet në konflikt interesi për të gjykuar çështjen në fjalë, pasi ai nuk ka asnjë interes personal ndaj të pandehurës Etleda Çiftja në këtë gjykim, përse kohë e pandehura ka kryer një detyrë kushtetuese ndaj tij në kohën kur e ka pas një detyrim të tillë. Gjyqtari në fjalë i është nënshtruar procesit të rivlerësimi kalimtar në respektim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore e tashmë për të ka një vendim përfundimtar i cili nuk mund të vihet në diskutim, **vendim që është bërë përfundimtar rreth 1 (një) vit më parë**. Në vlerësim të Gjykatës, të pranosh një shkak të tillë si përjashtim për gjyqtarin sikurse shkakun që parashtron Prokuroria e Posaçme, minon pikërisht shtetin e së drejtës dhe perceptimin e besimit të njerëzve tek drejtësia, e mbi të gjitha edhe tek reforma në drejtësi, nëpërmjet procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve. Secila nga palët, në ushtrim të funksionit që ka, duhet të respektojnë Kushtetutën dhe ligjin. Ushtrimi i funksionit bëhet marrë në konsideratë faktin se secili mban përgjegjësi personale para ligjit dhe të gjithë janë të barabartë para ligjit. Pra, ushtrimi i funksionit dhe i detyrave të ngarkuara nga ligji në një moment të caktuar nga ana e një subjekti, pale apo e gjyqtarit, nuk vlerësohet nga kjo Gjykatë si një rrethanë që ngre pikëpyetje lidhur me paanshmërinë e palëve në një proces, pa u lidhur dhe pa u shoqëruar me ndonjë rrethanë apo sjellje tjetër të evidentuar ose të dyshimtë. Përse kohë, shkakun në fjalë nuk është personal, aktual dhe as i tillë për nga rëndësia që të vendosë në dyshim objektivitetin e paanshmërinë e gjyqtarit Erjon Bani, kërkesa për përjashtime paraqitur ndaj tij rrëzohet nga Gjykata si e pabazuar në ligj e në prova. [...]

3. Në seancën gjyqësore të datës **25.07.2022**, Gjykata pasi çeli seancën, pyeti të pandehurën lidhur me procedurën e gjykimit, e cila deklaroi se kërkon të procedohet me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në kërkesën me shkrim të depozituar për gjykim të shkurtuar theksohet se: *“Në referencë të të drejtave të procedurale të znj. Etleda Çiftja, si e pandehur në një proces penal, të përcaktuara këto në nenin 332/c, pika 3; nenin 403; dhe nenin 405, të Kodit të Procedurës Penale, paraqesim para Gjykatës, kërkesën tonë për gjykim të shkurtuar të çështjes penale nr. 202, të vitit 2021, të sjellë për gjykim nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsioni dhe Krimin të Organizuar, mbështetet në arsyet si më poshtë: **Së pari**, te zgjatja në kohë e fazës së hetimeve penale që ka zhvilluar organi i akuzës, ka shkakuar dhe ende po shkakton një sërë pasoja të dëmshme jo vetëm në aspektin personal dhe familjar për znj. Çiftja dhe familjarët e saj, por edhe në veprimtarinë normale të procesit të vettingut në institucionin ku ajo punojti Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, duke sjellë në këtë institucion një situatë aspak normale, ku për shkak të statusit të znj. Çiftja si e pandehur, subjekte të ndryshme të rivlerësimit (disa prej të cilëve vetërikthehen nga kërkesa e tyre e mëparshme për dorëheqje) pretendojnë*

përrjashtimin e saj nga trupa gjykuese me arsytimin e ekzistencës së kushteve të konfliktit në dukje të interesit. Për rrjedhojë, shtyrja akoma dhe më shumë e seancave të këtij procesi pengon seriozisht veprimtarinë normale institucionale të KPK-së dhe të procesit të vettingut që zhvillohet në të. **Së dyti**, në lidhje me zbardhjen sa më parë të kësaj çështje, dukshëm ka një interes të veçantë të faktorit ndërkombëtar (që monitoron ecurinë e zbatimit të reformës në drejtësi dhe procesin e vettingut në veçanti), si dhe të opinionit të gjerë publik dhe medias në përgjithësi. Nisur nga këto fakte dhe arsye, shprehim ndaj Gjykatës (por edhe ndaj organit të akuzës) qëndrimin/kërkesën tonë si palë, për përshpejtimin sa më shumë të këtij procesi gjyqësor (përmes pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar), i cili sa më parë duhet të ndajë përfundimisht faktin nëse nga ana e znj.Çiftja, janë konsumuar apo jo elementët e figurës së veprave penale për të cilat ajo akuzohet nga organi i akuzës. Në lidhje me provat/aktet e paraqitura nga organi i akuzës, nuk mendojmë që ka nevojë për marrjen e provave të reja dhe gjykimi mund të vazhdojë në gjendjen që janë provat/aktet.”.

3.1. Në shqyrtimin e kërkesës të bërë nga e pandehura Etleda Çiftja, Gjykata mban parasysh faktin se, me Ligjin Nr. 41/2021 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7905, datë 21.3.1995, “KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”,³ janë bërë ndryshime lidhur me disponimet e gjyqtarit të seancës paraprake. Kështu, me ndryshimet që janë bërë neni 332/dh i K.Pr.Penale nën titullin “**Vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake**” parashikohet se: “1. Pasi dëgjon diskutimet e palëve, gjykata vendos: a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq, kur çmon se ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës; b) vijimin e gjykimit nga e njëjta gjykatë kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit; c) të ftojë palët të paraqesin diskutimet përfundimtare kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi. Palët kanë të drejtë të kërkojnë një afat për t’u përgatitur, jo më të gjatë se 15 ditë. Kur i pandehuri akuzohet për kryerjen e një veprë penale për të cilën parashikohet dënim me burgim në maksimum mbi 10 vjet, gjykata cakton datën e seancës dhe njofton kryetarin për të kryer plotësimin e trupit gjykues sipas ligjit; ç) pushimin e akuzës ose të çështjes kur janë rastet e paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kodi; d) deklarimin e moskompetencës dhe dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente në rastet e parashikuara në ligj. 2. Vendimi depozitohet në sekretari brenda 10 ditëve nga shpallja e tij. Palët kanë të drejtë të marrin kopje të tij. 3. Procedura e shqyrtimit në seancë paraprake nuk zëvendëson gjykimin e çështjes në themel dhe as paragjykon vendimin përfundimtar të saj.”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se nëse paraqitet nga i pandehuri kërkesë për të procedura me gjykim të shkurtuar, gjyqtari i seancës paraprake mund të disponon në këto mënyra: **Së pari**, nëse hetimet janë të plotë dhe çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet pranon kërkesën për gjykim të

³ Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 71, datë 14 maj 2021. Ky ligj ka hyrë në fuqi më datë 29.05.2021.

shkurtuar sipas nenit 405 pika 6 të K.Pr.Penale.⁴ **Së dyti**, nëse hetimet nuk janë të plota lidhur me akuzën për të cilën kërkohet dërgimi në gjykim, gjyqtari i seancës paraprake duhet të disponoj me plotësimin e hetimeve në respektim të nenit 332/ç të K.Pr.Penale. Nëse pas plotësimit të hetimeve, përsëri i pandehuri kërkon që të procedohet me gjykim të shkurtuar për një vepër penale për të cilën nuk parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm, gjyqtari vendos të pranoj kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe fton palët në diskutimet përfundimtare.

3.1. Gjykata çmon se, nëse kërkohet gjykim i shkurtuar dhe plotësohen kushtet ligjore për pranimin e saj, gjyqtari i seancës paraprake nuk merr vendim për dërgimin e çështjes për gjykim. Në këtë rast, gjyqtari i seancës paraprake shndërohet në gjyqtar themeli dhe ushtron të gjitha kompetencat e tij. Pra, për këtë vendimarrje nuk mund të konsiderohet më gjyqtar i seancës paraprake. Në këtë përfundim arrihet duke iu referuar nenit 406 të K.Pr.Penale, nën titullin “**Vendimi**” ku parashikohet shprehimisht se: “1. Kur jep vendim dënimi gjykata e ul dënimin me burgim ose gjobë me një të tretën. 2. Shfuqizohet. 3. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëjnë ankim prokurori dhe i pandehuri. 4. **Respektohet për aq sa janë të pajtueshme dispozitat e kreut III të këtij titulli.**”. Pra, nëse pranohet kërkesa për gjykim të shkurtuar, gjykata në marrjen e vendimit përfundimtar nuk mbështetet në Kreun “PËRFUNDIMI I HETIMEVE”, ku bën pjesë dhe seanca paraprake, por mbështetet në Kreun III “VENDIMI”, nenet 379-399 të K.Pr.Penale, që bën fjalë për marrjen e vendimit nga gjyqtari i themelit. Mbështetur në nenet 387⁵ nën titullin “**Vendimi i pushimit të çështjes**”, 388⁶ nën titullin “**Vendimi i pafajësisë**” dhe 390⁷ “**Dënimi i të pandehurit**” gjyqtari i themelit mund të marri vetëm tre vendime **për akuzën që ka ngritur prokuroria** në ngarkim të të pandehurit/ve, të cilat janë: **i)** pushimi i çështjes vetëm në rastet specifike të parashikuara nga neni 387 i K.Pr.Penale; **ii)** vendim pafajësie dhe **iii)** vendim dënimi. Pra, kur kalohet në diskutimet

⁴ Në nenin 405 të K.Pr.Penale, nën titullin “**Seanca e gjykimit të shkurtuar**” parashikohet shprehimisht: “6. Pasi dëgjon parashkrimin e prokurorit, në të njëjtën seancë gjykata vendos pranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar kur çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Në të kundërtën refuzon kërkesën dhe vazhdon me gjykim të zakonshëm. Kundër vendimit lejohet ankim sëbashku me vendimin përfundimtar.

⁵ Në nenin 387 të K.Pr.Penale parashikohet shprehimisht se: “1. Kur ndjekja penale nuk duhet të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë, sipas rasteve të parashikuara në shkronjat “c”, “ç”, “e” dhe “ë”, të paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kodi, ose kur vepra penale është shuar dhe i pandehuri nuk pretendon pafajësi, gjykata vendos pushimin e çështjes, duke treguar edhe shkakun. 2. Shfuqizohet.”

⁶ Në nenin 388 të K.Pr.Penale parashikohet shprehimisht se: “1. Gjykata merr vendim pafajësie kur: a) fakti nuk ekziston ose nuk provohet se ekziston; b) fakti nuk përbën vepër penale; c) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; ç) vepra penale është kryer nga një person që nuk mund të akuzohet ose të dënohet; d) nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën që akuzohet; e) fakti është kryer në prani të një shkakut të përligjur ose të një shkakut padënueshmërie, si dhe kur ekziston dyshimi për qënien e tyre.”

⁷ Në nenin 390 të K.Pr.Penale parashikohet shprehimisht se: “1. Kur fajësia e të pandehurit provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, gjykata jep vendim dënimi, duke caktuar llojin dhe masën e dënimit. 2. Gjykata nuk mund të bazojë vendimin e fajësisë vetëm mbi deklaratimet e bëra nga personi, i cili, me vullnetin e tij, nuk ka pranuar të pyetet nga i pandehuri ose nga mbrojtësi i tij në asnjërën nga fazat e procedimit. 3. Gjykata nuk mund të bazojë vendimin e fajësisë vetëm ose kryesisht në deklaratimet e bashkëtëpandehurit, apo dëshmitë e marra nëpërmjet teknikave të veçanta për fshehjen e identitetit të dëshmitarit, sipas nenit 361/b të këtij Kodi. 4. Kur i pandehuri ka kryer disa vepra penale, gjykata cakton dënimin për secilën prej tyre dhe zbaton normat mbi bashkimin e veprave penale dhe të dënimeve.”

përfundimtare gjyqtari nuk mund të shqyrtojë kërkesa të tjera si kërkesa për pushim të çështjes ose akuzës për të njëjtin të pandehur, pasi gjyqtari i themelit mund të marri vetëm vendim sipas nenit 387, 388 dhe 390 të K.Pr.Penale, për rrjedhojë në kuptim të nenit 406 pika 4 të K.Pr.Penale nuk mund të disponoj sipas nenit 332/dh gërma “a” dhe “ç” të K.Pr.Penale.

3.2. Gjithashtu, në nenin 403 të K.Pr.Penale nën titullin “**Kërkesa për gjykimin e shkurtuar**” parashikohet shprehimisht se: “**1. Kërkesa për gjykimin e shkurtuar paraqitet nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij me autorizim të posaçëm në seancën paraprake ose në seancë gjyqësore kur procedohet sipas nenit 400 dhe paragrafit 3, të nenit 406/ç, të këtij Kodi, me pasojë mospranimi.** 2. Nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm.”, ndërsa në nenin 405 pika 5, 6, 7 dhe 8 të K.Pr.Penale nën titullin “**Seanca e gjykimit të shkurtuar**” parashikohet shprehimisht se: “**5. Pasi dëgjon palët mbi kërkesat paraprake, gjykata lexon kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe pyet të pandehurin nëse i qëndron asaj. Kur i pandehuri deklaron se i qëndron kërkesës, gjykata deklaron të hapur shqyrtimin gjyqësor dhe i jep fjalën prokurorit që në mënyrë të përmbledhur të parashtojë rezultatet e hetimeve paraprake.** 6. Pasi dëgjon parashtrimin e prokurorit, në të njëjtën seancë gjykata vendos pranimin e kërkesës për gjykimin e shkurtuar kur çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Në të kundërtën refuzon kërkesën dhe vazhdon me gjykim të zakonshëm. Kundër vendimit lejohet ankim sëbashku me vendimin përfundimtar. 7. **Kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk pranohet nëse i pandehuri apo mbrojtësi i tij ngrenë pretendime mbi vlefshmërinë e akteve apo përdorshmërinë e provave të grumbulluara gjatë hetimit paraprak, apo kur kërkojnë marrjen e provave të reja në gjykim. Kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk pranohet edhe në rastet kur gjykata kryesisht konstaton pavlefshmëri absolute apo papërdorshmëri të provave, si rezultat i të cilave çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen e akteve.** Në këtë rast, në vendimin e saj për refuzimin e kërkesës gjykata përcakton edhe aktet absolutisht të pavlefshme apo provat e papërdorshme në gjykim. Ky rregull nuk zbatohet kur kërkohen prova lidhur me personalitetin e të pandehurit, apo gjendjen e tij personale, familjare ose ekonomike. 8. Kur gjykata pranon kërkesën për gjykim të shkurtuar, gjykata fton palët të paraqesin diskutimet përfundimtare.”

3.3. Gjithashtu, Gjkata çmon të evidentoj disa nga veçoritë/elementet e “gjykimit të shkurtuar” që janë vënë në dukje në vendimin unifikues Nr. 2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit: **a)** Gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonomi gjyqësore, sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell si pasojë një përfitim për të pandehurin në uljen në një 1/3 e masës së dënimit dhe mosaplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm; **b)** Ky përfitim nuk duhet kurrsesi të shkojë në dëm të dhënies së drejtësisë. Pra, kërkesën e të pandehurit dhe të mbrojtësit të posaçëm të tij, gjykata e pranon vetëm atëherë, kur ajo praktikisht bindet se mund të përfundojë çështjen në gjendjen që janë aktet, pa qenë nevoja për shqyrtimin gjyqësor. Gjkata çmon, gjithashtu, se në pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar

gjykata është e detyruar⁸ të mbajë në konsideratë dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka marrë në analizë insitutin e gjykimit të shkurtuar. Kështu, në vendimin Nr. 4, datë 10.02.2012 Gjykata Kushtetuese ndër të tjera shprehet se: “Në këndvështrimin kushtetues, Gjykata Kushtetuese çmon se gjykimi i shkurtuar është një gjykim i posaçëm i cili konsiston në heqjen dorë në mënyrë të vullnetshme nga i pandehuri nga disa aspekte themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të tilla si parimi i barazisë së armëve dhe i formimit të provës në kontradiktoritet, për të përfituar një ulje dënimi. Për këtë arsye legjislatori për këtë lloj gjykimi ka parashikuar rregulla të veçanta në kreun IV të titullit VII të KPP-së (nenet 403-406), të cilave gjyqtarët duhen t’i përmbahen gjatë zbatimit të këtij gjykimi të posaçëm.”. Më tej në këtë vendim Gjykata Kushtetuese shprehet se: “...ndonëse, gjatë gjykimit të zakonshëm, është kompetencë eskuzive e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të bëjnë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, në gjykimet e posaçme, siç konsiderohet dhe gjykimi i shkurtuar, kjo e drejtë duhet të ushtrohet në përputhje me veçoritë e këtij gjykimi e, në veçanti me faktin se për të proceduar me këtë lloj gjykimi, përveç kërkesës së të pandehurit kërkohet detyrimisht edhe vendimi/miratimi i gjyqtarit (shih paragrafin 18 të këtij vendimi). E thënë ndryshe, **gjyqtari në momentin e marrjes së vendimit, në lidhje me pranimin ose jo të kërkesës për gjykim të shkurtuar të të pandehurit, duhet të udhëhiqet jo vetëm nga parimi i ekonomisë gjyqësore (shih paragrafin 19 të këtij vendimi), por duhet të vendosë, kryesisht, në përputhje me parimin e drejtësisë efektive. Kjo do të thotë që ai, ndër të tjera, duhet të marrë në konsideratë edhe cilësimin juridik të veprës penale të përcaktuar nga prokurori. Si pasojë, nëse ka dyshime mbi këtë cilësim, ky element mjafton që gjyqtari të rrëzojë kërkesën e të pandehurit për të proceduar me gjykim të posaçëm dhe të vazhdojë gjykimin me procedurën e zakonshme duke respektuar kështu të gjitha parimet e procesit të rregullt ligjor, si kontradiktoriteti, e drejta e mbrojtjes, etj”.**⁹

3.4. Duke analizuar dispozitat e citura më lartë që rregullojnë gjykimin e shkurtuar (403-406 të K.Pr.Penale) si dhe nga analiza e jurisprudencës së Gjykatës së Lartë dhe asaj të Gjykatës Kushtetuese arrijmë në këto përfundime: **Së pari**, kërkesa për gjykim të shkurtuar paraqitet me pasojë mospranimi vetëm përpara gjyqtarit të seancës paraprake ose gjyqtarit të themelit kur procedohet me gjykim të drjetpërdrejtë (neni 400 i K.Pr.Penale) dhe kur shqyrtohet ankimi kundër vendimit të miratimit të urdhrin penal (neni 406/ç të K.Pr.Penale). Pra, në raste të tjera nuk mund të paraqitet direkt përpara gjyqtarit të themelit. **Së dyti**, kompetentë për të vendosur për pranimin ose jo të kërkesës për gjykim të shkurtuar është vetëm gjyqtarit i themelit dhe jo gjyqtari i seancës

⁸ Shiko vendimin Nr. 20, datë 04.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese ku thuhet shprehimisht se: “14. **Gjykata rihetkon se nenet 124, 132 dhe 145/2 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike dhe gjykatat.** Zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit.... Efekti detyrues i vendimeve të kësaj Gjykate ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit.”.

⁹ I njëjti qëndrim është mbajtur dhe me Vendimin Nr. 24, datë 30.04.2012 i Gjykatës Kushtetuese.

paraprake. **Së treti**, kërkesa për gjykim të shkurtuar rrëzohet në rastet kur: **i)** gjykata çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet; **ii)** i pandehuri apo mbrojtësi i tij ngrenë pretendime mbi vlefshmërinë e akteve apo përdorshmërinë e provave të grumbulluara gjatë hetimit paraprak, apo kur kërkojnë marrjen e provave të reja në gjykim; **iii)** gjykata kryesisht konstaton pavlefshmëri absolute apo papërdorshmëri të provave, si rezultat i të cilave çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në gjendjen e akteve. Pra, në këtë rast, Gjykata mund të pranojë kërkesën për gjykim të shkurtuar kur edhe pse konstaton akte të pavlefshme apo prova të papërdorshme çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet; **iv)** kërkohet për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm; dhe **v)** konstatohet cilësimi juridik i gabuar bërë nga prokuroria që mund të rëndonte pozitën e të pandehurit. Në këtë rast procedohet me procedurën e zakonshme duke respektuar kështu të gjitha parimet e procesit të rregullt ligjor, si kontradiktoriteti, e drejta e mbrojtjes, etj.

3.5. Duke u rikthyer në rastin konkret, Gjykata pas shqyrtimit të të gjitha akteve të ndodhura në fashikullin e gjykimit, ku konstatoi se ato nuk përmbanin ndonjë pavlefshmëri nga ato të parashikuara në nenin 128 të K.Pr.Penale, vlerësoi se bazuar në nenin 405 të Kodit të Procedurës Penale, ka vend për të proceduar me gjykim të shkurtuar, pasi çmoi se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, pa cenuar drejtësinë dhe interesat e ligjshëm të të pandehurës dhe në kushtet kur kërkesa u paraqit në fazën e duhur procedurale, konkretisht përpara gjyqtarit të seancës paraprake (neni 403). Gjithashtu, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk jemi përpara veprave penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm.

II. Rrethanat e çështjes.

4. Gjykata, në kushtet e procedimit me gjykim të shkurtuar, duke prezumuar pranimin nga palët e të gjitha akteve dhe provave të grumbulluara në fazën e hetimeve paraprake dhe duke i vlerësuar ato në tërësinë e tyre çmon të provuar faktin si më poshtë:

5. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka regjistruar procedimin penal Nr. 202, datë 13.07.2021, në ngarkim të të pandehurës Etleda Çiftja, për kryerjen e veprave penale "*Falsifikim i dokumentave*", në formën e përdorimit, dhe "*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë*", parashikuar nga nenet 186/1 dhe 257/a/2 i Kodit Penal, mbështetur mbi kallzimin e paraqitur me Nr. 593 Prot., datë 28.06.2021 të Shoqatës së Avokatëve Antikorrupsion Shqiptare SH.A.A.SH. (nr. 211 kallzimi datë 30.06.2021).

5.1. Kallzuesi ka parashtruar se shtetësja Etleda Çiftja, është emëruar më datë 17.06.2017 nga Kuvendi, si Komisionere, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në përmbushje të detyrimit për deklarimin e pasurisë pranë ILDKPKI-së, kjo shtetase ka depozituar "*Deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës*" me datë dorëzimi 17.07.2017. Referuar kësaj të fundit, kallzuesit i krijohen dyshime të forta mbi burimin e pajustificuar të krijimit të pasurive të deklaruara. Sipas kallzuesit, në vitin 2006, pa përfshirë shpenzimet për jetesë, pushime, mobilime, udhëtime etj, kjo shtetase ka kryer

shpenzime në vlerën prej 3 000 000 lekë dhe 42 864 USD. Ndërkohë referuar CV-së së saj, kjo shtetase ka nisur karrierën në vitin 2001 si ndihmëse në një zyrë avokatie pa emër dhe nuk ka deklaruar sa ka qenë paga e saj dhe nëse janë paguar detyrimet tatimore. Në vitin 2009 ka punuar pranë subjektit Egnatia O Albania si këshilltare ligjore dhe nuk ka deklaruar pagën dhe taksat.

5.2. Kallzuesi, pretendon gjithashtu se, kjo shtetase, ka deklaruar blerjen e një toke arë me sipërfaqe 3440 m² në vlerën 50 000 euro, ndërkohë që sipas kontratës së shitjes me Nr. 2938 Rep., dhe Nr. 1490 Kol., datë 10.07.2006, kjo pasuri rezulton e blerë në vlerën prej 300 000 lekë. Po vlera prej 300 000 lekësh është shënuar në kartelën e pasurisë pranë ZRPP-së.

5.3. Gjithashtu, kjo shtetase ka deklaruar se, ka blerë edhe tokën me sipërfaqe 1450 m² të llojit arë me vlerë 300 000 lekë, ndërkohë që nëse merret i mirëqenë çmimi prej 300 000 lekë sipas kontratave për të dyja pronat, nuk ka mundësi që referuar sipërfaqeve të ndryshme, të kenë çmime të njëjta. Sipas kësaj logjike, i bie që sipërfaqja e tokës arë prej 1450 m² është blerë në vlefën prej 207 lekë, m² ndërkohë që sipërfaqe prej 3440 m² është blerë në vlefën prej 2 035 lekë/m². Pra parcelat, megjithëse janë blerë në të njëjtën ditë, ndodhen në të njëjtin vend, janë blerë me një diferencë çmimesh për m², sa dhjetëfishi. Sipas kallzuesit, nënshkrimi i një kontrate, me çmim qindrafish më të ulët, janë përdorur si mekanizëm për t'u shmangur pagesa e detyrimeve në përqindje të caktuar (10 - 15 % në favor të buxhetit të organeve tatimore) sipas ligjit.

5.4. Kjo shtetase ka deklaruar se tokën e ka blerë nëpërmjet kredisë, e cila rezulton të jetë marrë më datë 29.09.2006, ndërkohë që toka është blerë më datë 10.07.2006, pra dy muaj pas disbursimit të kredisë. Referuar të njëjtës deklaratë, kallzuesi ngre pretendime në lidhje me vlerën e apartamentit. Kallzuesi parashton se në vitin 2006, kjo shtetase deklaroi se ka blerë apartament banimi me sipërfaqe 70.80 m² në vlerën 42 864 USD, me një çmim disa herë më të ulët se sa duhet të ishte vlera e tij, pasur parasysh se ndodhet në qendër të Tiranës. Si burim ka deklaruar pagat e saj dhe të bashkëshortit. Kjo pasuri, dukshëm konstatohet se megjithëse ndodhet në qendër të Tiranës, është blerë në një çmim preferencial dhe më pak se sa toka e ndodhur në Kavajë.

6. Gjithashtu, të ardhurat e pagës si Drejtoreshë Ligjore pranë shoqërisë Devoll nga aktet e prokurorisë rezulton se, e pandehura Etleda Çiftja, me vendimin Nr. 82/2017 datë 17.06.2017 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Rishqipërisë" është zgjedhur në institucionet e rivlerësimit si komisionere në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Ndodhur në këto kushte, në zbatim të Ligjit Nr. 9049, datë 10.4.2003 "PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË", i ndryshuar, e pandehura Etleda Çiftja më datën 17.07.2017 ka dorëzuar pranë Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave Deklaratën e Interesave Private Para Fillimit të Detyrës. Gjithashtu, në aktet e prokurorisë nuk rezulton që të jetë administruar ndonjë listë inventari për dokumentacionin

justifikues që duhet t'i bashkëlidhet këtij formulari ditën e dorëzimit të tij më datë 17.07.2017. Në këtë deklaratë pasurie, e pandehura Etleda Çiftja ka deklaruar pasuritë si më poshtë vijon:

1. **Apartament** banimi me sipërfaqe 70.80 m², rruga "{***}", Tiranë. Kontratë shitje datë 30.11.2016 me vlerë **42 864 USD**. Vlera e paguar në bazë të kontratës së sipërmarrjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 08.09.2006. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga **paga**. Pronësia 50 %.
2. **Kuota në Fondin e Investimeve** Raiffeisen Prestige, blerë më: **01.10.2012** me vlerë transksioni 1 200 000 lekë; **15.03.2013** me vlerë transksioni 400 000 lekë; **13.12.2013** me vlerë transksioni 1 200 000 lekë; **12.02.2015** me vlerë transksioni 600 000 lekë; **16.06.2015** me vlerë transksioni 1 000 000 lekë; **30.06.2016** me vlerë transksioni 1 500 000 lekë. Totali i blerjeve 5 900 000 lekë, çmimi i kuotës 1 418.0836 lekë. Numri i kuotave 4 979.4118 lekë. **Burimi i krijimit:** Nga {***} sh.a. Pronësia 100%.
3. Llogari bankare page në lekë pranë Raiffeisen Bank dhe gjendje më datë 17.06.2017 në vlerën **975 573.12 lekë**. **Burimi i krijimit:** Nga të ardhurat e **pagës si Drejtoreshë Ligjore pranë shoqërisë {***} sh.a.** Pronësia 100%.
4. Llogari bankare në euro pranë Raiffeisen Bank dhe gjendje më datë 17.06.2017 me vlerë 0 (zero). **Burimi i krijimit:** Nga të ardhurat e **pagës si Drejtoreshë Ligjore pranë shoqërisë {***} sh.a.** Pronësia 100%.
5. **Tokë arë me sipërfaqe 1450 m²** në adresë {***} Kavajë, blerë më datë **10.07.2006**, në vlerën 300 000 lekë. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga **paga**. Pronësia 100%.
6. **Tokë arë me sipërfaqe 3440 m² me adresë fshati {***}**, Kavajë, blerë më datë **10.07.2006**. **Burimi i krijimit:** Kredi nga Banka Amerikane e Investimeve (*American Bank of Investment SA*) ish Banka Emporiki - Shqiperi sh.a. në shumën prej **35 000 euro** dhe të ardhura nga **paga 15 000 euro** si Drejtoreshë Ligjore pranë {***}. Pronësia 100%.
7. Autoveturë e tipit Benz 203, prodhim i vitit 2000, me targa {***}, blerë më datë **23.04.2012**, në vlerën 1 000 000 lekë. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga **paga**. Pronësia 50%.
8. Autoveturë e tipit Benz, 4+1, tipi 124 (200D) prodhim i vitit 1985, me targa {***}, blerë më datë 04.07.2005, në vlerën 250 000 lekë. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga **paga**. Pronësia 50%.
9. Llogari bankare në euro, pranë American Bank of Investment SA dhe gjendje më datë 17.06.2017 në vlerën 688.12 euro. **Burimi i krijimit:** Llogari për pagesë kredie me të ardhurat e pagës. Pronësia 100%.
10. Llogari bankare në lekë pranë American Bank of Investments SA dhe gjendje më datë 17.06.2017 në vlerën 0.40 lekë. **Burimi i krijimit:** **Paga**. Pronësia 100%.
11. Llogari bankare në lekë pranë Alpha Bank dhe gjendje deri më datë 17.06.2017, në vlerën 1 116.99 lekë. **Burimi i krijimit:** **Bashkëshorti D.Ç.**

12. Llogari bankare në lekë pranë Banka Kombëtare Tregtare dhe gjendje deri më datë 17.06.2017 në vlerën 80 304 lekë. **Burimi i krijimit: Bashkëshorti D.Ç.**

13. Llogari bankare në lekë pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe gjendje deri më datë 17.06.2017 në vlerën 5 628.88 lekë. **Burimi i krijimit: Bashkëshorti D.Ç.**

6.1. Lidhur me përshkrimin e të ardhurave të saj në këtë deklaratë që përfshinë periudhën nga data 1 Janar deri në ditën e fillimit të punës së vitit të deklaramit, e pandehura Etleda Çiftja, ka deklaruar si më poshtë vijon:

1. Drejtoresh Ligjore pranë Shoqërisë {***} – 17.06.2017. **Vlera e të ardhura 2, 947, 226 (dy milion e nentëqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind e njetzet e gjashtë) Lekë.**
2. Të ardhura/rimbursim nga siguracioni privat. **Vlera e të ardhura 117, 330 (njqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë) Lekë.**
3. Të ardhurat të pritshme nga paga pas datës 17.06.2017. **Vlera e të ardhurave 1, 640, 707 (një milion e gjashtëqind e dyzet mijë e shtatëqind e shtatë) Lekë.**
4. Të ardhurat nga paga. Bashkëshorti D.Ç oficer pranë Drejtorisë së Mbrojtjes së Personaliteteve të Larta, Garda e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Brendshme. **Vlera e të ardhurave 372, 903 (treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tre) Lekë.**

6.2. Lidhur me përshkrimin e detyrimeve të tij, e pandehura Etleda Çiftja në Deklaratën e Interesave Private Para Fillimit të Detyrës ka deklaruar si më poshtë vijon:

1. **Kredi për blerje tokë arë**, me sip 3440 m2 tek American Bank of Investment SA (isha Banka Emporiki - Shqipëri sh.a.) më datë 29.09.2006 në shumën **35 000 euro me afat 20 vjet**. Gjendja më datë 17.06.2017 është në shumën 16 699. 30 euro. **Shlyerja ka filluar një muaj nga tërheqja e shumës së kredisë, 29.09.2006 dhe përfundon më datë 29.09.2026 me interes, me këst mujor 215 euro**. Ka deklaruar se deri në datën e deklarimit ka shlyer 16 699.30 euro.

7. Bazuar në nenin 27 të Ligjit Nr. 9049, datë 10.4.2003 “PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË”, i ndryshuar, nën titullin “**Thirrja e subjektit për të dhënë shpjegime**” ku parashikohet se: “Kur gjatë kontrollit zbulohet se deklaramet nuk janë të sakta ose burimet e deklaramara nuk identifikohen dhe nuk mbulojnë pasuritë e deklaramara, Inspektorati i Lartë thërret subjektin për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse, të cilat paraqiten kurdoherë me shkrim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.”, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i është drejtuar shtetases Etleda Çiftja, Komisionere pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me shkresën Nr. {***} Prot., datë 31.08.2017, me lëndë: “Ftesë për t’u paraqitur në ILDKPKI për të dhënë shpjegime lidhur me deklarimin e interesave private” në të cilët thuhet shprehimisht se:

“Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, bazuar në Nenin 3, të Ligjit Nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar, si dhe në ligjin Nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, ka në proces kontrolli të plotë deklaraten tuaj të interesave private, Para Fillimit të Detyrës 2017, të dorëzuar në dt.17.7.2017. Për të dhënë sqarimet e nevojshme lidhur me problemet e dala gjatë kontrollit të plotë, bazuar në nenin 27 të Ligjit Nr. 9049 datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, është e nevojshme të paraqiteni në ambientet e Inspektoratit të Lartë, **ditën e hënë, datë 18.9.2017, ora 10⁰⁰**. Në rast mosparaqitje, Inspektorati i Lartë do të vazhdojë kontrollin dhe marrjen e masave penale, administrative e disiplinore në mungesën tuaj.”.

7.1. Më datë **18.09.2017** është mbajtur procesverbali “Mbi shpjegimet e subjektit deklarues” midis të pandehurës Etleda Çiftja dhe shtetases V.K, me detyrë Inspektore në Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ku të pandehurës i janë bërë tetë pyetje. Në procesverbal në përfundim thuhet se: “Subjekti u njoh me problematikën e sipërcituar dhe në dt. 2.10.2017 do të paraqitet për të dhënë sqarime duke dorëzuar dhe dokumentacionin justifikues përkatës”.

7.2. Më datë **02.10.2017** është mbajtur procesverbali “Mbi shpjegimet e subjektit deklarues” midis të pandehurës Etleda Çiftja dhe shtetases V.K, me detyrë Inspektore në Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ku thuhet shprehimisht se: [...]

Subjektit iu shpjeguan arsyet e thirrjes së saj për të dhënë shpjegime dhe u paralajmërua për përgjegjësinë që ka në bazë të nenit 38, të Ligjit Nr. 9049 datë 10.04.2003, i ndryshuar, në rast deklarimi të rremë. Subjekti pasi u njoh me problematikën e konstatuar në deklaratat e saj të Interesave Private në Proces-Verbalin e dt.18.9.2017, sot, sqaroi si më poshtë:

Pyetje nr. 1: Në deklarimin tuaj PFD 2017 keni deklaruar: Apartament banimi, me sip.70.80 m², Rruga e {***}, Tiranë. Kontratë Shitje datë 30.11.2016 me vlerë 42 864 USD. (Vlera paguar në bazë të Kontratës së sipërmarrjes me nr. {***}, Rep. dhe {***} Kol, datë 8.9.2006). Burimi te ardhura nga paga. Zotëron 50% me bashkëshortin. Paraqisni dokumentacion vërtetues në lidhje me këtë aset. Sqaroni lidhur me burimin e krijimit të këtij aseti në vitin 2006 në vlerën 42 864USD, duke e shoqëruar sqarimin me dokumentacion justifikues. (DPPPP konfirmon se ju pagesën në dt. 30.11.2006 e keni kryer për këtë apartament ne shumen 42 864 Euro dhe jo USD). Sa kane qenë shpenzimet e mobilimit të këtij apartamenti?

Përgjigje nr. 1: Une po dorëzoj Certifikatën e Pronësisë, me nr. 1351611 leshuar dt.5.12.2016+Kontraten e Shitblerjes me nr. {***} Rep dhe nr. {***} kol dt.30.11.2016. Gjithashtu po dorëzoj dhe Kontratën e Sipërmarrjes te dt.8.9.2006+ Zgjidhje Kontrate e dt .8.9.2006 qe konfirmon se me firmën {***}

marrëveshja ishte kryer me familjen Kamberi dhe ne u lidhem pas kësaj Kontrate Zgjidhje me firmën {***}. Pagesën ja kemi kryer familjes Kamberi ne vlerën 42 864 USD dhe me firmën {***} ne skemi kryer transaksione. **Me firmën {***} shpk Kontraten e Shitblerjes e kemi lidhur përfundimisht ne 2016 dhe atëherë firma e ka deklaruar si pagese meqenëse është lidhur ne Noteri kjo Kontrate ne dt. 30.11.2016.** Deklaroj me përgjegjësi te plote qe pagesa eshte kryer ne 2006 dhe jashtë zyrës. Pagesa është kryer ne USD dhe nuk e di pse është deklaruar ne Euro nga firma. Këtë e konfirmojnë Kontratat qe sapo dorëzova. Ne kemi hyre per te banuar ne vitin 2006 dhe pagesat për mobilim kane shkuar ne shumen rreth 5 000 Euro. **Burimi i pagesës ka qene me kredinë e marre ne Emporiki Bank ne dt.29.9.2006 ne vlerën 35 000 Euro. Kjo shume mbuloi dhe blerjen ne vlerën 42 864 USD dhe shpenzimet e mobilimit. Ne Kontratën me bankën meqenëse firma {***} ende nuk e kishte te regjistruar ne ZVRPP këtë pallat qe po ndërtonte, unë nuk mund te merrja kredi me kolateral apartamentin dhe per këtë arsye vura si qellim marrje kredi dhe kolateral, blerjen e një toke me sip. 3 440 m2 ne {***} Kavaje. Kjo toke u vlerësua nga ekspertet e Bankës ne vlerën 50 000 Euro. Ne fakt, këtë toke unë nuk kisha nevojë ta bleja sepse ishte toke ne pronësi te babait tim i cili e kishte përfutuar me Ligjin 7501. Po dorëzoj Kontratën e Huase me Emporiki Bank te dt.29.9.2006+ Aktin e Marrjes se Tokës ne Pronësi te dt. 15.9.1995+Vertetim i dt. 29.6.2006 lëshuar nga Komuna Kryevidh qe konfirmon qe babai im Rustem Kaja ka ne zotërim sip. 3 440m2 ne ZK {***}+Certifikaten për Vërtetim Pronesie e dt.21.6.2006 qe konfirmon regjistrimin e tokës me sip. 3 440m2 Are ne Kryevidh Kavaje ne emër te babait tim R.K.**

Pyetje nr. 2: Në deklarin tuaj PFD 2017 keni deklaruar: Arë me sip. 1 450 m2, me adresë {***}, Kavajë, blerë me datë 10.7.2006 në vlerën 300 000 lekë, te ardhura nga paga dhe Arë me sip. 3 440 m2, me adresë {***}, Kavajë, blerë më datë 10.7.2006 në vlerën 50 000 Euro me burim kredi nga BIA, në shumën prej 35 000 Euro dhe 15 000 Euro të ardhura nga paga. Paraqisni dokumentacion vërtetues në lidhje me këto asete. Sqaroni lidhur me burimin e krijimit të këtyre aseteve (kredi dhe paga) në vlerat 300 000 leke dhe 50 000 Euro, duke e shoqëruar sqarimin me dokumentacion justifikues (vetëm ne 2006 ju keni krijuar asete, në vlerën totale 10 527 717 leke, konvertuar ne all me kursin e vitit). Sqaroni pse keni deklaruar që toka në {***} me sip. 3 440 m2 është blere ne masën 35 000 Euro nga kredia e marre ne ABI Bank, kur kjo bankë, në përgjigjen e dt. 8.8.2017, na konfirmon se kredia 35 000 Euro është marre në dt. 29.9.2006 për blerje apartamenti.

Përgjigje nr. 2: Per sip. e tokës 3 440 m2 e sqarova me lart kur shpjegova qëllimin e marrjes se kredisë ne Emporiki Bank. Pra kjo toke ishte e babait tim dhe qe te vihej Kolateral duhej te behej një Kontrate Shitblerje ne emër tim si Bleres qe pastaj ta përdorja si Kolateral për marrjen e kredisë. Pra kjo toke nuk

është blere realisht nga une sepse kredia është marre për apartamentin. Dhe toka e II me sip.1 450 m2 nuk është blere por qe te regjistrohej ne emrin tim duhet te lidhja një Kontrate Shitblerje me tim ate qe ishte pronar i kësaj toke. Dhe për këtë toke nuk kam paguar asgjë. Babai im e ka përfituar kete toke njësoj si Token e I, nga Ligji 7501. Po dorëzoj Kontraten e Shitblerjes te dt.10.7.2006 për blerje te tokës Are me sip. 3 440 m2 +Kontrate Shitblerje te dt.10.7.2006 qe konfirmon blerjen nga une te takes me sip. 1 450 m2 (dhe per kete blerje nuk kam kryer pagese) + Certifikaten e Pronesise per toke me sip. 1 450 m2 ne emër te babait tim Rustem Tuja+ Vertetim i dt.29.6.2006 lëshuar nga Komuna Kryevidh qe konfirmon qe babai im R.K ka ne zotërim sip. 1 450 m2 ne ZK 3175. E gjithë sip. qe u regjistrua ne emrin tim ishte ne respekt te Ligjit 7501, qe çdo pjestar i familjes bujqesore te merrte 5 000 m2 nga toka ne pronësi dhe regjistrimi ne emrin tim mund te kryhej vetëm nëse kryetari i familjes bujqësore i shiste këto toka me Kontrata Shitblerje (sic vepruam ne). Po dorëzoj dy Certifikatat e Pronesise te tokave te shpjeguara me lart qe tashme janë te regjistruara ne emrin tim.

Pyetje nr. 3: Në deklarin tuaj PFD 2017 keni deklaruar: Kuota në Fondin e Investimeve Raiffeisen Prestige. Blerë më: - datë 1.10.2012 me vlerë transaksioni 1 200 000 lekë; - datë 15.3.2013 me vlerë transaksioni 400 000 lekë; - datë 13.12.2013 me vlerë transaksioni 1200000 lekë; - datë 12.2.2015 me vlerë transaksioni 600 000 lekë; - datë 16.6.2015 me vlerë transaksioni 1 000 000 lekë; - datë 30.6.2016 me vlerë transaksioni 1 500 000 lekë. Totali i blerjes: 5 900 000 lekë. Raiffeisen Invest me pergjigjen e dt.4.8.2017 konfirmon deklarin tuaj. Sqaroni në mënyrë të detajuar, lidhur me burimin e krijimit të këtij investimi, për vitet 2012, 2013, 2015 dhe 2016, duke e shoqëruar sqarimin me dokumentacion justifikues. **Përgjigje nr. 3:** Ky investim ne Fondin e Investimeve ne RP është kryer vetëm me burim pagën time ne çdo vit. Për këtë po dorëzoj dhe Vërtetim te leshuar nga {***} sh.a. ne dt.2.10.2017 dhe gjithashtu po dorëzoj dhe statement te RZB qe konfirmon derdhjen e pagës ne favorin tim dhe pastaj kalimin ne fondin e investimit Raiffeisen Prestigj...[...]

8. Gjithashtu, nga e pandehura Etleda Çiftja në mbështetje të shpjegimeve të mësipërme, gjatë hetimit ka depozituar dokumentacionin si më poshtë vijon:

8.1. Kontratë Sipërmarrje datë 21.08.2003 më palë: **Investitor:** Shoqëria “{***}” sh.p.k dhe **Porositës:** R.K. Sipas kësaj kontrate sipërmarrësi Shoqëria “{***}” sh.p.k merrë përsipër të ndërtoj për porositësin një apartament me sipërfaqe 75.2 m² së bashku me ambjentet e përbashkëta, e përbërë nga një dhomë dhe një guzhinë, pallati D1, kati i tetë i banimit. Çmimi i shitjes së apartamentit është 42. 864 USD (Dyzetë e dymijë e tetëqind dollar”. Sipas kësaj kontrate kësti i parë në shumën 12.800 dollar është paguar jashtë zyrës noteriale. Kësti i dytë në shumën 12.800 USD do të paguhet brenda muajit dhjetor 2003. Kësti i tretë në shumën 12.800 USD do të paguhet në 30 maj 2004, ndërsa kësti i katërt në shumën 4464 USD do të paguhet me marrjen e çelësave.

8.2. Zgjidhje e Kontratës datë 08.09.2006 midis palëve: Shoqëria “{***}” sh.p.k dhe 1. M.K; 2. M.X; 3. V.H; 4. M.M dhe 5. I.K, në cilësinë e trashëgimtarëve të të ndjerit R.K. Sipas këtij veprimi juridik zgjidhet Kontrata e Sipërmarrjes datë 21.08.2003 me palë: **Investitor:** Shoqëria “{***}” sh.p.k dhe **Porositës:** R.K, për pronotimin e një apartamenti me sipërfaqe 75.2 m² në vlerën 42. 864 USD (Dyzetë e dymijë e tetëqind dollar”, e cila është likuajduar tërësisht. Në këtë dokument thuhet se palët me marrëveshje e zgjidhin këtë kontratë pasi trashëgimtarët e R.K ja kalojnë këtë apartament z.D.Ç dhe znj.Etleda Çiftja si dhe deklarojnë se shoqëria “{***}” sh.p.k ka të drejtë që të lidhë një kontratë të re sipërmarrje me porositës D.Ç dhe Etleda Çiftja me shumë të likuajduar.

8.3. Kontratë Sipërmarrje me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 08.09.2006, me palë: **Investitor:** Shoqëria “{***}” sh.p.k dhe **Porositës:** 1. Etleda Çiftja dhe 2. D.Ç. Sipas kësaj kontrate sipërmarrësi Shoqëria “{***}” sh.p.k merrë përsipër të ndërtoj për porositësin një apartament me sipërfaqe 75.2 m² së bashku me ambientet e përbashkëta, e përbërë nga një dhomë dhe një guzhinë, pallati D1, kati i tetë i banimit. Çmimi i shitjes së apartamentit është 42. 864 USD (Dyzetë e dymijë e tetëqind dollar”, shumë e cila është likuajduar jashtë zyrës noteriale.

8.4. Kontratë Shitblerje me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 30.11.2016, me palë: **Shitëse:** Shoqëria “{***}” sh.p.k dhe **Blerës:** 1. Etleda Çiftja dhe 2. D.Ç. Objekti është blerja e apartamentit objekt i Kontratës së Sipërmarrjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 08.09.2006. Sipas Çertifikatës së Pronësisë me Nr. {***}, datë 21.04.2010 dhe kartelës së pasurisë që i bashkëlidhet kontratës së shitjes rezulton se apartamenti objekt i këtyre kontratave është regjistruar në favor të Shoqërisë “{***}” Sh.p.k pranë ZVRPP-së më datë **31.03.2010**.

8.5. Kontratë Shitblerje me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006, të lidhur përpara noteres L.K, me palë: **Shitësit:** R.K, S.K dhe E.K; **Blerës:** Etleda Çiftja. Objekti i kësaj kontrate është shitja e një sipërfaqe tokë arë prej 3440 m² në {***}, Kavajë që shitësat kanë në pronësi sipas Çertifikatës së Pronësisë lëshuar më datë 21.06.2006. Në këtë kontratë ndër të tjera thuhet se: *“Shitësit deklarojnë se me vullnetin e tyre të lire e të plotë ia shesin pronën me cilesit e sipershenuara bazuar në Ligjen 8337 date 30.04.1998, blerësit Etleda Çiftja në Shumen 50 000 EURO (pesedhjetë mijë EURO) duke e lene të lire dhe të papengueshme që nga ky moment. Blerësi Etleda Çiftja e pranon blerjen e pronës të cilën e mere, të lire dhe të papengueshme si dhe **likujdon totalisht me leke në dorë jashtë Zyres që redaktohet ky akt.**”* Bashkëlidhur kësaj kontrate gjendet: **i)** Vërtetimi i datës 29.06.2006 lëshuar nga Kryetari i Komunës Kryevindh, ku citohet se z.R.K në cilësinë e kryetarit të familjes bujqësore për të kryer veprimet e kalimit të pronësisë sipas Ligjit Nr. 8337 datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyejore, livadhe dhe kullota” nuk ka anëtarë të tjerë përveç çertifikatës familjare bashkëngjitur këtij vërtetimi; **ii)** Çertifikata Familjare me kryefamiljar z.Rustem Kaja dhe pjesëtarë Suzana Kaja e Ervin Kaja; **iii)** Çertifikata e Pronësisë lëshuar më datë 21.06.2006 së bashku me hartën treguese të regjistrimit. Sipas kartelës së pasurisë rezulton se toka objekt i kontratës së shitjes është regjistruar që prej datës 28.05.1996.

8.6. Kontratë Shitblerje me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006, të lidhur përpara noteres L.K, me palë: **Shitësit:** R.K, S.K dhe E.K; **Blerës:** Etleda Çiftja. Objekti i kësaj kontrate është shitja e një sipërfaqe tokë arë prej 1450 m² me adresë: {***}, Kavajë që shitësat kanë në pronësi sipas Çertifikatës së Pronësisë lëshuar më datë 21.06.2006. Në këtë kontratë ndër të tjera thuhet se: *“Shitësit deklarojnë se me vullnetin e tyre te lire e te plote ia shesin pronen me cilesit e sipershenuara bazuar ne Ligjen 8337 date 30.04.1998, blesit Etleda Çiftja ne Shumen 300.000 LEKE (treqind mije leke) duke e lene te lire dhe te papengueshme qe nga ky moment. Bleresi Etleda Çiftja e pranon blerjen e prones te cilen e mere, te lire dhe te papengueshme si dhe **likujdon totalisht me leke ne dore jashte Zyres qe redaktohet ky akt.**”* Bashkëlidhur kësaj kontrate gjendet: **i)** Vërtetimi i datës 29.06.2006 lëshuar nga Kryetari i Komunës Kryevindh, ku citohet se z.R.K në cilësinë e kryetarit të familjes bujqësore për të kryer veprimet e kalimit të pronësisë sipas Ligjit Nr. 8337 datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyejore, livadhe dhe kullota” nuk ka anëtarë të tjerë përveç certifikatës familjare bashkëngjitur këtij vërtetimi; **ii)** Çertifikata Familjare me kryefamiljar z.R.K dhe pjesëtarë S.K e E.K; **iii)** Çertifikata e Pronësisë lëshuar më datë 21.06.2006 së bashku me hartën treguese të regjistrimit. Sipas kartelës së pasurisë rezulton se toka objekt i kontratës së shitjes është regjistruar që prej datës 28.05.1996.

8.6.1. Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi me Nr. {***}, datë 15.09.1995, ku rezulton se familjes së R.T.K, nga fshati Kryevindh i jepet në pronësi gjithsej **27191 m²tokë.**

8.6.2. Çertifikatë Familjare lëshuar më datë 04.10.2021 nga Njësia Administrative Kryevindh, ku rezulton se më datë 01.08.1991, përbërja e familjare e shtetasit R.K ishte me pesë persona, ky i fundit, bashkëshortja S.K, si dhe fëmijët Etleda Çiftja, E.K dhe O.K.

8.6.3. Çertifikatë Pronësie lëshuar më datë 15.09.2006, së bashku me hartën treguese të regjistrimit, ku rezulton se shtetësja Etleda R. Çiftja është pronare e një sipërfaqe tokë arë 3440 m², me adresë {***}, Kavajë, me numër pasurie {***}.

8.6.4. Çertifikatë Pronësie lëshuar më datë 08.09.2006, së bashku me hartën treguese të regjistrimit, ku rezulton se shtetësja Etleda R. Çiftja është pronare e një sipërfaqe tokë arë 1450 m², me adresë {***}, Kavajë, me numër pasurie {***}.

8.7. Kontratë Hipoteke me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 28.09.2006 të lidhur përpara Noteres L.K, me palë: BANKA “EMPORIKI – SHQIPERI” sh.a; **Hipotekuesi:** Etleda Çiftja. Në këtë kontratë ndër të tjera thuhet shprehimisht se: *“1.1. Objekti i kësaj Kontrate eshte venia e hipotekes se shkalles se pare ne favor te Bankes mbi pronen ne pronesi te Etleda CIFTJA e cila eshte e regjistruar ne Zyren e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Kavaje, Shqiperi, si me poshte: Nr. Pasurie {***}, Volumi {***}, Faqja {***}, Zona Kadastrale Nr. {***}. ...1.3. Kjo Kontratë Hipoteke eshte pjese perberesi dhe e pandare e Kontratave te kredise qe jane lidhur dhe qe do te lidhen ne te ardhmen ndermjet Bankes dhe Kredimarresit Etleda CIFTJA, te treguara ne piken 1.2. me lart, deri ne ripagimin e plote dhe pa kushte te shumes se cdo kredie te kredimarresit te mesiperm dhe te te gjitha detyrimeve sipas afateve dhe kushteve te percaktuara ne*

Kontratat perkatese te kredive. ... 2.1. Prona qe hipotekohet eshte nje are me siperfaqe 3, 440 m2.”.

8.7.1. Kontratë Huaje me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 29.09.2006 të lidhur përpara Noteres L.K, me palë: **Huadhënës:** BANKA “EMPORIKI – SHQIPERI” sh.a; **Huamarrës:** Etleda Çiftja; dhe **Dorëzanës:** D.Ç. Në këtë kontratë ndër të tjera thuhet shprehimisht se: “Banka bie dakord qe t’i jape Huamarresit nje Hua ne Shumen maksimale EURO 35, 000. – (EURO tridhjetë e pesë mijë vetëm) “HUAJA”, sipas kushteve dhe afateve te meposhtme: ...2. **Të ardhurat e Huas do te perdoren nga Huamarresi per financimin e nevojave te tij per blerjen e nje toke me siperfaqe 3, 440 m², me adrese ne Kryevidh, Kavaje, Shqiperi, ne perputhje me Kontraten Nr. Rep. {***}, Nr. Kol. {***}, date 10 Korrik 2006, vertetuar nga notere L.K, nenshkruar ndermjet R.K, S.K, E.K, (Shites) dhe Etleda Ciftja (Bleresi). Banka ka te drejten, po jo detyrimin te monitoroje, kontrolloje perdorimin e fondeve te huas nga Huamarresi. Gjithashtu, eshte rene dakord qe Huaja mund te perdoret per xxxx ne baze te kerkeses dhe te udhezimeve te Huamarresit, me kusht qe keto te perputhen me qellimin e Huas. Te ardhurat nga Huaja nuk do të përdoren per veprime apo transaksione qe vijne ne kundërshtim me sanksionet e Kombeve te Bashkuara, te Bashkimit European ose me legjislacionin shqiptar.”.**

8.7.2. Raport Vlerësimi “Tokë me sipërfaqe 3440 m2, {***} Kavajë”, datë 6 Shtator 2006 me Porositës: Emporiki BANK; Pronari: z.R.K; dhe Klienti: znj.Etleda Çiftja. Sipas këtij raporti vlera e tregut të lirë të kësaj prone është 48 000 Euro, ndërsa vlera e shitjes së detyruar ose vlera e likuidimit është 38 500 Euro.

8.7.3. Deklaratë Noteriale me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 28.04.2020 lëshuar nga BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SH.A, ku ndër të tjera thuhet se: “Ndërmjet Banka Emporiki-Shqiperi SHA (sot Banka Amerikane e Investimeve SHA) dhe Kredimarrësve Etleda Ciftja dhe D.C eshte lidhur Kontrata e Kredise Nr. {***} Rep dhe Nr. {***} Kol, date 29.09.2006, Notere L.K, për sigurimin e së ciles është vendosur hipotekë ne favor te Bankes me anë të Kontraten e Hipotekes Nr. {***} Rep dhe Nr. {***} Kol., date 28.09.2006, Notere L.K, mbi pronen e regjistruar si më poshtë: a) Prona në pronësi të Shoqeria Etleda Çiftja, e cila është regjistruar në Zyren e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavaje, Shqipëri (tashme Drejtoria Vendore e ASHK Kavaje), Nr. Pasurie {***}, volumi {***}, Faqe {***}, Zona Kadastrale {***}, ndodhur ne {***}, Kavaje, Shqipëri. Me ane te kesaj deklarate kerkojme nga Drejtoria Vendore e ASHK Kavaje, (ish Zyra e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Kavaje), Shqiperi te fshije vetem hipoteken e vendosur ne favor te Bankes mbi pasuri ne e pershkruar me siper, me ane te Kontrates te cituar me poshte: Kontrata e Hipotekes Nr. {***} Rep dhe Nr. {***} Kol, date 28.09.2006, Notere L.K.”.

9. Gjithashtu, në mbështetje të pretendimeve të saj, e pandehura Etleda Çiftja ka depozituar pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dokumentacionin justifikues mbi burimet e të ardhurave për të dhe bashkëshortin e saj, si më poshtë vijon:

9.1. Vërtetim me Nr. {***} Regj, datë 27.01.2000 të Ministrisë së Drejtësisë, ku pasqyrohet se kjo shtetase është regjistruar në regjistrin e asistentëve për avokatë në Ministrinë e Drejtësisë, diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë të UT më Tiranë më datë 08.08.1999. Regjistrimi është bërë konform nenit 34 të ligjit nr. 7827 datë 31.05.1994 "Për Avokatinë në R.Sh" pasi mbledhja e përgjithshme e Dhomës së Avokatëve Tiranë, ka caktuar për të kryer stazhin si asistent, pranë avokatit të kësaj dhome z.S.D. Stazhi fillon 15.08.1999 dhe mbaron 15.08.2000.

9.1.1. Sipas vërtetimit pa datë, të nënshkruar nga Av.S.D, vërtetohet se shtetësja Etleda Kaja ka punuar si asistente pranë këtij avokati nga muaji gusht i vitit 1999, ku vazhdon të punojë dhe aktualisht. Përsa më sipër figuron e regjistruar në Ministrinë e Drejtësisë (Regjistrin e asistentëve). Ky vërtetim lëshohet për efekt testimi.

9.2. Sipas vërtetimit të muajit korrik 2006 të lëshuar nga shoqëria {***} sh.p.k. për shtetasen Etleda Çiftja, rezulton të jetë vërtetuar se kjo shtetase është e punësuar si këshilltare juridike me kohë të pjesshme, pranë kësaj shoqërie, me pagë mujore 30 000 lekë. Ky vërtetim është lëshuar me kërkesën e të interesuarit për ta përdorur si dokument në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi.

9.3. Vërtetim Nr. {***} Prot., datë 18.11.2020 lëshuar nga Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë ku theksohet se shtetasja Etleda Kaja për periudhën Mars 2001-Dhjetor 2004 ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilit është derdhur kontribut nga subjekti "{***}" me nr. dosje 5365 juridike.

9.3.1. Vërtetim Nr. {***} Prot., datë 18.11.2020 lëshuar nga Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë ku theksohet se shtetasja Etleda Kaja për periudhën Janar 2005-Dhjetor 2008 ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilit është derdhur kontribut nga subjekti {***} me nr. dosje 5365 juridike.

9.3.2. Vërtetim me Nr. {***} Prot., datë 06.10.2021 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tiranë, ku vërtetohet se shtetësja Etleda Çiftja (Kaja) me ID {***} është trajtuar me raport barrëindje, pranë DRSSH Tiranë nga data 01.09.2005-29.08.2006 me vlerë 393145 (treqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e dyzetë e pesë) Lekë. Listëpagesat janë dorëzuar nga subjekti {***} me NIPT {***} Tiranë.

9.3.3. Vërtetim Nr. {***} Prot., datë 18.11.2020 lëshuar nga Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë ku theksohet se shtetasja Etleda Kaja për periudhën Janar 2009-Maj 2009 ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilit është derdhur kontribut nga subjekti "{***}" me nr. dosje 5365 juridike.

9.4. Vërtetim lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ku theksohet se shtetasi D.Ç për periudhën **01.07.2000-31.12.2002** ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilit është derdhur kontribut nga subjekti Garda e Republikës.

9.4.1. Vërtetim lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ku theksohet se shtetasi D.Ç për periudhën **01.01.2003-16.11.2005** ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilit është derdhur kontribut nga subjekti Garda e Republikës.

9.4.2. Vërtetim Nr. {***} Prot., datë 30.09.2021 lëshuar nga Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë ku theksohet se shtetasi D.Ç për periudhën **Maj - Tetor 2005** ka realizuar

të ardhura mbi bazën e të cilit është derdhur kontribut nga subjekti “**Garda e Republikës së Shqipërisë**” me nr. dosje 276 juridike.

9.4.3. Vërtetim lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ku theksohet se shtetasi D.Ç për periudhën **16.11.2005-16.11.2007** ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilit është derdhur kontribut nga subjekti Garda e Republikës.

9.4.4. Vërtetim Nr. {***} Prot., datë 30.09.2021 lëshuar nga Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë ku theksohet se shtetasi D.Ç për periudhën **Shkurt 2010 - Dhjetor 2012** ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilit është derdhur kontribut nga subjekti “**Banka e Shqipërisë**” me nr. dosje 1 juridike.

9.4.5. Ekstrakt nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për shtetasin D.Ç që provon pagimin e kontributeve për periudhën Dhjetor 2011-Dhjetor 2016.

9.4.6. Statamentin e llogarisë bankare pranë Intesa SANPAOLO Bank, për shtetasin D.Ç për periudhën Janar 2010-Dhjetor 2014.

9.4.7. Statamentin e llogarisë bankare pranë BKT-së, për shtetasin D.Ç për periudhën Tetor 2013-Dhjetor 2016.

10. Gjatë hetimeve paraprake rezultoi se Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar më datë 15.07.2021 ka marrë vendimin “Për sekuestrimin e sendeve/dokumentave” pranë Bankës Amerikane të Investimeve sh.a. të Kontratës Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 29.09.2006 e lidhur ndërmjet Bankës Emporiki sh.a. dhe shtetasve Etleda dhe D.Ç, si dhe të gjithë praktikës përkatëse që lidhet me marrjen e huasë. Në zbatim të këtij vendimi nga policia gjyqësore është mbajtur procesverbali “Për sekuestrimin e dokumentave” mbajtur më datë 28.07.2021, duke u sekuestruar ndër të tjera dokumentacioni si më poshtë vijon:

10.1. Aplikim –Deklaratë për Kredi Hipotekore të bërë nga shtetësja Etleda Çiftja më datë 16.08.2006 pranë Emporiki Bank.

10.2. Kontratë Shitblerje me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006, të lidhur përpara Noteres L.K, me palë: **Shitësit:** R.K, S.K dhe E.K; **Blerës:** Etleda Çiftja. Objekti i kësaj kontrate është shitja e një sipërfaqe tokë arë prej 3440 m² në {***}, Kavajë që shitësat kanë në pronësi sipas Çertifikatës së Pronësisë lëshuar më datë 21.06.2006. Në këtë kontratë ndër të tjera thuhet se: “*Shitësit deklarojnë se me vullnetin e tyre të lire e të plotë ia shesin pronën me cilesit e sipershenuara bazuar në Ligjen 8337 datë 30.04.1998, blerësit Etleda Çiftja në **Shumen 50 000 EURO (pesedhjetë mijë EURO)** duke e lënë të lire dhe të papengueshme që nga ky moment. Blerësi Etleda Çiftja e pranon blerjen e pronës të cilën e mere, të lire dhe të papengueshme si dhe **likujdon totalisht me leke në dorë jashtë Zyres që redaktohet ky akt.**” Pjesë e praktikës është dhe Çertifikata e Pronësisë lëshuar më datë 15.09.2006 për këtë pasuri në emër të të pandehurës Etleda Çiftja bashkëlidhur se cilës gjendet edhe kartela e pasurisë, ku është pasqyruar shuma e paguar për blerjen e pasurisë në vlerën 300.000 (treqind mijë) Lekë. Me këtë provohet fakti se, Emporiki Bank ka qenë në dijeni të vlerës së blerjes me të cilin është regjistruar në ZVRPP Kavajë, pasuria e lënë si garanci Hipotekore.*

10.3. Kontratë Hipoteke me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 28.09.2006 të lidhur përpara Noteres L.K, me palë: BANKA “EMPORIKI – SHQIPERI” sh.a;

Hipotekuesi: Etleda Çiftja. Pjesë e praktikës është dhe Çertifikata e Pronësisë lëshuar më datë 15.09.2006 për këtë pasuri në emër të të pandehurës Etleda Çiftja bashkëlidhur se cilës gjendet edhe kartela e pasurisë, ku është pasqyruar shuma e paguar për blerjen e pasurisë në vlerën 300.000 (treqind mijë) Lekë dhe jo 50.000 Euro sikurse përmendet në kontratën e shitjes. Me këtë provohet fakti se, Emporiki Bank ka qenë në dijeni të vlerës se blerjes me të cilin është regjistruar në ZVRPP Kavajë, pasuria e lënë si garanci Hipotekore. Gjithashtu, Emporiki Bank është në dijeni të faktit që vlera e sendit që është vënë si garanci Hipotekore është 300.000 (treqind mijë) Lekë, pasi është pasqyruar në kartelën e pasurisë që i bashkëlidhet Çertifikatës “Për vërtetim hipotekimi të pasurisë së paluajtshme” lëshuar më datë 29.09.2006.

10.4. Kontratë Huaje me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 29.09.2006 të lidhur përpara Noteres L.K, me palë: **Huadhënës:** BANKA “EMPORIKI – SHQIPERI” sh.a; **Huamarrës:** Etleda Çiftja; dhe **Dorëzanës:** D.Ç, si dhe praktika që shoqëron atë ku përfshihet dhe siguracioni shëndetësor.

10.5. Vërtetim i datës 12.06.2006 lëshuar nga Garda e Republikës nëpërmjet të cilit vërtetohet se shtetasi D.Ç është efektiv i Gardës së Republikës me pagë 36.300 (tridhjetë e gjashtë mijë e treqind) lekë.

10.6. Vërtetim i lëshuar më Qershor 2006 nga Kompania {***}, ku vërtetohet se shtetësja Etleda Çiftja punon me profilin si juriste në kompani nga periudha Mars 2021 dhe në vazhdim, me pagë mujore 80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë. Kjo provohte dhe me Kontratën Individuale të Punës e lidhur më datë 01.03.2001.

10.7. Vërtetim i muajit korrik 2006 të lëshuar nga shoqëria {***} sh.p.k. për shtetasen Etleda Çiftja, ku rezulton se kjo shtetase është e punësuar si këshilltare juridike me kohë të pjesshme, pranë kësaj shoqërie, me pagë mujore 30 000 lekë.

10.8. Njoftim për shlyrjen totale të parakohshme të kredisë depozituar nga shtetësja Etleda Çiftja më datë 04.03.2020 pranë Bankës Amerikane të Investimeve.

10.9. Deklaratë Noteriale “Për fshirje hipoteke” me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 28.04.2020 lëshuar nga BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SH.A, për heqjen e hipotekës mbi sendin e paluajtshëm tokë armë të vendosur si garanci nga e pandehura Etleda Çiftja.

10.10. Në përfundim të hetimit administrative nuk rezulton të jetë marrë ndonjë masë administrative ndaj të pandehurës Etleda Çiftja. Kështu, në shkresën Nr. {***} Prot., datë 14.04.2022 Inspektoriat i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me lëndë: “Kthim përgjigje” thuhet shprehimisht: “Në vijim të shkresës tuaj nr. 3018 prot., (E.M) datë 12.04.2022, ardhur dhe protokolluar më datë 13.04.2022, bashkëlidhur ju vëmë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar për subjektin Etleda Çiftja. Gjithashtu ju bëjmë me dije se ILDKPKI nuk ka marrë masa administrative për këtë subjekt.”.

11. Me shkresën Nr. {***}, datë 10.03.2022 të Bankës Amerikane të Investime, drejtuar Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar konfirmohet dokumenti: Raport Vlerësimi “Tokë me sipërfaqe 3440 m2, {***} Kavajë”, datë 6 Shtator 2006 me Porositës: Emporiki BANK; Pronari: z.R.K; dhe Klienti:

znj.Etlenda Çiftja. Sipas këtij raporti **vlera e tregut të lirë të kësaj prone është 48 000 Euro**, ndërsa **vlera e shitjes së detyruar ose vlera e likuidimit është 38 500 Euro**.

12. Gjithashtu, gjatë hetimeve paraprake rezulton se Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar më datë 28.04.2022 ka marrë vendimin “Për sekuestrimin e sendeve/dokumentave” pranë arkivës noteriale të Noteres E.K, të akteve si vijon: **i)** praktika e plotë e Kontratës së Sipërmarrjes Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 21.08.2003 me palë: Shoqëria “{***}” sh.p.k si sipërmarrës dhe R.K si porositës; **ii)** praktika e plotë e aktit “Zgjidhje kontrate” datë 08.09.2006, mes shoqërisë “{***}” sh.p.k dhe shtetasve M.K, M.Xh, V.H, M.M dhe I.K; **iii)** praktika e plotë e Kontratë Sipërmarrje me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 08.09.2006 me sipërmarrës shoqëria “{***}” sh.p.k dhe porositës Etleda dhe D.Ç; **iv)** praktika e plotë e Kontratë Shitblerje me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 30.11.2016 me shitës Shoqëria “{***}” sh.p.k dhe blerës shtetasit Etleda dhe D.Ç, si dhe regjistri noterial nëse këta të fundit kanë kryer ndonje veprim tjetër noterial. Nga procesverbali “Për kqyrjen e dokumenteve” mbajtur më datë 29.04.2022 rezultuan të njëjta akte që vetë e pandehura Etleda Çiftja i ka dorëzuar si prova, të cilat janë cituar më sipër.

13. Gjithashtu, gjatë hetimeve paraprake rezulton se Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar më datë 22.04.2022 ka marrë vendimin “Për sekuestrimin e sendeve/dokumentave” pranë Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, Dega Kavajë, dokumentat në origjinal si më poshtë vijon: **i)** Praktika e plotë e regjistrimit të pasurisë në emër të familjes bujqësore të shtetasit R.K me nr. {***}, vol {***}, faqe {***}, ZK nr. {***}, adresa e pasurisë {***}, Kavajë, lloji arë, sipërfaqe totale 3440 m²; **ii)** Praktika e plotë e regjistrimit në emër të shtetasës Etleda Çiftja, pasurisë me nr. {***}, vol {***}, faqe {***}, ZK nr. {***}, adresa {***} Kavajë, lloji i pasurisë arë, sipërfaqe totale 1450 m². Me procesverbalin “Për sekuestrimin e dokumentave” mbajtur më datë 16.05.2022 është sekuestruar dokumentacioni origjinal: Akti i marrjes së tokës në pronësi Nr. {***} datë 1995 lëshuar nga Komuna Kryeviidh me sipërfaqe 27,191 m², familjes së R.T.K.

14. Me shkresën Nr. {***} Prot., datë 09.07.2021 hyrje në prokurori, të noterit Gj.K është përcjellë kopje kontrate shitblerje si vijon: Kontrata e Shitblerjes Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë **10.07.2006** për shitblerjen e pasurisë me nr. {***} vol {***} faqe {***}, sip 3440 m² me shitës R.K, S.K dhe E.K dhe blerës Etleda Çiftja, në vlerën 300 000 lekë. Nga kqyrja e regjistrimit të veprimeve noteriale të noterës L.K rezulton se kontrata me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., është regjistruar në këtë regjistër në datë 06.07.2006. Pas sekuestrimit të praktikës së kontratës së shitblerjes si më sipër cituar pranë noterës, rezulton se gjendet e njëjta kontratë, me vlerë 300 000 lekë, por me datë 06.07.2006, të korrigjuar. Gjithashtu, është sekuestruar pranë **ASHK-së** praktika e regjistrimit të pasurisë me nr. {***} vol {***} faqa {***}, dhe konstatohet se gjendet Kontrata me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë **10.07.2006** e korrigjuar data dhe çmimi i shitjes është 300 000 lekë. Kjo praktikë regjistrimi ka referencë 00000099.

14.1. Gjithashtu, është sekuestruar pranë noterës edhe praktika e Kontratës së Shitblerjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 06.07.2006, por me datë të

korrigjuar, lidhur ndërmjet shtetasve R.K, S.K dhe E.K me shtetasen Etleda Çiftja për shitblerjen e pasurisë me Nr. {***}, vol {***} faqa {***}, me sip 1450 m², në vlerën 300 000 lekë. Nga kqyrja e regjistrimit të veprimeve noteriale edhe kjo kontratë rezulton e pasqyruar në regjistrin e veprimeve noteriale më datë 06.07.2006. Po ashtu, është sekuestruar pranë ASHK-së edhe praktika e regjistrimit të pasurisë me nr. {***} vol {***} faqa {***}, dhe konstatohet se gjendet kontrata me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006 e korrigjuar data dhe çmimi i shitjes është 300 000 lekë. Kjo praktikë regjistrimi ka referencë 00000194.

15. Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se, më datë 29.09.2006, shtetësja Etleda Çiftja njofton bankën Emporiki se ka tërhequr huanë prej 35 000 euro. Nga statement bankar i Bankës Emporiki, rezulton se më datë 29.09.2006 është kredituar në llogarinë bankare me nr {***} shuma e huasë e marrë pranë Bankës Emporiki në vlerën 35 000 euro. **Më datë 29.09.2006 kjo shtetase, kalon për llogari të shtetasës S.K shumën prej 34 000 euro me përshkrimin "Për shlyerje detyrimi për blerje toke".** Pjesa tjetër e ngelur në këtë llogari konstatohet se ka pasur destinacione për pagesa të tjera për efekt të kësaj kredie si pagesë primi të policës së sigurimit, shpenzime vlerësimi për pronën e ofruar si kolateral, shpenzime noteriale për dokumentacionin e kredisë, shpenzime të hipotekës për regjistrimin e barrës mbi pronën, shpenzime të zyrës ligjore ligjore për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për kredinë, interes i depozitës me afat, duke shkuar më datë 30.10.2006 kjo llogari në gjendjen zero. Pra, rezulton sikur shtetasës S.K i është bërë një pagesë prej 4 182 680 lekë të cilat e kanë burimin nga një kredi e marrë pranë ish Bankës Emporiki (34 000 X 123.02 kursi i këmbimit më datë 29.09.2006) ndërkohë që nuk rezulton të jetë paguar pjesa e mbetur nga 50 000 euro (50 000 euro X 123.26 lekë kursi i këmbimit valutor më datë 10.07.2006 = 6 163 000 lekë) por as pagesa për parcelën tjetër të tokës me nr. {***} në vlerën prej 300 000 lekësh. **Po më datë 29.09.2006 këto para janë tërhequr nga shtetësja S.K, në vlerën 33 900 euro.** Përveç kësaj pagese, nuk evidentohet të jetë kryer ndonjë pagesë tjetër në drejtim të shtetasve K. Gjithashtu, nuk konstatohet të jetë kryer ndonjë pagesë as për parcelën tjetër të tokës, atë me nr. {***}.

16. Sipas analizës financiare të bërë nga prokuroria rezulton se, nëse do të përlllogarisnim të ardhurat dhe shpenzimet, referuar faktit se për sipërfaqet e tokave arë nuk është paguar asnjë lek, pasur parasysh pretendimet mbi të gjithë të ardhurat e shtetasës Etleda Çiftja, pra edhe të ardhurat e deklaruara sipas saj në një zyrë avokatie dhe pranë shoqërisë {***} sh.p.k., dhe kredinë e marrë, duke zbritur shpenzimet për jetesë, shpenzimet për blerje pasurish (apartament dhe makinë) dhe mobilim, por duke mospërlllogaritur vlerën e deklaruar për blerjen e tokave, sipas pretendimeve të palëve, rezulton se familja Çiftja, në vitin 2006, e ka mbyllur me një kursim prej 278 850 lekë dhe nëse mbajmë parasysh kursimet e mundshme të viteve të mëparshme, shkon në një pozitivitet prej 4 570 133 lekë (pasur parasysh shpenzimet me normen e inflacionit). Ky rezultat të çon sipas prokurorisë drejt allogjikës së marrjes së kredisë për blerjen e apartamentit, i cili shkon në një vlerë të përafërt. Nëse do të përlllogarisnim shpenzimet sipas të dhënave jo të plota të INSTAT, do të rezultonte se shtetësja Etleda e ka mbyllur vitin 2006 me një kursim prej 716 226 lekë (nëse është paguar nga {***} dhe av. S.D)

dhe në total në përmbledhje edhe të kursimeve të viteve të mëparshme me një kursim të mundshëm prej 7 139 548 lekë. Ky rezultat del i pakuptimte sipas prokurorisë dhe e bën allogjik marrjen e një kredie. Nëse do të zbrisnim shumat që pretendohet se janë marrë nga shoqëria {***} dhe Av.S. D, pasi nuk rezultojnë realisht të dokumentuara dhe as të vërtetuara se në çfarë periudhe janë marrë, kursimet e mundshme do të rezultojnë në një vlerë prej 4 023 858 lekë (pasur parasysht shpenzimet me normen e inflacionin që sërish përafrohet me vlerën e apartamentit dhe shtetesja Etleda nuk ka pasur asnjë arsye përse të merrte kredinë në vlerën e sipërcituar. Nëse do të përlllogarisnim shpenzimet sipas të dhënave jo të plota të INSTAT, do të rezultonte se shtetesja Etleda e ka mbyllur vitin 2006 me një kursim prej 476 226 leke (nëse nuk është paguar nga {***} dhe av.S.D) dhe në total në përmbledhje edhe të kursimeve të viteve të mëparshme me një kursim të mundshëm prej 6 238 662 lekë. Ky rezultat del i pakuptimte sipas prokurorisë dhe e bën allogjik marrjen e një kredie.

17. Gjatë hetimeve paraprake është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetesja L.K, e cila kur është pyetur lidhur me praktikën e lidhjes së Kontratës së Shitblerjes për pasurinë tokë arë, me 3440 m2, e ndodhur në {***} Kavajë, ka deklaruar shprehimisht se: *“Unë jam Luljeta Kongoli, për periudhën 1998 - 2012 kam ushtruar profesionin e noteres. Në lidhje me kontratën e shitblerjes të pasurisë nr. {***} vol {***} faqe {***} me adresë {***}, Kavajë nr {***} prot, nr {***} kol, palët kanë qenë prezent në nënshkrimin e kontratës. Kontrata është nënshkruar në datë 6 Korrik 2006, me "palë shitëse" shtetasit, R.K, S.K dhe E.K dhe "palë blerëse" Shtetasen Etleda Çiftja (Kaja) për pasurinë, tokë arë sipërfaqja 34401112, e ndodhur në {***} Kavajë, zona kadastrale {***}, vol {***}, faqe {***}, zotëruar nga R.K. Sipas kontratës, çmimi i shitjes është 300,000 (treqintë mijë) lekë. **Pyetje:** Ju lutem, më thoni sa është cmimi i shitjes së pronës 3440 m2, që palët ranë dakort me vullnetin e tyre të lirë. **Përgjigje:** Unë për shkak të kohës, duke qenë se kanë kaluar vite, nuk e mbaj mend, por referuar aktit, kontratës së Shit-Blerjes nr {***} rep, nr {***} kol., datë 06 Korrik që kam përpara, cmimi i shitjes së pronës, tokë arë me sip. 3440 m2 është 300,000 (treqintë mijë) lekë. **Pyetje:** Pranë A.SH.K dega Kavajë, jnë tërhequr dokumentat origjinle të dosjes që i përket pasurisë tokë arë me sip 3440 m2, zona kadastrale {***}, vol {***}, faqe {***}. Ne dosje gjendet kontrata e Shit - Blerjes Nr. {***} rep nr {***} Kol, e datës 10 Korrik 2006 me cmim të kontratës 300,000(treqintë mijë) lekë. A është nënshkruar kjo kontratë në zyrën tuaj? **Përgjigje:** Po, kontrata është nënshkruar në zyrën Time.*

Pyetje: Kush është arsyeja që kontrata e sekuestruar pranë zyrës tuaj ka datën 06 Korrik 2006 dhe kontrata e sekuestruar pranë A.SH.K Dega Kavajë ka datën e nënshkrimit 10 Korrik 2006, pra kanë data të ndryshme? **Përgjigje:** Datat janë të shkruajtura me dorën time në të dyja kontratat. Kontrata e dalë nga arkiva ime, është e korigjuar sepse e kam ballafaquar me regjistrin, pasi në rregjistrin nr {***} rep dhe nr {***} kol i referohet datës 6 Korrik 2006. **Pyetje:** A janë vendosur datat e kontratave të sekuestruara pranë zyrës notërijale dhe ASHK Kavaje nga JU respektivisht data 6 dhe data 10 Korrik 2006? **Përgjigje:** Datat janë të shkruajtura me dorën time në të dyja kontratat. Kontrata e dalë nga arkiva ime, është e korigjuar sepse e kam ballafaquar me

regjistrin, pasi në rregjistër nr {***} rep dhe nr {***} kol i referohet datës 6 Korrik 2006.

Pyetje: Pranë Bnkës Amerikane te Investimeve, janë sekuestruar dokumentat e dosjes në lidhje me kontratën e huasë nr, {***} dhe nr kol. {***} (baka Emporiki - Shqipëri Sh.A). Huaja është marrë nga Etleda Çiftja për blerjen e pasuri se, sipas kontratës së Shit - Blerje nr {***} prot, nr {***} kol, tokë arë sip. 3440 m2. (Noteres i tregohet kontrata). A është hartuar kjo kontratë në zyrën tuaj noteriale? **Përgjigje:** Po, kjo kontratë është nënshkruar në zyrën time noterjale. **Pyetje:** Kontra e Shit - Blerjes nr {***} prot, nr {***} kol për pasurinë tokë arë sip. 3440 m2, depozituar pranë Bankës Emporiki - Shqipëria Sh.A, ka cmimin 50,000 euro, cmim i cili ndryshon ngacmimi i kontratës depozituar pranë A.SH.K - Dega Kavajë dhe Kontratës së Sekuestruar pranë zyrës tuaj i cili është 300,000 (treqintë mijë) lekë. Ju lutem na tregoni arsyet se pse cmimi për të njëjtën pronë ndryshon? **Përgjigje:** Me sa mbaj mend unë, pasi është nënshkruar kontrata me cmim blerje 300, 000 (treqintë mijë) lekë, palët me vullnetin e tyre ndryshuan çmimin, duke qenë se kjo marrëdhënie ishte midis familjarëve, bleresi Etleda Çiftja (Kaja) është bijë e palës shitëse R. dhe S.K. Cmimi 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro per pronën, u ndryshua po atë ditë, me mirëkuptim të palëve në kontratë të cilët e nënshkruan përsëri, dhe me sa mbaj mend ky ndryshim u bë sepse banka nuk ja pranonte, këtë pronë si kolateral me çmimin 300,000 (treqintë mijë) lekë. **Pyetje:** Në dijeninë tuaj duke qenë se kontrata e Shit - Blerjes nr {***} prot, nr {***} kol, për pasurinë tokë arë sip. 3440 m2, të cilës i është ndryshuar çmimi nga 300,000 (treqintë mijë) lekë në 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro, kush ka qenë arsyeja? **Përgjigje:** Me sa më kujtohet ka qenë banka e cila nuk ka pranuar çmimin 300,000 (treqintë mijë) lekë si kolateral. **Pyetje:** Ju lutem na thoni, burimin e këtij informacioni. **Përgjigje:** Unë kam qenë notere e bankës Emporiki që nga themelimi i saj dhe këtë informacion e kam marrë nga banka.”. Këto fakte provohen me procesverbalin “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale” mbajtur më datë 29.09.2021.

18. Gjatë hetimeve paraprake është pyetur në cilësinë e personi që ka dijeni për veprën penale shtetësjë M.Xh, lidhur me Kontratën e Sipërmarrjes të datës 21.08.2003 të lidhur midis shoqërisë “{***}” sh.p.k dhe babait të saj të ndjerë R.K, shumën e parave të paguara, periudhën kur janë paguar këto pagesa, mënyrën e pagesës dhe nëse është paguar e gjithë shuma e rënë dakort për blerjen e apartamentit, duke deklaruar shprehimisht se: “Me sa më kujtohet mua, babai im kish prenotuar një apartament tek shoqëria {***} sh.p.k me sipërfaqe rreth 15 m2 bashkë me sipërfaqet e përbashkët, në vitin 2003 dhe pagesat i ka kryer me këste cash në dorë sipas kontratës së lidhur. Nuk di të them periudhën kur janë kryer pagesat e kësteve por në bindjen time afatet e parashikuar në kontratë janë respektuar. Me sa di unë janë paguar të gjithë këstet si është rënë dakort sipas kontratës por kësti i fundit nuk është paguar me kushtin për tu paguar në momentin e regjistrimit të pronës, por shuma e pa paguar e këstit të fundit se sa ka qenë nuk më kujtohet.

Pyetje: Në lidhje me aktin e "zgjidhje kontratë" datë 08.09.2006, akt ku është dakortësuar zgjidhja e kontratës dhe kalimi i apartamentit tek shtetasit D.Ç dhe Etleda

Çiftja, a ju është paguar shuma e parave të paguar për prenotimin e apartamentit, nëse po, sa ka qenë shuma e paguar, në çfarë mënyre është paguar dhe kur është paguar? **Pëgjigje:** Duke qenë se babai im në Mars të vitit 2006 ndërroi jetë dhe kishim një akt trashëgimie me 5 persona (M.K, M.Xh, V.H, M.M dhe I.K) dhe për të mos krijuar probleme në lidhje me tjetërsimin e kësaj prone kemi firmosi të 5 trashëgimtarët. Në lidhje me pagesën e kryer nga blerësit, më kujtohet se shuma është likuiduar cash pasi blerësit kanë marrë një kredi, data nuk më kujtohet por di të them se shuma është marrë pas nënshkrimit të "zgjidhje kontrate", me pretendimin e blerësve që u duhej ky akt për ta depozituar në bankën ku do merrnin kredinë. Në lidhje me shumën është paguar nga blerësit aq sa ka qenë e shënuar në kontrate por pa këstin e fundit. **Shuma e parave është marrë nga vëllai im.** Këto fakte provohen me procesverbalin “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale” mbajtur më datë 13.04.2022.

18.1. Gjithashtu, është ripyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetësja **M.Xh**, lidhur me faktin se si është njohur me shtetasen Etleda Çiftja, si ka lindur ideja e blerjes së shtëpisë të pronotuar nga babai i saj, si dhe çfarë është diskutuar në lidhje me likuidimin e pagesave të kryerja nga babai i saj i ndjerë. Kjo shtetase ka deklaruar shprehimisht se: “**Në vitin 2006 kam punuar si kontabiliste e jashtme, pranë shoqërisë {***}, shoqëri greke ku shtetasja Etleda Çiftja punonte si juriste. Si dhe jam shprehur, me ndërrimin jetë të babait, shtëpia e prenotuar ishte vendosur për tu shitur. Në ambientet e shoqërisë {***}, jam shprehur që kisha shtëpinë e babait për të shitur. Etleda ka shprehur interes për ta parë apartamentin, dhe pasi e ka parë, është rënë dakort për ta blerë. Me kujtohet se apartamenti ka qenë i pa dorëzuar nga shoqëria, jo i përfunduar plotësisht. Etledës i ka pëlqyer shtëpia dhe më ka kërkuar favor, duke mos e plotësuar dot shumën e plotë për vleftën e shtëpisë do duhej të merrte një kredi pranë bankës, por për këtë më kërkoi të nënshkruanim paraprakisht aktine revokimit i cili do ti duhej ta paraqiste në bankë. Me marrjen e kredisë shlyeu totalisht vleftën e shtëpisë. Si dhe kam shprehur Etleda ka paguar 42,864 USD, ndërsa këstin e fundit shoqërisë {***} sh.p.k babai nuk ja kish paguar. Me sa më kujtohet në momentin e marrjes së kredisë prej shtetasës Etleda pranë bankës, jemi shlye totalisht, paratë na janë dhënë në dorë (cash).**” Këto fakte provohen me procesverbalin “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale” mbajtur më datë 20.05.2022.

19. Gjatë hetimeve paraprake është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetësja **M.K**, e cila lidhur me kalimin e apartamentit tek shtetasit D.Ç dhe Etleda Çiftja, ka deklaruar shprehimisht: “**Me sa më kujtohet, pas vdekjes së bashkëshortit, për arsye ekonomike, prishëm kontratën e porosisë me shoqërinë {***} sh.p.k. Për zgjidhjen e kontratës së porosisë së bashku me fëmijët e bashkëshortit kemi nënshkruar zhjidhjen e kontratës. Me sa më kujtohet shuma e paguar për apartamentin është paguar me me para në dorë nga blerësit të cilëve ju është kaluar apartamenti, paratë e apartamentit të shitur vajzat e bashkëshortit tim dhe unë ramë dakort që ti kalonin (merrte) djali i bashkëshortit tim I.K.** Shuma e saktë nuk më kujtohet, por mund të them se blerësit e apartamenti kanë paguar shumën që ne kishim paguar shoqërinë

{***} sh.p.k. Si periudhë pagese nuk më kujtohet, por di të them që shuma është paguar ndoshta 1 muaj pas vdekjes së bashkëshortit tim i cili ka ndërruar jetë në Mars të po atij viti dhe në momentin e nënshkrimit të zgjidhjes së kontratës paratë kanë qenë të paguara.”. Këto fakte provohen me procesverbalin “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijani për veprën penale” mbajtur më datë 13.04.2022.

20. Gjatë hetimeve paraprake është pyetur në cilësinë e personit që ka dijani për veprën penale, shtetasi I.K, i cili ka deklaruar shprehimisht se: “Me sa më kujtohet babai donte që kursimet tona ti investonte dhe për këtë arsye pronotoi një apartament tek shoqëria {***} sh.p.k rreth 75 m2, pallati do të ndërtohej tek vila Gold-i por çmimi realisht nuk më kujtohet pasi unë isha i ri dhe për arsye se ka kaluar shumë kohë. Pagesat janë brë cash me para në dorë shoqërisë {***} sh.p.k por unë nuk e di sa është paguar dhe datën apo periudhën kur janë paguar paratë. **Pyetje:** Në lidhje me aktin e "zgjidhje kontratë" datë 08.09.2006, akt ku është dakortësuar zgjidhja e kontratës dhe kalimi i apartamentit tek shtetasit D.Ç dhe Etleda Çiftja, a ju është paguar shuma e parave të paguar për prenotimin e apartamentit, nëse po, sa ka qenë shuma e paguar, në çfarë mënyre është paguar dhe kur është paguar? **Përgjigje:** Pas vdekjes së babait në vendosëm të shisnim apartamentin e prenotuar dhe shuma e parave që do të merrej nga shitja do më kalonte mua. Sa është shuma e parave nuk më kujtohet por di të them që është kryer cash (para në dorë) nga blerësit e apartamenti pas zgjidhjes së kontratës me shoqërinë {***} sh.p.k . **Më kujtohet se paratë janë dhënë nga blerësit pas zgjidhjes së kontratës, dhe në mirëbesim pasi ata kanë marrë kredi në bankë, por duhet të ketë qenë një perudhë e shkurtër jo më shumë se 1 muaj. Dua të shtoj se për kohën kur është nënshkruar zgjidhja e kontratës kam qenë i ri dhe me këtë çështje është marrë motra e madhe M.”. Këto fakte provohen me procesverbalin “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijani për veprën penale” mbajtur më datë 13.04.2022.**

21. Gjatë hetimeve paraprake është pyetur në cilësinë e personit që ka dijani për veprën penale shtetësja M.M, e cila lidhur me kalimin e apartamentit tek shtetasit D.Ç dhe Etleda Çiftja, ka deklaruar shprehimisht: “Me sa mbaj mend kemi firmosur për të prishur kontratën me shoqërinë {***} sh.p.k dhe apartamenti ju kalua blerësit i cili duhej të paguante shumën të cilën babai kish paguar për apartamentin. Emrin e blerësit nuk i di dhe nuk më kujtohet, nuk më kujtohet sa ka qenë shuma e paguar nga babai im për apartamenti si dhe se sa është shuma e paguar nga blerësi ndaj nesh. **Di të them që paratë janë paguar cash në dorë dhe i ka marrë vëllai im I ndërsa koha kur janë paguar nga blerësit nuk më kujtohet në ishte para apo pas nënshkrimit të kontratës.”. Të njëjtin deklaram ka dhe shtetësja V.H trashëgimtarja e të ndjerit R.K. Këto fakte provohen me procesverbalet “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijani për veprën penale” mbajtur më datë 13.04.2022.**

22. Gjatë hetimeve paraprake është pyetur në cilësinë e personit që ka dijani për veprën penale shtetasi J.Z, i cili ndër të tjera ka deklaruar se emri i shtetases Etleda Çiftja nuk i kujton asgjë. Referuar vërtetimit mendon se është lëshuar nga shoqëria e tyre dhe duket i nënshkruar nga babai i tij, administratori i shoqërisë Th.Z, pasi mesa sheh nënshkrimi/firma i ngjan që është e tija. Sqaron se që nga krijimi i shoqërisë në vitin

1994 dhe deri rreth vitit 2019- 2020 në krye të aktivitetit ka qenë babai i tij Th., por ai është tërhequr nga aktiviteti i kësaj shoqërie për arsye moshe si dhe për arsye të shëndetit të rënduar. Aktualisht merr mjekim për demencë (alzhaimer). Roli i tij ka qenë kryesisht me shitjet e apartamenteve dhe gjetjen e shesheve të ndërtimit. Konsulenca juridike është marrë nga studio ligjore, por në varësi të ngarkesës që ka pasur aktiviteti, kanë punësuar edhe persona ndihmës në zyë. Për këshilla të karakterit ligjor mesa i kujtohet i janë drejtuar noteres M.Sh, ndërsa emra personash të punësuar nuk i kujtohen. Në bindjen e tij, personat e punësuar pranë kësaj shoqërie, janë regjistruar, por në vitin 2006 nuk është i sigurtë nëse kanë pasë nënshkruar kontratë me punëmarrësit. Në vitet e mëhershme mesa di ai, nuk ka qenë detyrim që pagesat të kryheshin në bankë dhe beson se janë bërë me para në dorë. Në vërtetimin e treguar, firma i ngjan me firmën e babait të tij, vula është e shoqërisë, por logoja në krye të vërtetimit nuk i kujtohet. Për periudhën 2004 - 2007 nuk disponojnë dokumenta të ruajtura të kësaj natyre.”. Këto fakte provohen me procesverbalin “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale” mbajtur më datë 04.05.2022.

22.1. Gjithashtu, gjatë hetimeve paraprake është ripyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetësi **J.Z**, i cili ka deklaruar shprehimisht se: “Pasi jam larguar nga zyra juaj, klikova në internet për të marrë informacion në lidhje me shtetasen Etleda Çiftja për të cilën u pyeta. Nga fotot e shfaqura në internet u kujtova se shtetasen ne fjalë e njihja me emrin Leda. Me sa me kujtohet ne harkun e viteve 2001 - 2006 shoqëria {***} sh.p.k ka patur një zyrë me qira (per rreth 2-3vjet) pranë ndërtesës Gjergji Center dhe në të njëjtin kat kish zyrat dhe shoqëria {***}. Me shtetasen që si e përmenda më sipër quhel Leda jemi njohur duke qenë se shoqëria {***} sh.p.k ka bashkëpunuar në ato vite me shoqërinë {***}, nga e cila ka marrë punë ndërtimore me nën kontraktim (ndërtime bazamentesh antena celulare).Shtetasja në fjalë bashkëpunonte me kompaninë {***}, por unë nuk kam dijeni për pozicionin e saj. Kemi patur komunikim me shtetasen në fjale dhe gjykoj nga ky raport bashkëpunimi, im at mund të ketë kërkuar shërbimin apo ndihmën e shtetases Etleda Çiftja. Në lidhje me vërtetimin e lëshuar dhe me pagesën e deklaruar, informacion më të saktë do mund të jepte babai im Th.Z, i cili ka qenë administrator dhe nënshkrues i vërtetimit, por ashtu si e shpreha edhe në deklaratën e parë, ai është në gjëndje të pamundur shëndetësore dhe mendore, pasi vuan nga demenca (alzhaimer).”. Këto fakte provohen me procesverbalin “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale” mbajtur më datë 10.05.2022.

23. Gjatë hetimeve paraprake është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetasi **R.K**, i cili ka deklaruar shprehimisht se: “Etleda Çiftja është ime bijë, ne si anëtarë të kooperativës Kryevidh Kavajë, gëzonim të drejtën e pronës në bazë të ligjit 7501. Kështu në abzë të ligjit 7501 në na takonte nga 5000 m2 për anëtar familje. Vajza irne Etleda është martuar në Tiranë, lindi një fëmijë dhe kishte nevoja për një apartament. Bëmë kontrat akt shitje të këtyre dy parcelave për efekt kredie. Akt shit - blerja u bë tek noterja, ne firmosëm duke e ditur se kjo tokë e disponueshme i takonte vajzës në bazë të ligjit. Prona, toka bujqësore që është dhënë në bazë të ligjit nr 7501 ka kaluar në emrin e kryefamiliarit, dhe sipërfaqja totale që kemi përfituar është rreth

25,000 m2 për të cilat disponoj certifikatë pronësie. Aktualisht zotroj 16,450 m2 në {***}, 1,500 m2 tek {***}, plus 1,333 m2 në {***}, 207 m2 pemtore. **Meqënëse vajza kërkonte kredi, u mblodhëm bashkë me pjestarët e familjes, ramë në kompromis që bijës time Etleda ti japim këtë sip. toke që disponojmë (sip. 3440 m2 tek {***}) dhe 1,450 m2 tek {***}).** **Pyetje:** Sa fëmijë keni? **Përgjigje:** Unë kam 3 fëmijë, 2 vajza, Etleda dhe O. si dhe 1 djalë i quajtur E.

Pyetje: Nga shqyrtimi i dokumentave na rezulton që keni kryer 3 kontrata shit - blerje me blerëse shtetasen Etleda Çiftja, për çfarë pasurish bëhet fjalë dhe a janë nënshkruara prej jush këto kontrata? (I tregohen; kontrat shit - blerje nr {***} rep, nr {***} kol, pasuria tokë arë me sip 3440 m2, nr pasurie {***}, vol {***} faqe {***}, me adres {***} me çmim shitje 300,000 lekë, kontrat shit - blerje nr {***} rep, nr {***} kol, pasuria tokë arë me sip 3440 m2, nr pasurie {***}, vol {***} faqe {***}, me adres {***} me çmim shitje 50,000 euro; kontrat shit - blerje nr {***} rep, nr {***} kol, pasuria tokë arë me sip 1450 m2, nr pasurie {***}, vol {***} faqe {***}, me adres {***} me çmim shitje 300,000 lekë. A janë nënshkruar nga Ju, dhe çfarë mund të na thoni referuar çmimit të shitjes? **Përgjigje:** Nënshkruar janë nga dora ime, meqë ishte për efekt kredie nuk u interesova për çmimin për arsye se kontratën me sa më kujtohet e kemi nënshkruar për shkak të bankës për të marrë kredi. Unë nuk kisha interes nga shitja e pronës për arsye se vajzës time i takonte ligjerisht toka, unë nuk do merrja para dhe si e thashë më sipër nuk isha i interesuar për çmimin dhe nuk më kujtohet saktësisht se çfarë ka ndodhur, por di që është bërë për shkak të kredisë që duhej marrë për blerjen e apartamentit. **Toka është dhënë pa pagesë, unë lekë skam përfituar.**

Pyetje: Në lidhje me pasuritë e shituar, a jeni paguar dhe në çfarë forme janë marrë paratë, me bankë apo në dorë (cash)? **Përgjigje:** Si e thashë më sipër nuk kam marrë asnjë lekë nga shitja e këtyre pronave, as me bankë as me para në dorë (cash). **Pyetje:** Ju thatë që i keni dhënë sipërfaqet e tokës 3,440 m2 dhe 1450 m2 vajzës tuaj Etleda pa pagesë, pa përfituar para prej saj, po fëmijëve të tjerë a i keni dhuruar prona apo pasuri? **Përgjigje:** Fëmijëve të tjerë aktualisht nuk u kam ndarë prona, sepse nuk u janë dashur, kur të vijë koha do jua ndaj me noter, kur të kenë nevojë. **Pyetje:** Sipas të dhënave të marra nga Emporiki Bank rezulton që në 20.09.2006 shtetasja Etleda Çiftja, i ka kaluar 34,000 euro shtetasës S.K, me përshkrimin "kamlim për shlyerje detyrimi për blerje toke", shumë që është tërhequr (33,900 euro) po në këtë datë nga shtetasja S.K. Çmund të na thoni për këtë transaksion, pse ka ndodhur? (I tregohet ekstrakti i Emporiki Bank i llogarisë nr {***} në emër të S.R.K. **Përgjigje:** Për këtë fakt unë nuk kam dijeni, dhe nuk kam çfarë të shtoj. ". Këto fakte provohen me procesverbalin "Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale" mbajtur më datë 19.04.2022.

24. Gjithashtu, gjatë hetimeve paraprake është pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale shtetasja S.K, e cila ka deklaruar shprehimisht se: "Etleda Çiftja është vajza jonë. Me sa më kujtohet Etleda donte të merrte një shtëpi pasi kish djalin një vjeç dhe në atë kohë ishte me qira. Për blerjen e apartamenti i nevojitej një kredi bankare pasi nuk i kishin lekët për të blerë shtëpinë. Ne si familje në bazë të ligjit 7501 kemi marrë sipërfaqe toke rreth 5000 m2 për frymë. Edhe Etledës si bija jonë i takonte të

merrte 5,000 m2 nga toka që ne kemi marrë në bazë të ligjit 7501. Si familje ne kemi marrë rreth 25 mijë - 27 mijë m2 tokë. **Shkuam tek noterja për të firmosur kontratën që do ti shërbente Etledës për të marrë tokën me të cilëndo merrte kredi në bankë. Me sa mbaj mend unë kam enë dy ose tre herë te noterja, por saktësisht nuk mbaj mend. Ne kemi nënshkruar kontratën vetëm për kredinë e gocës. Pyetje: Sa fëmijë keni?** **Përgjigje:** Unë kam 3 fëmijë, 2 vajza, Etleda dhe O. si dhe 1 djalë i quajtur E.

Pyetje: Nga shqyrtimi i dokumentave na rezulton që keni kryer 3 kontrata shit - blerje me blerëse shtetasen Etleda Çiftja, për çfarë pasurish bëhet fjalë dhe a janë nënshkruara prej jush këto kontrata? (I tregohen; kontrat shit - blerje nr {***} rep, nr {***} kol, pasuria tokë arë me sip 3440 m2, nr pasurie {***}, vol {***} faqe {***}, me adres {***}, Kavajë me çmim shitje 300,000 lekë, kontrat shit - blerje nr {***} rep, nr {***} kol, pasuria tokë arë me sip 3440 m2, nr pasurie {***}, vol {***} faqe {***}, me adres {***}, Kavajë me çmim shitje 50,000 euro; kontrat shit - blerje nr {***} rep, nr {***} kol, pasuria tokë arë me sip 1450 m2, nr pasurie {***}, vol {***} faqe {***}, me adres {***} me çmim shitje 300,000 lekë. A janë nënshkruar nga Ju, dhe çfarë mund të na thoni referuar çmimit të shitjes? **Përgjigje:** Nënshkruar janë nga dora ime. Nuk me kujtohet saktësisht se çfarë ka ndodhur, kam firmosur çfarë më kanë vënë përpara. Firmën e kam hedhur me qëllim për të ndihmuar vajzën ime, Etledën të merrte kredi. **Kontratat janë firmosur përpara noteres dhe nuk më kujtohet pse janë bërë tre kontrata pasi unë mbaj mend që 2 kontrata kemi nënshkruar pasi dy pasuri i janë dhënë Etledës, si pjesë të vetën.**

Pyetje: Në lidhje me pasuritë e shituar, a jeni paguar dhe në çfarë forme janë marrë paratë, me bankë apo në dorë (cash)? **Përgjigje:** Pasuritë, Sipërfaqet e tokës nuk i janë shitur Etledës, pasi asaj i takonte në bazë të ligjit 7501, në si prindër nuk kemi shitur as nuk kemi marrë para, por e bëmë për të mbështetur gocën të merrte kredi. **Pyetje:** Ju thatë që i keni dhënë sipërfaqet e tokës 3,440 m2 dhe 1450 m2 vajzës tuaj Etleda pa pagesë, pa përfitur para prej saj, po fëmijëve të tjerë a i keni dhuruar prona apo pasuri? **Përgjigje:** Pronat, sipërfaqet e tokës janë në emërin e R., bashkëshortit tim, vajza jonë Etleda kishte nevojë të merrte kredi dhe kjo ishte arsyeja që i dhamë pjesën e vet, pronat që do tu jepen fëmijëve të tjerë janë në emër të Rustemit, aktualisht nuk ju janë kaluar fëmijëve të tjerë.

Pyetje: Sipas të dhënave të marra nga Emporiki Bank rezulton që në 20.09.2006 shtetasja Etleda Çiftja, ju ka kaluar juve 34,000 euro në llogarinë bankare pranë Emporiki Bank me përshkrimin "kamlim për shlyerje detyrimi për blerje toke", shumë që është tërhequr (33, 900 euro) po në këtë datë nga Ju. Çmund të na thoni për këtë transaksion, pse ka ndodhur? (I tregohet ekstrakti i Emporiki Bank i llogarisë nr. {***} në emër të S.R.K). **Përgjigje:** Me sa më kujtohet, kam shkuar tek banka me Etledën, kam tërhequr shumën e parave dhe ja kam dhënë vajzës. Dua të them edhe njëherë, ne nuk i kemi shitur pronë Etledës dhe nuk kemi përfitur para nga kalimi i pronës, çdo gjë është bërë për të marrë kredi në bankë. Këto fakte provohen me procesverbalin "Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale" mbajtur më datë 19.04.2022.

25. Gjatë hetimeve paraprake, e pandehura **Etleda Çiftja**, ka paraqitur shpjegime pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila është protokolluar më datë **15.10.2021** me Nr. {***} Prot., drejtuar prokurorisë. Në shpjegimet e saj, e pandehura Etleda Çiftja citon shprehimisht se: [...]

Unë, Etleda Çiftja jam zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë në datë 17.06.2017, në funksionin e Komisioneres pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Sipas ligjit nr. 9049 të dates 10.04.2003 "*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publik*", i ndryshuar, me zgjedhjen si anëtare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si organ kushtetues, kisha detyrimin për deklarim të interesave private të mijat, bashkshortit dhe të fëmijëve madhorë, brenda 30 ditëve nga data e zgjedhjes në këtë funksion, pra dorëzimin e Deklaratës Para Fillimit të Detyrës (shkurt DPDF). Para kësaj date nuk kam qenë subjekt deklarues sipas ligjit 9049 datë 10.04.2003. Unë kam dorëzuar DPDF, në datë 17.07.2017, vërtetuar me vërtetimin lëshuar nga ILDKPKI.

1. Në lidhje me apartament Banimi, sipërfaqe 70.80 m2, Rruga "{*}", Tiranë**

Deklarimi për këtë apartament në deklaratën para fillimit të detyrës, datë 17.07.2017.

Apartament Banimi, sipërfaqe 70.80 m2, Rruga "{}", Tiranë. Kontratë Shitje me datë 30.11.2016 me vlerë 42,864 USD, (Vlera paguar në bazë të Kontratës e Sipërmarrjen me nr. {***} Rep dhe {***} Kol., Datë 08.09.2006), me burim krijimi të ardhurat nga pagat, në pronësi 50%.***

Sqarime dhe dokumentacion pranë ILDKPKI-së në lidhje me deklaratën para fillimit të detyrës.

1.2 Në lidhje me qartësimet për këtë deklarim, bazuar në nenin 24 të ligjit nr. 9049 të datës 10.04.2003, i cili citon se: "*Inspektorati i Lartë bën përpunimin paraprak të deklarimeve, i cili përfshin juridiksionin, rregullsinë e plotësismit të deklaratës dhe të anekseve të saj. Kur nga përpunimi paraprak vërtetohen gabime materiale, mospërputhje midis deklaratës së dorëzuar personalisht në formë fizike dhe deklaratës së dorëzuar me mjete të komunikimit elektronik, ose plotësimet të gabuara, Inspektorati njofton subjektin që ka paraqitur këto deklarime, i cili brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar t'i ndreqë ato [...].*" ILDKPKI-ja me anë të shkresës Nr. {***} Prot, datë 31.08.2017, më ka ftuar për të dhënë shpjegime lidhur me deklarimin e interesave private, para fillimit të detyrës.

1.3. Jam paraqitur më datë 18.09.2017, sipës kërkesës së ILDKPKI-së dhe më janë bërë prezent pyetjet dhe dokumentacioni i kërkuar. Pasi u njoha me sqarimet e kërkuara nga ILDKPKI, ramë dakort që në datë 2.10.2017 do të paraqitem për të

dhënë shpjegime dhe paraqes dokumentacion justifikues. Konkretisht në lidhje me këtë apartament më është kërkuar dokumentacion vërtetues si dhe më janë kërkuar sqarime për burimin e krijimit të këtij asemi në vitin 2006, në vlerën 42 864 USD, duke më kërkuar të paraqitem në datë 18.09.2017, ora 10:00.

1.4. Në sqarimet e mia pranë ILDKPKI-së në lidhje me këtë apartament kam paraqitur dhe sqaruar: *Unë po dorëzoj certifikatën e pronësisë, me nr. 1351611, lëshuar në datë 5.12.2016 + kontratën e shitblerjes me nr. {***} rep dhe nr. {***} kol datë 30.11.2016, gjithashtu po dorëzoj kontratën e sipërmarrjes të datës 8.09.2006 + zgjidhje kontrate datë 8.09.2006, që konfirmon se marrëveshja ishte kryer me Familjen K. dhe ne u lidhëm pas kësaj zgjidhje kontrate me firmën {***}. Pagesën ja kemi kryer familjes K. në vlerën 42 864 USD dhe se me firmën {***} nuk kemi kryer transaksione. Me firmën {***}, kontratën e shitblerjes e kemi lidhur përfundimisht në vitin 2016 dhe atëherë firma e ka deklaruar si pagesë, meqenëse është lidhur tek noteri kjo kontratë në datë 30.11.2016, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se pagesa është kryer në vitin 2006 dhe jashtë zyrës. Pagesa është kryer në USD ne nuk e kuptoj pse është deklaruar në Euro nga Firma, këtë e konfirmojnë dhe kontratat që sapo dorëzova. [...] Burimi i pagesës ka qenë me kredinë e marrë në Emporiki Bank në datë 29.09.2006 në vlerën 35 000 euro. [...] në kontratën me bankën meqenëse firma {***} ende nuk e kishte të regjistruar në ZVRPP këtë pallat që po ndërtonte, unë nuk mund të merrja kredi me kolateral apartamentin dhe për këtë arsye vura si qëllim marrje kredie dhe kolateral, blerjen e një toke me sipërfaqe 3440 m² në Kryevidh Kavajë. Kjo tokë u vlerësua nga ekspertët e bankës në vlerën 50 000 Euro. [...].*

1.5 Për sa më sipër e kam prezumuar të sqaruar/ndrequr deklarin tim në DPFDP të 17.07.2017, në referencë dhe të nenit 24 të ligjit nr. 9049 të dates 10.04.2003.

Dokumentacion ligjor justifikues

- 1. Deklarata e Interesave Privatë para Fillimit të Detyrës**, me numër indeksi 14568 e vitit 2017, dorëzuar në datë 17. 07.2017.
- 2. Ftesën për tu paraqitur pranë ILDKPKI-së** për të dhënë shpjegime lidhur me deklarin e interesave private, me numër {***} prot datë 31.08.2017.
- 3. Procesverbal** mbi shpjegimet e subjektit deklarues, në datë 18.09.2017, firmosur nga Etleda Ciftja dhe Inspektore e ILDKPKI-së V.K.
- 4. Procesverbal** nr. 2, mbi shpjegimet e subjektit deklarues, në datë 2.10.2017, firmosur nga Etleda Ciftja dhe Inspektore e ILDKPKI-së V.K.
- 5. Certifikatë Pronësie Apartamenti**, me numër pasurie {***}, ndodhur në Tiranë, me sipërfaqe 70.8 m², në emër të D.C me 1/2 pjesë dhe Etleda Ciftja 1/2 pjesë.
- 6. Kontratë shitblerje me nr. {***} rep, nr. {***} kol datë 30.11.2016**, midis shoqërisë {***} sh.p.k si shitës dhe D.C, Etleda Ciftja si blerës, për të

njënjin apartament më lart, ku i referohet kontratës së sipërmarrjes si më poshtë.

7. **Kontratë sipërmarrje me nr. {***} rep, nr. {***} kol datë 08.09.2006** midis shoqërisë {***} sh.p.k si investitor dhe D.C, Etleda Ciftja si porositës, për të njëjtin apartament më lart, ku i referohet zgjidhjes së kontratës së sipërmarrjes me trashëgimtarët e porositësit të mëparshëm si më poshtë, ku citon se *cmimi i shitjes është likuiduar jashtë zyrës noteriale, pasi porositësi i mëparshëm kishte shlyer të gjithë vlerën me mandate arkëtimi.*
8. **Zgjidhje Kontrate, datë 08.09.2006 midis shoqërisë {***} sh.p.k** si investitor dhe M.K, M.Xh, V.H, M.M, I.K si trashëgimtarët ligjor të porositësit R.K, në kontratën e sipërmarrjes si më poshtë, në të cilën, ku citohet se *ja kalojmë këtë apartament z.D.Ç dhe Etleda Çiftja nga të cilët kanë marrë të gjithë shumën e paguar për prenotimin e këtij apartamenti. Më tej trashëgimtarët e R.K deklaruan se shoqëria {***} sh.p.k ka të drejtë të lidhë kontratë të re sipërmarrje me D.Ç dhe Etleda Çiftja me shumë të likuiduar.*
9. **Kontratë sipërmarrje me nr. {***} datë 21.08.2003**, midis shoqërisë {***} sh.p.k si investitor dhe R.K si porositës fillestar i këtij apartamenti.
10. **Printim nga OSHE për të vërtetuar momentin e hyrjen në apartament, tetor - nëntor 2006.**
11. **Deklaratë nga Banka Amerikane e Investimeve nr. {***} rep, {***} kol datë 28.4.2020**, me anë të të cilës banka kërkon nga ASHK Kavajë, të fshijë vetëm hipotekën e vendosur në favor të bankës mbi pasurinë nr. {***}, volume {***}, faqe {***}, zona kadastrale {***}, ndodhur në {***}, e cila është bllokuar me anë të kontratës së Hipotekës nr. {***} rep dhe {***} kol datë 28.09.2006. Me anë të kësaj deklarate, vërtetohet se kredia është shlyere gjitha nga data 29.09.2006 deri në mars 2020.

2. **Në lidhje me tokën are me sipërfaqe 3440 m2 me adrese {***}, Kavaje, dhe tokën Are me sipërfaqe 1450 m2 ne adrese {***}, blere me date 10.07.2006.**

Deklarimi për këtë apartament në deklaratën para fillimit të detyrës, datë 17.07.2017.

2.1 Arë me sipërfaqe 1450 m2 në adresë {*}, Kavaje, blerë më datë 10.07.2006, me vlerë 300 000 lekë, me burim të ardhurat nga paga dhe Are me sipërfaqe 3440 m2 me adrese {***}, Kavaje, blerë më datë 10.07.2006, me vlerë 50 000 euro Burimi: Kredi nga Banka Amerikane e Investimeve (American Bank of Investments SA), ish- Banka Emporiki - Shqiperi Sh.A në shumën prej 35,000 Euro dhe te ardhura nga paga 15,000 Euro si Drejtoreshe Ligjore pranë {***}.**

Sqarime dhe dokumentacion pranë ILDKKI-së në lidhje me deklaratën para fillimit të detyrës.

2.2. Në lidhje me qartësimet për këtë deklaram, bazuar në nenin 24 të ligjit nr. 9049 të dates 10.04.2003, i cili citon se: *"Inspektorati i Lartë bën përpunimin paraprak të deklarameve, i cili përfshin juridiksionin, rregullsinë e plotësimit të deklaramës dhe të anekseve të saj. Kur nga përpunimi paraprak vërtetohen gabime materiale, mospërputhje midis deklaramës së dorëzuar personalisht në formë fizike dhe deklaramës së dorëzuar me mjete të komunikimit elektronik, ose plotësime të gabuara, Inspektorati njofton subjektin që ka paraqitur këto deklaramë. i cili brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar t'i ndreqë ato [...]* ILDKPKI-ja me anë të shkresës Nr. {***} Prot., datë 31.08.2017, më ka ftuar për të dhënë shpjegime lidhur me deklaramin e interesave private, para fillimit të detyrës.

2.3. Jam paraqitur më datë 18.09.2017 dhe më janë bërë prezent pyetjet dhe dokumentacioni i kërkuar dhe u ra dakort që në datë 2.10.2017 do të paraqitem për të dhënë shpjegime dhe paraqes dokumentacion justifikues. Më konkretisht më janë kërkuar sqarime se përse kam deklaramur që toka në {***} me sipërfaqe 3440 m² është blerë në masën 35 000 euro nga kredia e marrë nga ABI bank, **kur kjo bankë në përgjigjen e saj datë 8.8.2017, ka konfirmuar se kredia 35 000 euro është marrë në datë 29.09.2006 për blerje apartamenti.**

2.4 Në përgjigje të ILDKPKI-së kam paraqitur dhe sqaruar: [...] *kjo tokë ishte e babit tim dhe që të vihej kolateral duhej të bëhej një kontratë shitblerje në emrin tim si blerës që pastaj ta përdorja si kolateral për marrjen e kredisë. Pra kjo tokë nuk është blerë realisht nga unë, pasi kredia është marrë për apartamentin. Dhe toka e dytë me sipërfaqe 1450 m² nuk është blerë por që ta regjistrohej në emrin tim duhet të lidhja një kontratë shitblerje me tim atë që ishte pronar i kësaj toke. Dhe për këtë tokë nuk kam paguar asgjë. Babai im e ka përfutuar këtë tokë njësoj si tokë e parë, nga ligji 7501.[...]* Për të vërtetuar deklaramet e mia në lidhje me sa i ka shpjeguar ILDKPKI-së, kam dorëzuar dokumentacion justifikues.

2.5. Për sa më sipër e kam prezumuar të sqaruar/ndrequr deklaramin tim në DPFID të 17.07.2017, në referencë dhe të nenit 24 të ligjit nr. 9049 të dates 10.04.2003.

Dokumentacion justifikues për deklaramet e mia:

1. ***Deklarata e Interesave Private para Fillimit të Detyrës***, me numër indeksi 14568 e vitit 2017, dorëzuar në datë 17.07.2017.
2. ***Ftesën për t'u paraqitur pranë ILDKPKI-së*** për të dhënë shpjegime lidhur me deklaramin e interesave private, me numër {***} prot datë 31.08.2017.
3. ***Procesverbal*** mbi shpjegimet e subjektit deklarames, në datë 18.09.2017, firmosur nga Etleda Ciftja dhe Inspektore e ILDKPKI-së V.K.
4. ***Akti i marrjes së tokës në pronësi me nr. {***} datë 15.09.1995***, i cili vërteton mënyrën e fitimit të pronësisë nga familja me përfaqësues babain tim R.K, dhe se dy pronat të cilat më kanë kaluar mua janë pjesë e kësaj AMTP-je, respektivisht 4890 m² (sipas ligjit 5 000 m² për secilin anëtar).

5. **Certifikatë e trungut familjar në datë 1.8.1991**, e cila vërteton përbërjen e familjes në datë 1.08.1991, për efekt të përfitimit të tokës sipas ligjit nr. 7501 dhe akteve në zbatim të tij. Kjo Certifikatë vërteton se prona është fituar me ligj.
6. **Certifikatë për vërtetim pronësie**, për tokën arë me sipërfaqe 3440 m², ndodhur në {***} Kavajë, me numër pasurie {***}.
7. **Kontrata e shitjes me nr. {***} rep dhe {***} kol, datë 10.07.2006**, me palë shitëse R.K, S.K, E.K dhe me palë blerëse Etleda Çiftja, për pronën me sipërfaqe 3440 m², me çmim 50 000 euro. (kjo është prona dhe kontrata e cila është depozituar pranë Bankës Emporiki për të marrë kredinë prej 35 000 eurosh).
8. **Certifikatë për vërtetim pronësie**, për tokën arë me sipërfaqe 1450 m², ndodhur në {***}, me numër pasurie {***}.
9. **Kontrata e shitjes me nr. {***} rep dhe {***} kol, datë 10.07.2006**, me palë shitëse R.K, S.K, E.K dhe me palë blerëse Etleda Çiftja, për pronën me sipërfaqe 1450 m², me çmim 300 000 lekë.

3. Në lidhje me kontratën e kredisë së marrë pranë Emporiki Bank në 29.09.2006.

Deklarimi për këtë kredi në deklaratën para fillimit të detyrës, datë 17.07.2017

3.1. Kredi për blerje toke Are, me sipërfaqe 3440 m², tek American Bank of Investments SA (ish- Banka Emporiki - Shqiperi Sh.A.), me 29.09.2006, në shumën 35,000 Euro, me afat 20 vjet. Gjendja me datë 17.06.2017 shuma 16,699.30 Euro. Shlyerja ka filluar 1 muaj nga tërheqja e shumës së kredisë 29.09.2006 dhe përfundon 29.09.2026 me interes, me kest mujor 215 Euro. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, deri në datën e fillimit të detyrës (me shifra dhe me fjalë) 16,699.30 Euro.

Sqarime dhe dokumentacion pranë ILDKP KI-së në lidhje me deklaratën para fillimit të detyrës.

3.2. Në lidhje me qartësimet për këtë deklaram, bazuar në nenin 24 të ligjit nr. 9049 të dates 10.04.2003, i cili citon se: "Inspektorati i Lartë bën përpunimin paraprak të deklarimeve, i cili përfshirin juridiksionin, rregullsinë e plotësimit të deklaratës dhe të anekseve të saj. Kur nga përpunimi paraprak vërtetohen gabime materiale, mospërputhje midis deklaratës së dorëzuar personalisht në formë fizike dhe deklaratës së dorëzuar me mjete të komunikimit elektronik, ose plotësime të gabuara, Inspektorati njofton subjektin që ka paraqitur këto deklarime. i cili brenda 15 ditëve nga marria e njoftimit është i detyruar t'i ndreqë ato [...]. ILDKPKI-ja me anë të shkresës Nr. {***} Prot., datë 31.08.2017, më ka ftuar për të dhënë shpjegime lidhur me deklaramin e interesave privatë, para fillimit të detyrës.

3.3. Jam paraqitur më datë 18.09.2017 dhe më janë bërë prezent pyetjet dhe dokumentacioni i kërkuar dhe u ra dakort që në datë 2.10.2017 do të paraqitem për të dhënë shpjegime dhe paraqes dokumentacion justifikues. Konkretisht në lidhje me kredinë e marrë pranë Emporiki Bank, **sepse Banka ABI (ish Emporiki Bank), në përgjigjen e datës 8.08.2017, ka konfirmuar se kredia 35 000 euro është marrë në datë 29.09.2006, për blerje apartamenti.**

3.3. Në përgjigje të ILDKPKI-së kam paraqitur dhe sqaruar: [...] *kjo tokë ishte e babit tim dhe që të vihej kolateral duhej të bëhej një kontratë shitblerje në emrin tim si blerës që pastaj ta përdorja si kolateral për marrjen e kredisë. [...] Pra kjo tokë nuk është blerë realisht nga unë, pasi kredia është marrë për apartamentin. Dhe toka e dytë me sipërfaqe 1450 m2 nuk është blerë por që ta regjistrohej në emrin tim duhet të lidhja një kontratë shitblerje me tim atë që ishte pronar i kësaj toke. Dhe për këtë tokë nuk kam paguar asgjë. Babai im e ka përfituar këtë tokë njësoj si tokë e parë, nga ligji 7501 [...]*

3.4. Për sa më sipër e kam prezumuar të sqaruar/ndrequr deklarin tim në DPDFD të 17.07.2017, në referencë dhe të nenit 24 të ligjit nr. 9049 të datës 10.04.2003.

3.5. Në të gjithë deklarin tim para fillimit të detyrës, i jam referuar dokumentacionit ligjor që unë disponoja dhe që kisha depozituar në bankën emporiki për marrjen e kredisë. **Pra, unë kisha firmosur një kontratë me 50 000 euro me prindërit dhe vëllain tim, me qëllim që ta vendosja kolateral për marrjen e kredisë dhe banka për këtë kërkonte që kjo pronë të kalonte me kontratë shitje, pas një sërë veprimesh që kishte kryer në lidhje me vlerësimin e kësaj prone.**

3.7. Për sa kohë që qëllimi im i vetëm ishte marrja e një huaje për të blerë apartamentin, isha e detyruar të zbatoja të gjitha kërkesat dhe procedurat e përcaktuara nga Banka.

Dokumentacion justifikues për deklarinet e mia:

- 1. Deklarata e Interesave Privatë para Fillimit të Detyrës,** me numër indeksi 14568 e vitit 2017, dorëzuar në datë 17.07.2017.
- 2. Ftesën për tu paraqitur pranë ILDKPKI-së** për të dhënë shpjegime lidhur me deklarin e interesave private, me numër {***} prot datë 31.08.2017.
- 3. Procesverbal** mbi shpjegimet e subjektit deklarues, në datë 18.09.2017, firmosur nga Etleda Ciftja dhe Inspektore e ILDKPKI-së V.K.
- 4. Kontrata e Huasë** me Nr. {***} Rep., dhe {***} Kol., datë 29 shtator 2006.
- 5. Kontrata e Hipotekës** me Nr. {***} Rep., Nr. {***} Kol., datë 28.09.2006.
- 6. Kontrata e Shitblerjes** me Nr. {***} Rep dhe {***} Kol, datë 10.07.2006, me palë shitëse R.K, S.K, E.K dhe me palë blerëse Etleda

Ciftja, për pronën me sipërfaqe 3440 m², me cmim 50 000 euro, pjesë e kontratës së huasë.

7. **Raport Vlerësimi**, për tokë me sipërfaqe 3440 m², {***} Kavajë, i datës 6 Shtator 2006, pregatitur nga studio Load sh.p.k, e angazhuar nga Banka Emporiki.
8. **Deklaratën Noteriale** me numër {***} Rep dhe Nr. {***} Kol., datë 28.04.2020, që vërteton se shuma e marrë kredi bashkë me interesat janë shlyer totalisht bankës ABI. [...]

ANEKSI 1

Të ardhurat e siguruara gjatë viteve 1999 - gusht 2006

Të ardhura të cilat vërtetohen me dokumentacion ligjor justifikues

1. Të ardhura nga punësimi Etleda Kaja/Çiftja pranë shoqërisë {***} sh.k, kanë qenë në shumën 4.640.760 lekë bruto. Shuma e pagave neto, bazuar në legjislacionin në fuqi të kohës,¹⁰ përlllogariten në shumën **3.880.818 lekë**, sipas vërtetimit të lëshuar nga DRSSH Tiranë.
2. Të ardhurat për Etleda Çiftja neto nga raport barrëindje kanë qenë në shumën **393.145 lekë**, sipas vërtetimit nr. {***}, dt. 5.10.2021, të lëshuar nga DRSSH Tiranë.
3. Të ardhurat neto nga punësimi im si konsulente me kohë të pjesshme pranë {***} sh.p.k kanë qenë në shumën **600.000 lekë**, sipas vërtetimit Korrik 2006, të lëshuar nga {***} shpk.
4. Të ardhurat neto nga punësimi i bashkëshortit/ D.Ç pranë Gardës së Republikës kanë qenë në shumën **3.535.339 lekë**, sipas vërtetimit të lëshuar nga Garda e Republikës.
5. Referuar librezave të llogarive të kursimit, shuma neto e të ardhurave nga interesat e depozitave tona bankare ka qenë në shumën **266.907 lekë**.

Në përfundim, të ardhurat e mija dhe bashkëshortit tim, **për periudhën 2001 - gusht 2006**, shoqëruar me dokumentacion ligjor janë në shumën totale **8.676.209 lekë**.

Dua të sqaroj, se krahas të ardhurave të paraqitura më sipër, në këtë periudhë kam përfituar edhe:

- i. Të ardhura të tjera, konkretisht nga punësimi im pranë Zyrës së avokatisë të avokatit S.D nga gushti i vitit 1999 deri në Dhjetor të vitit 2000, për të cilin disponoj vërtetimin {***} regjistri datë 27.01.2000, lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, drejtoria e shërbimeve të lira si dhe vërtetimi i lëshuar nga vetë avokati S.D, i cili provon marrëdhënien e punësimit, por për shkak se administratori i kësaj shoqërie ka ndërruar jetë, nuk mund të

¹⁰ Ligj 8711, dt. 15.12.2000; Ligj 8841, dt. 11.12.2001; Ligj 9326, dt. 6.12.2004; Ligj 9458, dt. 21.12.2005; VKM nr. 101, dt. 21.3.2002; VKM nr. 346, dt. 13.6.2002; VKM nr. 384, dt. 14.7.2000; VKM nr. 402, dt. 11.6.2001; VKM nr. 446, dt. 26.6.2003;

siguroj të dhëna lidhur me shumën e saktë të përfituar nga ana ime. Mesa mbaj mend, përfitoja 25.000 lekë neto në muaj për periudhën nga shtator 1999 - dhjetor 2000 (në total 400 000 lekë). *Gjithsesi nuk i kam përfshirë në të ardhurat e mia, pasi nuk disponoj dokumentacion mbi tatimin e paguar mbi këto të ardhura nga ana e avokatit S.D. U interesova dhe rezutoi se avokati kishte ndërruar jetë.*

- ii. Po kështu, gjatë periudhës 2004-2007, kam dhënë konsulencë ligjore për shoqëritë tregtare dhe kam ndjekur në gjykatë regjistrimin në regjistrin tregtar të degëve të shoqërive të huaja dhe shqiptare, si dhe depozitim vendimesh të asamblesë së ortakëve të këtyre shoqërive, si disa shembuj që kam mundur të gjej: (1) {***} (degë e shoqërisë greke), (2) {***} sh.a (degë e shoqërisë greke), si dhe shoqërive tregtare shqiptare etj. (ka dhe të tjera por nuk i mbaj mend të gjitha), për të cilat jam paguar nga këto shoqëri për shërbimin ligjor për shoqëritë tregtare dhe depozitim e kërkesave për regjistrim, vendimeve të bordit apo mbledhjes së ortakëve të shoqërive. **Për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe faktit që asokohe nuk kam qenë subjekt deklarimi, pasi nuk ushtroja funksione publike, nuk kam ruajtur dokumentacion lidhur me shumat e sakta që kam përfituar.**
- iii. Përsa i përket detyrimeve tatimore, lidhur me detyrimin për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sqaroj se pagat e përfituara nga punësimi im pranë {***} sh.k. kanë qenë mbi pagën maksimale për efekt të përlllogaritjes së këtyre kontributeve. Ndërsa lidhur me tatimin në burim/mbi të ardhurat nga paga, tatimi për shërbimin e ofruar nga ana ime mbahej nga këto shoqëri dhe, në dijeninë time, derdhej për llogari të zyrës së tatimtaksave. *Për këto shërbime të kryera disponoj dokumentacion që vërteton punën e kryer, si kërkesat drejtuar gjykatës, vendimet nga gjyqtari ku evidentohet qartë përfaqësimi nga ana ime si avokate, por duke qenë se nuk disponoj pagesën e tatimit në burim nga këto shoqëri, nuk i kam përfshirë në të ardhurat e mija.*

Dokumentacion justifikues bashkëlidhur:

1. Shkresa Nr. {***} Prot., datë 18.11.2020 "Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare", lëshuar nga ISSH, dega e arkivit rajonal Tiranë.
2. Vërtetim Nr. {***} Prot., datë 6.10.2021, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tiranë, për pagesë të barrë lindjes.
3. Vërtetim korrik 2006, lëshuar nga shoqëria {***} sh.p.k.
4. Vërtetim nga Garda e Republikës për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare (3 fletë).

5. Vërtetimin nr. {***} regjistri datë 27.01.2000, lëshuar nga Ministria e Drejrisë, drejtorja e shërbimeve të lira si dhe vërtetimi i lëshuar nga vetë avokati S.D.
6. Tabelë- Përmbledhëse vjetore e të ardhurave për periudhën janar 2001 - gusht 2006.

ANEKS1 2

Përsa i përket periudhës shtator 2006 - dhjetor 2016, në vijim renditen të ardhurat e mija dhe bashkëshortit tim, në shumën totale 44.464.929 lekë.

1. Referuar vërtetimit të lëshuar nga DRSSH Tiranë, të ardhurat bruto nga punësimi im pranë shoqërisë {***} gjatë periudhës shtator 2006 - dhjetor 2008 kanë qenë në shumën 2.959.666 lekë. Shuma e pagave neto, bazuar në legjislacionin në fuqi të kohës, përllogariten në shumën **2.478.570 lekë**.
2. Për periudhën 2009-2016, referuar kreditimeve me përshkrim "pagë" në llogarinë time në bankën Emporiki (punësimi pranë shoqërisë {***}) dhe në bankën Raiffeisen, (punësimi pranë shoqërisë {***}), të ardhurat nga paga kanë qenë në shumën **33.678.917 lekë**.
3. Referuar vërtetimit për bazën e vlerësuar dhe pagën neto mesatare, lëshuar nga Garda e Republikës dhe vërtetimit Nr. {***} Prot., datë 30.9.2021, pagat nga punësimi i bashkëshortit për periudhën shtator 2006 - 2010 kanë qenë në shumën **1.608.364 lekë**.
4. Për periudhën 2011-2016, referuar kreditimeve nga paga në llogarinë e bashkëshortit në bankën Intesa (4.728.555 lekë nga punësimi pranë Bankës së Shqipërisë), bankës BKT (1.593.328 lekë nga punësimi pranë Gardës së Republikës) dhe ekstraktit të e-albania për periudhën shkurt - gusht 2014, për të cilën mungon informacioni në llogaritë bankare (494.200 lekë bruto, 377.194 lekë neto), kanë qenë në shumën totale prej **6.699.078 lekë**.

Gjatë kësaj periudhe (shtator 2006 - dhjetor 2016) kemi paguar kredinë (principal dhe interesa) në shumën 5.120.774 lekë (39.046 euro); kemi blerë një automjet në vlerën 1.000.000 lekë, kemi investuar në fondin Raiffeisen Prestige në shumën 5.900.000 lekë dhe kemi pasur likuiditete bankare në datë 31.12.2016 në vlerën 587.757 lekë.

Në total këto shpenzime dhe pasuri kanë vlerën **12.608.531 lekë**, përkundrajt të ardhurave në vlerën **44.464.929 lekë** të realizura në këtë periudhë.

Dua të sqaroj gjithashtu se në këto të ardhura nuk janë përfshirë ato të ardhura të përfituara nga bashkshorti im gjatë periudhës 2007 - 2010, pasi nuk gjetëm dokumentacion mbi deklarimin e pagës së marrë për punën e kryer pranë 2 shoqërive që ai ka qenë i punësuar, para se të fillonte punë në Bankën e Shqipërisë.

Dokumentacion justifikues bashkëlidhur:

1. Vërtetim Nr. {***} Prot., datë 30.09.2021, lëshuar nga ISSH, drejtoria arkivit Lundër, për D.Ç.
2. Lëvizje llogarie bankare në emrin e bashkshortit D.Çiftja, pranë Intesa San Paolo dhe BKT.
3. Vërtetim me numër reference {***}, i datës 02.10.2017, për pagat bruto vjetore për periudhën Qershor 2009 - 2017.
4. Ekstrakt nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve (gjeneruar nga ealbania), lidhur me pagat për efekt kontributesh, për periudhën dhjetor 2011 deri në dhjetor 2016, për Etleda Çiftja.
5. Ekstrakt nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve (gjeneruar nga e-albania), lidhur me pagat bruto për efekt kontributesh, për periudhën dhjetor 2011 deri në dhjetor 2016, për Dejvi Çiftja.
6. Tabelë - Përmbledhëse vjetore e të ardhurave dhe pasurive për periudhën shtator 2006 - dhjetor 2016.

ANEKS1 3

Në lidhje me kontratën e datës 08.09.2006.

1. Në vitin 2006, kohë kush ishim duke kërkuar për një apartament, kishim si alternativë të blerjes së një apartamenti në Kompleksin {***} (apartamenti në të cilin unë banoj), dhe kishim biseduar me trashëgimtarët e porositësit (i cili kishte ndërruar jetë) se me qëllim blerjen e këtij apartamenti më duhej të merrja kredi pranë bankës Emporiki, sepse nuk i kisha mundësitë e financimit të shumës. Për këtë arsye u interesova në bankë dhe banka më kërkoi dokumentacionin e nevojshëm për të më analizuar mua si aplikant, konkretisht dokumentacion për aftësitë paguese bazuar në të ardhurat që ne kishim si Familje, bazuar në shumën e kërkuar prej 35 000 eurosh.
2. Për këtë arsye, u dërguan pranë bankës që në qershor të vitit 2006, vërtetimit të lëshuar nga punëmarrësi im Egnatia O.Albania, lëshuar në qershor 2006 dhe vërtetimi i lëshuar nga {***} sh.p.k, i cili daton Korrik 2006 dhe vërtetimi i lëshuar nga Garda e Republikës për bashkshortin në datë 06.06.2006, pasaportat, çertifikate lindje, familjare, dëshmi penaliteti, vërtetim punësimi, kopje të kontratës së punësimit, deklaratë personale mbi "të gjitha burimet e të ardhurave familjare.
3. Më tej, pasi banka me konfirmoi që plotësoheshin kushtet për aplikim, atëherë unë duhet të plotësoja kushtet për garancinë apo kolateralin, në të cilin përfshiheshin: (1) *Dokumenti i plotë i pronës që ofrohet si garanci (origjina e pronës dhe kartelë e rifreskuar nga Hipoteka) dhe pronave që zotëroni;* (2) *Kontrata e blerjes së pronës së re (ose Kontrata sipërmarrjes);* (3) *gentplanin e pronës;* (4) *kopje të lejes së ndërtimit dhe vendimit për dhënie të sheshit të ndërtimit.*

4. Pasi u konsultova me përfaqësuesit e bankës në lidhje me apartamentin që kisha zgjedhur dhe i paraqita dokumentacionin përkatës, më njoftuan se nuk mund të lihej kolateral apartamenti pasi nuk plotësonte kushtet e lënies kolateral në favor të bankës, duke qenë se ishte i paregjistruar në ZVRPP dhe për këtë arsye do të duhet të paraqesësh një kontratë blerje të një prone tjetër e cila plotëson kushtet e kërkuara nga banka.
5. Në këto kushte babai im filloi procedurën për regjistrimin e dy pronave tokë arë në ZVRPP Kavajë, dhe prona të cilët plotësonin kushtet për kolateral sipas kërkesave të bankës, u paraqita pranë noterit, e cila ishte dhe noteri i bankës Emporiki dhe kërkova të kaloj pronat e regjistruara nga babai im në emrin tim, pasuritë me nr. {***} me sipërfaqe 3440 m2 dhe pasurinë me nr. {***}, për shkak të kërkesave të bankës, e cila kërkonte një pronë të regjistruar në regjistrat hipotekar për dhënien e shumës së kërkuar kredi.
6. Referuar shumës së kërkuar nga ana ime prej 35 000 eurosh kredi dhe duke qenë se banka kërkonte kolateral i cili të ishte i vlerësuar me çmim në shitje në tregun e lirë dhe pastaj të jepte 70% të cmimit të vlerësuar, ajo kërkoi vlerësimin e pasurisë me nr. {***} me sipërfaqe 3440 m2, pasuri e cila plotësonte kushtet e bankës për të vendosur kolateral. Kjo pronë vlerësohej në vlerën 48 000 euro si vlerë e tregut të lirë të pronave dhe vlera e likuidimit në shumën 38.500 euro, sipas raportit të vlerësimit kryer nga studio "Load" sh.p.k, angazhuar nga vetë banka. Gjithashtu ju paraqit bankës si alternativë për vënie kolatrali apartamentin e prindërve të bashkshortit, me sipërfaqe 67 m2, Rruga Bajram Curri, Tiranë, i cili u vlerësua gjithashtu, por nuk u përdor si kolateral, duke qenë se çmimi i vlerësuar për shitje në treg të lirë i pronës tokë arë me sipërfaqe 3440m2, ishte më i përshtatshëm nga analiza e riskut të bërë nga banka.
7. Referuar rekomandimeve të bankës Emporiki u hartuan kontratat e shitjes me familjarët e mi (babai, nëna dhe vëllai), respektivisht: (i) kontratën e shit-blerjes me numër {***} Rep, Nr. {***} Kol., datë 10 korrik 2006, midis shitësave (R, S dhe E.K) dhe unë në pozicionin e blerësit, për blerjen e pronës prej 3440 m2, me numër pasuri {***}, lloji pasurisë arë, në shumën 50 000 euro, duke e lënë të lirë nga ky moment (pronë e cila do të vihej kolateral). (ii) kontratën e shit-blerjes me numër {***} Rep, nr. {***} Kol., datë 10 korrik 2006, midis shitësave (R, S dhe E.K) dhe unë në pozicionin e blerësit, për blerjen e pronës prej 1450 m2, me numër pasuri {***}, lloji pasurisë arë, në shumën 300 000 lekë, duke e lënë të lirë nga ky moment.
8. Gjatë shqyrtimit të aplikimit për kredinë nga komiteti i miratimit të kredive në bankë, u informova se banka nuk ishte plotësisht e bindur për kolateralin tokë arë, për shkak të llojit tokë bujqësore dhe kërkonte që të formalizohej kontrata e sipërmarrjes midis palëve, për apartamentin për të cilin kërkohet kredia.
9. Për këtë arsye, në datë 8.09.2006 (i) u nënshkrua zgjidhja e kontratës së sipërmarrjes së vitit 2003 të lidhur nga R.K (Fillimisht ky apartament është

porositur nga shtetasi R.K me kontratë sipërmarrje me nr. {***} datë 21.08.2003, midis tij dhe firmës {***} sh.p.k. Zoti R.K ndërron jetë në Mars të vitit 2006 dhe trashëgimtarët e tij donin ta shisnin këtë apartament) nga trashëgimtarët ligjorë të R.K dhe firmës {***} sh.p.k. (ii) pas zgjidhjes së kontratës dhe kalimin e të drejtave tek unë dhe bashkshorti im, ~~ne~~ firmosëm kontratën e sipërmarrjes me firmën {***} sh.p.k, po në të njëjtën datë 08.09.2006, (pra u zëvendësua porositësi).

10. Për më tej, unë nuk e posedoja apartamentin nga data 08.09.2006, pasi nuk ishte disbursuar akoma kredia e miratuar nga Emporiki Bank. Unë kam filluar të banoj në këtë apartament në tetor - nëntor të vitit 2006, çka vërtetohet nga regjistrimi i kontratës me OSHEE për lidhjen e kontratës së funizimit me energji elektrike, e cila ka filluar në datë 29 nëntor 2006.

ANEKSI 4

Shpjegime lidhur me kontratën shitblerjes me Nr. {*} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006,** me palë shitëse R.K, S.K, E.K dhe me palë blerëse Etleda Ciftja, për pronën me sipërfaqe 3440 m2.

1. Unë kam qenë në cilësinë e blerësit në këtë kontratë të cilën e kam firmosur në datë 10.07.2006, para noterit L.K, me cmim 50 000 euro. Kjo kontratë ka si shitësa familjarët e mi (babain, nënën dhe vëllain), dhe është bërë kontratë shitje sipas kërkesave të bankës Emporiki, me qëllim që të vihej kolateral për marrjen e një shume kredie prej 35 000 eurosh pranë kësaj banke.

2. Në lidhje me kontratën e cila rezulton e dorëzuar pranë ZVRPP Kavajë, me të njëjtin numër repertori, kolektori, date, palë, objekti, por me një çmim të ndryshëm nga kontrata që disponoj unë të noterizuar nga i njëjti noter, L.K dhe që i është depozituar dhe bankës Emporiki për marrje kredie, duket që mund të jetë një ngatërresë e paqëllimtë në faqosjen e kontratës dhe dokumentat bashkalidhur, duke vendosur gabimisht fletën e dytë të kontratës shitblerjes së pronës me sipërfaqe 1450 m2, e cila ka çmimin 300 000 lekë dhe që është nënshkruar në të njëjtin moment.

3. Në momentin e firmosjes së të gjitha kopjeve të përgatitura nga noteri, kam prezumuar që të gjitha kopjet ishin njëjloj, pa kontrolluar secilën faqe të cdo kopje.

4. Duke qenë se aplikimi në ZVRPP Kavajë për regjistrimin e kontratës, nuk është bërë personalisht nga ana ime, nuk i është kushtuar rëndësi dokumentacionit të dorëzuar. [...]

26. Sa më sipër, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në përfundim të gjykimit kërkoi: **1. Deklarimin fajtores të pandehurës Etleda Ciftja, për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimi të dokumentave", parashikuar nga neni 186 paragrafi i parë i Kodit Penal, duke e denuar me 1 (një) vit burgim. 2.**

Deklarimin fajtores të të pandehurës **Etleda Çiftja**, për kryerjen e veprës penale të "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", parashikuar nga neni 257 /a paragrafi i dytë i Kodit Penal, duke e denuar me **1 (një) vite 6 (gjashtë) muaj burgim. 3.** Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, bashkimin e dënimeve në një dënim të vetëm prej **1 (një) vite 6 (gjashtë) muaj burgim. 4.** Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, t'i zbritet 1/3 nga masa e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me **1 (një) vit burgim. 5.** Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë për një afat prej 2 (dy) vitesh, me kushtin që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës. **6.** Në zbatim të nenit 391 të K.Pr.Penale të deklarohet falsiteti i kontratës së shitblerjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006 (*data 10 e korrigjuar*) për shitblerjen e pasurisë me nr. {***} ZK {***}, sip prej 3440 m². **7. Në bazë të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale dhe 36 të Kodit Penal, në lidhje me provat, si më poshtë vijon: T'i kthehen noterës *Luljeta Kongoli*: 1) Kontratë Huaje nr. Rep {***} Nr. Kol {***} datë 29.09.2006 lidhur ndërmjet Bankës Emporiki dhe shtetasve Etleda dhe D.Ç; 2) Kontratë Hipotekimi Nr. {***} Rep., Nr. {***} Kol., datë 28.09.2006 në gjuhën angleze dhe shqip; 3) Deklaratë Nr. {***} Rep., datë 29.09.2006; 4) Deklaratë Nr. *** Rep., datë 29.09.2006; 5) Kontratë Shitblerje Nr. {***} Rep., Nr. {***} Kol., datë 06.07.2006; 6) Kartelë pasurie për pasurinë me Nr. {***} datë lëshimi 10.07.2006; 7) Çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 21.06.2006, hartë treguese e regjistrimit, vërtetim datë 29.06.2006 lëshuar nga Komuna Kryevidh; 8) Çertifikatë familjare e shtetasit Rustem Kaja datë 29.06.2006; fotokopje të pasaportave të shtetasve Rustem dhe Suzana Kaja; 9) Kontratë Shitblerje Nr. {***} Rep., Nr. {***} Kol., datë 06.07.2006; 10) Kartelë pasurie për pasurinë me nr. {***} datë lëshimi 10.07.2006; 11) Çertifikate për vërtetim pronësie për pasurinë me nr. {***} datë lëshimi 21.06.2006, hartë treguese e regjistrimit, vërtetim i Komunës Kryevidh datë 29.06.2006, çertifikatë përbërje familjare e shtetasit Rustem Kaja datë lëshimi 29.06.2006, fotokopje të pasaportave të shtetasve Rustem dhe Suzana Kaja. Të kthehen pranë ASHK, Tirana Veri, Arkiva vendore: 1. Kontratë shitblerje nr. 15214/94, dy fletë; 2) Planimetri bodrumi dhe apartamenti, dy fletë; 3) Plan vendosje; 4) Kontratë për privatizimin e banesës datë 15.09.1993; 5) Çertifikatë përbërje familjare datë lëshimi 11.06.1993; 6) Treguesit kryesorë për apartamentin, formulari nr. 2 datë 15.09.1993; 7) Treguesit tekniko ekonomikë të banesës formulari nr. 1, Inventari i brendshëm i dosjes me ref {***} ZK {***} nr. pasurie 3/103+1-6 vol 2 faqa 18.19; 8) Kartelë e pasurisë së paluajtshme kodi unik 8370002019, çertifikatë regjistrimi datë lëshimi 10.11.2021, dy copë; 9) Kartelë pasurie kodi unik 8370002018; 10) Kërkesë nr. 65846; 11) Shkresë datë 16.09.2021; 12) Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore Nr. Rep {***}, Nr. Kol {***}, datë 04.08.2021; 13) Çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 23.07.2001, dy copë; 14) Shkresë kthim përgjigje për shtetasen F.Ç; 15) Kërkesë nr. 56827; 16) Kartelë e pasurisë së paluajtshme kodi unik 8370002018; 17) Vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore Nr. {***}**

Rep., Nr. {***} Kol., datë 04.08.2021; **18)** Çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 21.07.2001; **19)** Shkresë për shtetasen Fatmire Çiftja; **20)** Kërkesë nr. 48304; **21)** Vendim Nr. {***} Rep., Nr. {***} Kol., datë 04.08.2021; **22)** Çertifikatë për vërtetim pomësie datë lëshimi 23.07.2001; **23)** Mandat pagese ref 29363853. **Të kthehen pranë ASHK, Tirana Veri:** **1)** Inventari i brendshëm i dosjes, ref {***} ZK {****} nr pasurie 1/312+ 1-43; **2)** Kartela e pasurisë; **3)** Kërkesë nr. 118444; **4)** Kontratë shitblerje Nr. {***} Rep., Nr. {***} Kol., datë 30.11.2016; **5)** Çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 21.04.2010; **6)** Aplikim i noterës One stop shop; **7)** Kartela e pasurisë së paluajtshme; **8)** Kontratë Sipërmarrje Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 08.09.2006, planimetri; **9)** Fotokopje pasaporte e shtetasve D. dhe Etleda Çiftja, ekstrakt i regjistrimit tregtar të shoqërisë {***} sh.p.k. **Të kthehen pranë ASHK, Dega Kavajë:** **1)** Inventari i brendshëm i dosjes nr ref 0000099; **2)** Aplikim datë 31.07.2006; **3)** Kontratë shitblerje Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006; **4)** Kartelë pasurie për pasurinë me nr. {***} datë lëshimi 10.07.2006; **5)** Çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 21.06.2006, hartë treguese e regjistrimit, vërtetim datë 29.06.2006 lëshuar nga Komuna Kryevidh; **6)** Çertifikatë familjare e shtetasit R.K datë 29.06.2006; **7)** Hartë treguese e regjistrimit; **8)** Inventari i brendshëm i dosjes ref 0000194; **9)** Aplikim datë 31.07.2006; **10)** Kontratë Shitblerje Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006; **11)** Kartelë pasurie për pasurinë me nr. {***} datë lëshimi 10.07.2006; **12)** Çertifikate për vërtetim pronësie për pasurinë me nr. {***} datë lëshimi 21.06.2006, hartë treguese e regjistrimit, vërtetim i Komunës Kryevidh datë 29.06.2006, çertifikatë përbërje familjare e shtetasit R.K datë lëshimi 29.06.2006, hartë treguese e regjistrimit. **Të kthehen pranë Bankës Amerikane të Investimeve:** **1)** Aplikim deklarate për kredi hipotekare; **2)** Çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 23.07.2001 bashkë me kartelën e pasurisë për pasurinë me nr. {***}; **3)** Kontratë Shitblerje Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006 pasi të bëhet shënimi si pjesë e pandarë e kontratës e deklarimit të falsifitetit të kësaj kontrate; **4)** Çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 21.06.2006, hartë treguese e regjistrimit; kartelë pasurie, çertifikatë e përbërjes familjare, çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 15.09.2006; kartelë pasurie; **5)** Kontratë Shitblerje Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006, çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 21.06.2006; kartelë pasurie; hartë treguese regjistrimi, vërtetim datë 29.06.2006; çertifikatë e përbërjes familjare; **6)** Vërtetim datë 12.06.2006 e Gardës së Republikës; **7)** Vërtetim i muajit korrik 2006 i shoqërisë {***}; **8)** Vërtetim i muajit qershor 2006 i shoqërisë {***}; **9)** Referencë e shoqërisë {***} e muajit shtator 2006; **10)** Kontratë individuale e punës Nr. {***} Prot., datë 01.03.2001; **11)** Vërtetim Nr. {***} Rep., datë 06.06.2006; **12)** Çertifikata NIPT për shoqërinë {***}; çertifikatë për regjistrim në organin tatimor; vërtetim nr. {***} rep datë 06.06.2006; **13)** Vendim i gjyqtarit të vetëm nr. {***} datë 31.10.2000; **14)** Vërtetim i njësisë me origjinalin Nr. {***} Rep., datë 06.06.2006; **15)** Liçencë e subjektit {***}; **16)** Vërtetim i njësisë me origjinalin Nr. {***} Rep., datë 24.05.2006; **17)** Kontratë hipotekimi Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 28.09.2006; **18)** Çertifikatë për vërtetim pronësie datë lëshimi 15.09.2006, kartelë pasurie nr. {***}, hartë treguese regjistrimi; **19)** Çertifikatë për vërtetim hipotekimi; **20)** Kartelë

pasurie e paluajtshme; **21)** Kontratë Huaje Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 29.09.2006; **22)** Deklaratë Nr. {***} Rep., datë 29.09.2006; Nr. {***} Rep., datë 29.09.2006; **23)** Kalendari i detyrimeve, 4 fletë; **24)** Njoftim për tërheqjen e huasë; **25)** Njoftim për shlyerje pjesore të kredisë; **26)** Dokument sigal; **27)** Policë sigurimi jete; formulari i miratimit të kredisë., urdhër kalimi, mandat pagese, customer position, account details dy fletë; transferim fondesh i brendshëm, Jurnal Multi Offset Input 4 fletë; **28)** Policë sigurimi datë 29.09.2006; **29)** Urdhër kalimi, mandat pagese; **30)** Policë sigurimi datë 29.09.2006 dy fletë; **31)** Customer Position, urdhër kalimi, mandat pagese, urdhër kalimi, mandat pagese; **32)** Policë sigurimi datë 29.09.2006 dy fletë, urdhër kalimi, mandat pagese; **33)** Policë sigurimi tre fletë; **34)** Formular i miratimit të kredisë; **35)** Account Details; **36)** Transferim fondesh; **37)** Journal Multi Offset Input; **38)** Account Details dy fletë; **39)** Transferim fondesh; Jpurnal Multi Offset, transferim fondesh, Jorunal "Multi Offset; nr llogarie; **40)** Policë sigurimi tre fletë, nr llogarie, Journal Multi Offset, dy fletë; nr llogarie; **41)** Deklaratë noteriale Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 28.04.2020; **42)** Njoftim për shyerje totale të parakohshme kredie. **Të kthehet pranë ASHK Dega Kavajë:** **1)** Akt i marrjes së tokës në pronësi Nr. {***} datë 15.09.1995. **7.** Shpenzimet proceduriale të kryera në hetim paraprak si dhe ato të kryera gjatë gjyqimit, t'i ngarkohen solidarisht te pandehurëve.

III. Vlerësimi i Gjykatës.

1. Lidhur me përgjegjësinë penale të të pandehurës Etleda Çiftja.

27. Përgjegjësia penale është detyrimi ligjor i çdokujt, që shkel një rregullim normativ me karakter penal, për t'iu nënshtruar pasojave ligjore me karakter ndëshkues e parandalues. Nisur nga rëndësia që kanë organet proceduese penale përgjatë të gjithë veprimtarisë që përbën në tërësi procedimin penal, nga intensiteti i madh i kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të subjekteve të nënshtruara dhe nga nevoja për zhvillimin e një procedimi të ndershmë, të rregullt dhe tërësisht në përputhje me ligjin, Kodi Penal ka parashikuar disa kushte kumulative që duhet të përmbushen në çdo procedim penal.

28. Kushtetuta e Republikës sonë në nenin 39 të saj shprehet ndër të tjera se: *“Askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj”*, që njihet me parimin latin *“Nullum crimen, nulla poena sine legge”*, d.m.th. nuk ka krim, nuk ka ndëshkim pa ligj. Në bazë dhe në zbatim të këtij përcaktimi **rezervë ligjore**, Kodi Penal fillimisht në nenin 1 dhe më pas në nenin 2 të tij, respektivisht nën titujt **“Ligji penal dhe ndarja e veprave penale”** dhe **“Mosdënimi pa ligj”**, shprehet se: *“Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat në pjesën e posaçme të këtij Kodi”* dhe *“Askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër penale që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale. Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj.”* Sigurisht, Legjislatori nuk do të mjaftohej kurrësi me kaq, kështu që, në pjesën e

posaçme të Kodit Penal ka parashikuar edhe llojet e veprave penale dhe llojet apo masat përkatëse për to. Përcaktimi i saktë i normës që parashikon veprën penale, ka një rëndësi themelore, sepse është një parakusht për respektimin e parimit të ligjshmërisë, që një person të merret në përgjegjësi penale, e më pas ndaj tij të zbatohet sanksioni penal, sipas figurës së veprës penale saktësisht të kryer prej tij.¹¹

29. Pra, sipas të drejtës sonë penale e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale është që në veprimet ose mosveprimet e tij të ekzistojnë elementët e një figure të caktuar të veprës penale, të parashikuar nga ligji penal. Respektimi dhe plotësimi i elementeve të figurës së veprës penale ka rëndësi të madhe, sepse ka të bëjë me zbatimin e parimit të ligjshmërisë. Për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj të marra së bashku, të cilët janë: **a)** objekti i veprës penale; **b)** ana objektive; **c)** subjekti dhe **ç)** ana subjektive. Provueshmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Nëse nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë ligjorë, personi nuk mund të merret nën përgjegjësi penale dhe rrjedhimisht as të dënohet.¹² Prandaj, në çështjen konkrete, gjykata, duhet të shohë e të verifikojë, ekzistencën e të gjithë elementëve të veprës penale dhe të figurës së saj në veçanti. Figura e veprës penale, pasqyron formën juridike të veprës penale për rastin konkret. Nëse nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë personi, nuk mund të dënohet. Prandaj, më poshtë, Gjykata çmon të analizojë elementët e figurës së veprës penale për të cilën akuzohet e pandehura Etleda Çiftja.

A. Lidhur me kryerjen e veprës penale të “Falsifikim i dokumenteve”.

30. Duke u rikthyer në çështjen objekt gjykimi, prokuroria e akuzon të pandehurën Etleda Çiftja, për veprën penale të “Falsifikimi i dokumenteve”, pasi sipas saj nga rrethanat e faktit rezulton se ajo i ka konsumuar të gjithë elementët objektiv e subjektiv të marrë së bashku, që kjo veprë penale të konsiderohet e kryer. Prandaj, në çështjen objekt gjykimi, Gjykata, duhet të analizojë elementët e figurës së veprës penale të “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se: “Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet. Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet. Kur falsifikim bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet.”.

31. Në lidhje me objektin e veprës penale, “Falsifikimit të dokumenteve”. Gjykata çmon se vepra penale, përveçse përbën një shkelje formale të ligjit penal material, në të njëjtën kohë, ajo duhet të përbëjë edhe një cenin real të marrëdhënies juridike të qenësishme që mbrohet nga objekti i veprës penale. Pra, për konfigurimin e një veprë penale konkrete, nuk mjafton vetëm shkelja e përcaktimit ligjor, thjeshtë si komandë ligjore, por kërkohet edhe prania e një cenimi, domethënë të një sulmi që i

¹¹Shiko vendimin Nr. 3, datë 02.11.2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

¹²Shiko vendimin Nr. 204, datë 02.11.2016 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

bëhet marrëdhënies juridike të mbrojtur nga norma penale inkriminuese si pasojë e kryerjes së një fakti penal. Pikërisht, parimi i cenueshmërisë së nevojshme të marrëdhënies së mbrojtur (*nullum crimen sine iniuria*) parashikon që vepra penale, përveçse një shkelje ligjore e normës, duhet të konsistojë edhe në një cenim të marrëdhënies juridike që mbrohet si një e mirë juridike nga objekti i normës penale. Ky parim buron nga parimi materialitetit (*nullum crimen nulla poena sine actione*) në të drejtën penale, sipas të cilit një vullnet kriminal që nuk manifestohet dhe materializohet në botën e jashtme nuk mund të ndëshkohet. Prandaj edhe është e rëndësishme që cilësimi ligjor i veprës penale të jetë në përputhje me faktin e kryer materialisht dhe marrëdhënia konkret të jetë e cenuar apo e vendosur në një rrezik real, në të kundërt nuk mund të kemi ndëshkim. Gjykata vlerëson se parimi i cenueshmërisë së nevojshme në të drejtën penale, kërkon që ligji penal substancial duhet të interpretohet vetëm sipas kuptimit kur marrëdhënia juridike e mbrojtur nga objekti i normës penale cenohet efektivisht nga sjellja e njeriut (veprim a mosveprim), pasi ky parim përbën një garanci substanciale për individin përballë zbatimit të ligjit penal material nga organet shtetërore kompetente. Objekt i veprës penale të falsifikimit të dokumenteve, është marrëdhënia juridike konkrete që garanton veprimtarinë e rregullt të organeve të administratës publike, si dhe të personave privatë në lidhje me hartimin, administrimin dhe lëshimin e dokumenteve, nga veprimet ose mosveprimet kriminale, që sjellin si pasojë cenimin e ligjshmërisë së funksionimit të këtyre organeve, si dhe të drejtave apo interesave të ligjshëm të shtetasve.¹³ Pra, objekti material i krimit mund të jenë dokumenta zyrtarë apo privatë të ndryshëm,¹⁴ përveç atyre që parashikohen në nenet 187 “Fallsifikimi i dokumenteve shkollor”, 188 “Fallsifikimi i dokumenteve shëndetësor”, 189 “Fallsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”, 190 “Fallsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve” dhe 191 “Fallsifikimi i akteve të gjendjes civile” të Kodit Penal.

32. Në lidhje me anën objektive (*actus rea*) të figurës së veprës penale “Fallsifikimit të dokumenteve”. Gjykata thekson se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idetë e tij. Pra, ana objektive paraqet sulmin kriminal të shqyrtuar nga ana e tij e jashtme, nga pikëpamja e zhvillimit gradual dhe konsekuent të ngjarjeve dhe fenomeneve, të cilat fillojnë të vihen në lëvizje me kryerjen nga subjekti i veprimit ose mosveprimit dhe përfundojnë me ardhjen e një rezultati të caktuar kriminal. Nga teoria e së drejtës penale dhe praktika gjyqësore rezulton se, element të anës objektive të figurës së veprës penale janë: i) *veprimi ose mosveprimi* i kundërligjshëm; ii) *mënyra e kryerjes së veprës penale*, me të cilën kuptohet renditja e veprave, metodat e përdorura, karakteri kronologjik dhe

¹³Shiko vendimin Nr. 24, datë 09.02.2017 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹⁴ Objekt i veprës penale të falsifikimit të dokumenteve mund të jenë edhe dokumente private. Kështu në vendimin Nr. 510, datë 12.11.2008 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndër të tjera shprehet se: “Pavarësisht argumentimit që është përpjekur të parashtrijë gjykata e apelit në arsyetimin e vendimit të saj, objekti i veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal në fuqi nuk lidhet në mënyrë të posaçme me fallsifikimin e dokumentave zyrtarë. Kjo përsa kohë ligjvënësi në këtë dispozitë shprehet për dokumenta, pa parashikuar posaçërisht kategorinë e tyre.”.

specifika e lëvizjeve që bën personi për kryerjen e veprës penale. Mënyra e kryerjes së veprës penale lidhet ngushtësisht me mjetet e përdorura nga personi për realizimin e saj; dhe iii) *Koha, vendi dhe ambjenti i kryerjes së veprës penale*, me të cilën kuptohet grumbullimi dhe unitetit i kushteve konkrete, në të cilat kryhet veprimi ose mosveprimi kriminal, në të cilat zhvillohet lidhja shkakësore¹⁵ dhe vjenë rezultati (pasojë) kriminale. Këto kushte ekzistojnë objektivisht dhe pavarësisht nga vullneti i subjektit i veprës penale.

32.1. Në kuptim të nenit 186 të Kodit Penal, figura e veprës penale “*Falsifikimit të dokumenteve*”, me falsifikim të dokumenteve kuptojmë paraqitjen në të të rrethanave të rreme ose përpilimin e një dokumenti krejtësisht të falsifikuar, si dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara. Falsifikimi i dokumentit mund të bëhet në dy mënyra: ose duke vepruar drejtpërsëdrejti mbi të, duke bërë shtesa, korigjime, ndryshime dhe çdo veprim tjetër material (*falsifikim material*) ose duke falsifikuar përmbajtjen e tij, pa prekur formën e dokumentit (*falsifikim intelektual*). Ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht se figura e veprës penale “*Falsifikimi i dokumenteve*” nga ana objektive kryhet në dy forma: nëpërmjet “*falsifikimit të dokumenteve*” dhe nëpërmjet “*përdorimit të dokumenteve të falsifikuara*” nga vetë personi që e ka kryer falsifikimin apo nga një person tjetër që ka interes për përdorimin e tij.¹⁶ Në formën e parë të kryerjes është e domosdoshme zbulimi i autorësisë së falsifikimit dhe në pamundësi të saj përjashtimi nga kjo autorësi e pjesëmarrësve në proces.¹⁷ Po ashtu, që të arrihet në konkluzionin se jemi përpara kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal në formën e përdorimit, do të duhet së pari të provohet përdorimi i aktit, por njëkohësisht të vërtetohet dijenia e subjektit të veprës penale së akti i përdorur prej tij përmban të dhëna të rreme, sikundër të jetë evident dhe qëllimi i fitimit apo çdo lloj interesi tjetër personal nga përdorimi i këtij dokumentacioni të falsifikuar.¹⁸

32.2. Ndërkohë përveç objektit të përgjithshëm që cenohet ligjvënësi ka parashikuar si forma të veçanta kryerjen e kësaj vepre në disa rrethana rënduese. Konkretisht kryerja e falsifikimit i) në bashkëpunim,¹⁹ ose më shumë se një herë apo ka

¹⁵ Shiko vendimin Nr. 06, datë 01.02.2017 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ku parashikohet shprehimisht se: “*Bazuar në parimin latin “Nullum crimen, nulla poena sine causa” (Nuk ka krim, nuk ka dënim pa shkak), lidhja shkakësore, si një nga tre elementët e domosdoshëm të anës objektive të figurës së veprës penale e parashikuar në nenin 13 të K.Penal, vendos kushtin për ekzistencën e përgjegjësisë penale. Si e tillë ajo mund të përfytyrohet si një segment me dy skaje me pikë nistore shkakun, veprimin apo mosveprimin e kundraligjshëm dhe pikë fundore pasojën. Lidhja shkakësore shpreh pikërisht marrëdhënien që krijohet mes këtyre dy elementëve. E thënë ndryshe, lidhja shkakësore mund të kuptohet si marrëdhënia e varësisë që ekziston mes veprimit ose mosveprimit dhe pasojës përfundimtare të ardhur në një ngjarje konkrete, çka do të thotë se ekzistenca e pasojës shoqërisht të rrezikshme duhet të jetë rezultat i drejtpërdrejtë i veprimeve të të pandehurit dhe se po të mos ekzistonin veprimet konkrete të kryera prej këtij të fundit, nuk do të ekzistonte as pasojja. Ashtu si edhe çdo element tjetër i veprës penale, lidhja shkakësore duhet të provohet. Pra, në çdo gjykim duhet të evidentohet lidhja mes veprimit apo mosveprimit dhe pasojës së ardhur në çështjen konkrete objekt gjykimi, në mënyrë që vepra penale e parashikuar nga ligji të konsiderohet e kryer nga autori i veprimit apo mosveprimit.”*

¹⁶ Shiko Vendimin Nr. 186, datë 05.06.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹⁷ Shiko Vendimin Nr. 113, datë 27.03.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹⁸ Shiko Vendimin Nr. 617, datë 16.06.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹⁹ Kolegjet e Bashkuara në vendimin Nr. 4 datë 15.04.2011, kanë unifikuar praktikën gjyqësore në

sjellë pasoja të rënda si dhe **ii)** falsifikimin nga personi që ka për detyrë ta lëshojë dokumentin. Pra, ligjvënësi përveç elementeve të domosdoshëm të veprës penale të falsifikimit i cili konsiston në paraqitjen e rrethanave të rreme, për efekt të përgjegjësisë penale ka përcaktuar rrethana që rëndojnë përgjegjësinë penale të subjektit që e kryen atë. **Megjithëse figura e veprës penale është e njëjta, format e kryerjes së veprës penale nuk konkurojnë me njëra-tjetrën. Për efekt të përcaktimit të përgjegjësisë penale do të vlerësohet gjithmonë rrethana e posaçme pa të cilën vepra penale nuk do të ishte kryer.**²⁰

32.3. Gjykata e gjen me vend të theksojë se, barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili duhet nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, duhet t'i krijojë gjykatës bindjen **“përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”** se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri. Sipas Vendimit Unifikues Nr. 7 të datës 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: *“Për vendimin përfundimtar lidhur me themelin e akuzës, gjykata disponon bazuar në bindjen e saj mbështetur në prova që vërtetojnë ose jo akuzën, pra jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Asnjë provë nuk mund të ketë një vlerë të paracaktuar, si në drejtim të fajësisë ashtu edhe të pafajësisë.”*. Pra, në procesin penal, organit të akuzës i kërkohet të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, çdo element që përbën veprën penale, për të cilën akuzohet i pandehuri. Nga ana e tij, i pandehuri nuk ka asnjë detyrim që të provojë pafajësinë e tij, megjithatë, ai gëzon të drejtën të mbrohet në procesin penal, në përputhje me procesin e rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ. Lidhur me standardin e vlerësimit të provave GJEDNJ, në **çështjen Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë** shprehet se: *“Për të vlerësuar provat e faktit, Gjykata adopton standardin e të provuarit “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”, por shton se prova të tilla duhet të ndiqen nga bashkëekzistenca e deduktiveve përkuese, mjaftueshmërisht të fortë dhe të qartë ose nga prezumime të njëjta e të pakundërshtueshme të faktit.”*.

32.4. Gjithashtu, Gjykata për të përcaktuar faktin kriminal, është e detyruar të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: *“1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.”*. Lidhur me kuptimin i këtij parimi kushtetues, Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr. 57, datë 21.12.2012, ndër të tjera shprehet se: *“Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është in dubio pro reo, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit²¹ dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e*

lidhje me bashkëpunimin në kryerjen e veprës penale duke përcaktuar se: *“Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se që të ndodhemi në kushtet e bashkëpunimit duhet të bashkëkzistojnë si kushte sine qua non: 1. dy ose më shumë subjekte (pluralitet personash); 2. realizimi i faktit kriminal në të gjithë elementet e tij materiale; 3. dhënia e një kontributi rilevant në kryerjen e veprës penale nga secili prej bashkëpunëtorëve; 4. ana subjektive, të paktën në formën e saj minimale, që është dijenia e të paktën njërit prej bashkëpunëtorëve për të bashkëpunuar me të tjerët në kryerjen e faktit kriminal.”*.

²⁰ Shiko Vendimin Nr. 288, datë 07.11.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

²¹ Në vendimin Nr. 5, datë 2 Shkurt 2001 të Gjykatës Kushtetuese ndër të tjera thuhet se: *“Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjithë organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj. Arsyetimi*

akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuzat.²² Kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit (“akuzës”, “veprës penale” për të cilën akuzohet, që nënkupton një veprim, sjellje dhe fakt,²³ ky duhet bërë në favor të të pandehurit. Në bazë të këtij parimi pranohet se kur gjykata e shpall të pandehurin të pafajshëm, ajo nuk duhet të bindet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. I pandehuri shpallet i pafajshëm atëherë kur organi i akuzës nuk ka arritur të provojë në gjykatë se i pandehuri e ka konsumuar veprën penale në të gjithë elementët e saj përbërës ose kur ekziston një dyshim për akuzën, i cili sipas parimit të njohur *in dubio pro reo*, çmohet nga gjykata në favor të të pandehurit.

32.5. Gjithashtu, përse i përket standartit të provueshmërisë në procesin penal, Gjykata mban parasysh jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë. Kështë, në vendimin Nr. 196, datë 12.06.2013 Kolegji Penal i Gjykatës Lartë, ndër të tjera shprehet: “Kolegji Penal risjell në vëmendje edhe vendimin që i përket çështjes “Breukhoven kundër Republikës Çeke”, nr.44438/06, datë 21.07.2011 kur, GjEDNj përvijon jurisprudencë të qartë, në lidhje me mundësinë dhe vlerën e përdorimit të akteve, si dhe kualifikimit të akuzave nga ana e gjykatave të faktit. “Sipas jurisprudencës së krijuar nga gjykata, të gjitha provat duhet të merren në një seancë publike, në prani të të akuzuarit, me qëllim të mundësisë së kundërshtimit të tyre. Ka përjashtime nga ky parim, por ato nuk duhet të shkelin të drejtat e mbrojtjes, që sipas rregullit të përgjithshëm, të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 3 (d) të nenit 6, kërkojnë që të pandehurit t'i jepet një mundësi e përshtatshme dhe e duhur, për të paraqitur kundërshtimet e rastit dhe për t'i bërë pyetje dëshmitarit, si në fazën e deklarimeve ose në një fazë të mëvonshme. Në veçanti, të drejtat e mbrojtjes kufizohen, në një masë që është në kundërshtim me kërkesat e nenit 6, nëse dënimi është i bazuar vetëm, ose në një mënyrë vendimtare, në deklaratimet e një dëshmitari, për të cilat i akuzuari nuk ka pasur mundësi të vijë në dënim dhe t'i kundërshtojë gjatë hetimit ose gjykimit (shiko dhe A.M. kundër Italisë, nr.37019/97, § 25, ECHR 1999-IX). (“Breukhoven kundër Republikës Çeke”, nr.44438/06, datë 21.07.2011, §43).”, ndërsa në vendimin Nr. 201, datë 05.07.2012 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë shprehet se: “...37. Një konkluzion i tillë i këtij Kolegji bazohet në nenin 152/1 të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton se asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar dhe duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor. Kjo do të thotë se fajësia e të pandehurit në një proces penal nuk mund të konkludohet duke u bazuar vetëm në një provë të vetme, e pa mbështetur kjo me prova të tjera më tepër kur ajo nuk provon qartësisht fajësinë e të gjykuarve. Nëse do të konkludohej me një provë të vetme, atëherë

që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale.”

²² I njëjti qëndrim është mbajtur me vendimin Nr. 47, datë 07.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

²³ Shiko Vendimet Nr. 8, datë 08.05.2005 dhe Nr. 10, datë 02.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

kësaj prove do t'i jepej vlerë e paracaktuar, gjë që është në kundërshtim me kërkesat e nenit 152/1 të Kodit të Procedurës Penale dhe në këtë rast nuk do të **kishim çmuarje të provave**, gjë që është kërkesë e detyrueshme kësaj dispozite.”. Nga përmbajtja e këtyre vendimeve rezulton se askush nuk mund të dënohet me një provë të vetme, e cila nuk lidhet me prova të tjera.²⁴

32.6. Gjykata çmon se, është fakt i njohur që procesi i çmuarjes së provave është proces i ndërlikuar dhe kompleks, pasi përbërës të tij janë komponentë sa juridiko-faktikë, aq edhe të brendshëm, psikologjikë, nga të cilët duhet të udhëhiqet dhe nga i cili ndikohet trupi gjykues në formimin e bindjes së brendshme, pas shqyrtimit prej tij, në tërësi, të provave të administruara gjatë gjykimit, prova këto që doemos duhet të jenë marrë në zbatim të kërkesave të nenit 151 të K.Pr.Penale. Në nenin 152 të K.Pr.Penal nën titullin **“Çmuarja e provave”** parashikohet shprehimisht se: *“1. Asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar nga ligji. Gjykata, pas shqyrtimit të provave në tërësi, çmon vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre, duke argumentuar arsyet ku është mbështetur për të krijuar bindjen e saj.”*,²⁵ ndërsa në nenin 380 të K.Pr.Penale nën titullin **“Provat që mund të përdoren për të marrë vendimin”** parashikohet shprehimisht se: *“1. Për të marrë vendimin gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor.”*. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se çdo provë vlerësohet në unitet me provat e tjera që do të thotë se asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar, në të kundër nuk do të kishim çmuarje të provave. Pra, çmuarja e provave përbëhet prej veprimeve të Gjykatës për përcaktimin e vërtetësisë dhe mjaftueshmërisë së provave. **Vërtetësia e provave** është përcaktimi i saktësisë së fakteve provuese domethënë arritja në përfundimin nëse një provë i përgjigjet ose jo së vërtetës. **Mjaftueshmëria e provave** është përcaktimi që bëhet se bashkësia dhe tërësia e tyre lejon nxjerrjen e përfundimit të vërtetë për ekzistencën e faktit për të cilin ato (prova) janë mbledhur. Në qoftë se në bazë të provave të mbledhura është e pamundur arritja e një përfundimi të tillë, kjo gjë tregon se provat nuk janë të mjaftueshme. Në nenin 152 të

²⁴ Shiko vendimin Nr. 97, datë 20.03.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ku thuhet se: *“Nga aktet dhe provat e shqyrtuara rezulton se të dy gjykatat e faktit i kanë bazuar vendimet e tyre vetëm në një provë të vetme, siç janë bisedat telefonike, të cilat sipas vlerësimit të gjykatave të faktit, janë zhvilluar ndërmjet të gjykuarve dhe pa i analizuar ato me asnjë provë tjetër, direkte ose indirekte, që provon fajësinë e të pandehurve, duke vepruar kështu në kundërshtim me kërkesat e pikës 1 të nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, duke i dhënë kësaj prove vlerë të paracaktuar.”*.

²⁵ Shiko Vendimin Nr. 31, datë 31.01.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ku thuhet se *“Kodi i Procedurës Penale në nenin 149 ka dhënë nocionin e provës duke përcaktuar se: “Provat janë njoftimet mbi faktet dhe rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë”. Ndërkohë që në nenin 152/2 të K.Pr.Penale është përcaktuar se “...2. Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indicjet përveçse këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën”. Ndërkohë që ligjvënësi ka dhënë definicionin përsa i përket se çfarë është provë në kuptimin procedural kuptimin e indicjes si mjet procedural provueshmërie e jep teoria e së drejtës procedurale penale. Indicja është një pjesë e provës (probatio simplena) e cila nuk mund ta provojë në mënyrë të plotë një fakt por në mënyrë të përafërt. Gjykata vlerëson se dallimi midis provës dhe indicjes qëndron në atë që: nëse e para vërteton në mënyrë të drejtpërdrejtë ekzistencën ose jo të një fakti, e dyta është një rrethanë nga e cila mund të arrihet në një deduksion të logjikshëm, një konkluzion i përafërt mbi ekzistencën ose jo të një fakti.”*.

K.Pr.Penale është sanksionuar parimi i çmuarjes së lirë të provave. Provat shqyrohen sipas bindjes së brendshme duket zbatuar metodën dialektike gjëtë vlerësimit të provave, sipas kësaj metode vërtetësinë e provave duhet ta shikojmë në lidhje të përgjithshme dhe varësi reciproke me provat e tjera dhe me faktet e çështjes, pra duhet ta shikojmë në mënyrë të gjithëanshme. **Me bindje të brendshme**, kuptojmë atë ndjenjë që formohet tek organi procedues në bazë të ndijimeve të përshtyojeve të tij për drejtësinë e përfundimeve të arritura për saktësisinë dhe mjaftueshmërinë e provave. Bindja e brendshme formohet nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre. Kjo kërkesë e ligjit ka për qëllim që të detyrojë Gjykatën që para se ajo të arrijë në përfundimin e saj, lidhur me vlerësimin e provave, të marrë në shqyrtim jo vetëm njërën anë të provës që bën fjalë për vërtetësinë e saj, por dhe anën e kundërt që e ve në dyshim ose e mohon këtë vërtetësi, **që gjykat të mbështetet jo vetëm te një provë, por në disa të tilla**, që duke i vlerësuar në tërësinë e tyre të lejojnë jo nxjerrjen e një përfundimi hipotetik por një të vetëm dhe të pakundërshtueshëm.²⁶

32.7. Gjykata mbështetur në provat e administruara gjatë gjykimit, duke i parë në unitetin e tyre, si dhe duke u mbështur në parimin *in dubio pro reo*, (çdo dyshim lidhur me faktin shkon në favor të të pandehurit) çmon se fakti objekt gjykimi në mënyrë të përmbledhur rezulton si më poshtë vijon:

37.2.1. E pandehura Etleda Çiftja në vitin 2006 ishte e martuar, me një fëmijë 1 vjeç dhe jetonte në Tiranë me qira. Ndodhur në këto kushte, ajo kishte nevojë për blerjen e një apartamenti. Në këtë periudhë e pandehura Etleda Çiftja punonte si juriste pranë shoqërisë greke “{***}”, ku si kontabiliste pranë kësaj shoqërie punonte dhe shtetësja M.XH. Babai i kësaj të fundit, shtetasit R.K në cilësinë e porositësit kishte lidhur me shoqërinë “{***}” sh.p.k, Kontratën e Sipërmarrjes datë 21.08.2003, për ndërtimin e një apartamenti me sipërfaqe 75.2 m² së bashku me ambjentet e përbashkëta, e përbërë nga një dhomë dhe një guzhinë, pallati D1, kati i tetë i banimit. Çmimi i shitjes së apartamentit është 42. 864 USD (Dyzetë e dymijë e tetëqind dollar”.

37.2.2. Në muajin Mars të vitit 2006 shtetasi R.K ndërroi jetë. Ndodhur në këto kushte, shtetësja M.Xh në cilësinë e trashëgimtares ligjore të të ndjerit së bashku me trashëgimtarët e tjerë vendosën ta shisnin apartamentin e pronotuar tek shoqëria “{***}” sh.p.k. Këtë fakt shtetësja M.Xh ja bëri të ditur edhe të pandehurës Etleda Çiftes, e cila shprehu interes për ta parë apartamentin, dhe pasi e ka parë, është rënë dakort për ta blerë. Sipas deklaramit të shtetases M.Xh, Etledës i ka pëlqyer shtëpia dhe i ka kërkuar favor, duke mos e plotësuar dot shumën e plotë për vleftën e shtëpisë do duhej të merrte një kredi pranë bankës, por për këtë i kërkoi të nënshkruante paraprakisht Aktin e revokimit, i cili do t'i duhej ta paraqiste në bankë.

37.2.3. Për të siguruar shumën për blerjen e apartamentit të porositur nga i ndjeri R.K, e pandehura Etleda Çiftja më datë **16.08.2006** ka aplikuar për Kredi Hipotekore pranë Emporiki Bank. Për këtë fakt e pandehura ka depozituar dokumentacionin e kërkuar nga banka lidhur me punësimin e saj e të bashkëshortit. Por, sipas rregullave të

²⁶ Shiko “E Drejta Procedurale Civile I”, Ribotimi i katërt, Prishtinë 2004, autori Prof.Dr.Faik Brestovci, faqe 249-250.

bankës për të mundësuar marrjen e kredisë duhej dhe garancia hipotekore. Apartamenti që e pandehura Etleda Çiftja dëshironte të blente me kredi nuk ishte i regjistruar në ZVRPP Tiranë, pasi gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se ky apartament është regjistruar në favor të Shoqërisë “{***}” Sh.p.k më datë **31.03.2010**.

37.2.4. Për këtë arsye, sipas sugjerimit të përfaqësuesve të Emporiki Bank do të duhej që e pandehura Etleda Çiftja të paraqeste një kontratë blerje të një prone tjetër e cila plotëson kushtet e kërkuara nga banka. Ndodhur në këto kushte, babai i të pandehurës, shtetasi R.K filloi procedurën për regjistrimin e dy pronave tokë arë në ZVRPP Kavajë, prona të cilët plotësonin kushtet për kolateral sipas kërkesave të bankës. Këto prona janë fituar nga shtetasi R.K bazuar në Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi me Nr. {***}, datë 15.09.1995, ku rezulton se familjes së R.T.K, nga {***} i jepet në pronësi gjithsej **27191 m² tokë**. Më datë 21.06.2006 shtetasi R.K është pajisur me Çertifikatat e Pronësisë. Referuar shumës së kërkuar nga e pandehura Etleda Çiftja prej 35 000 Eurosh kredi, Emporiki Bank kërkonte kolateral i cili të ishte i vlerësuar me çmim në shitje në tregun e lirë dhe pastaj të jepte 70% të çmimit të vlerësuar. Prandaj, banka kërkoi vlerësimin e pasurisë me nr. {***} me sipërfaqe 3440 m², pasuri e cila plotësonte kushtet e bankës për të vendosur kolateral. Kjo pronë vlerësohej në vlerën 48 000 euro si vlerë e tregut të lirë të pronave dhe vlera e likuidimit në shumën 38.500 Euro, sipas raportit të vlerësimit kryer nga studio "Load" sh.p.k, angazhuar nga vetë banka.

37.2.5. Referuar rekomandimeve të Emporiki Bank u hartua Kontrata e Shitblerjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006, të lidhur përpara Noteres L.K, me palë: **Shitësit:** R.K, S.K dhe E.K; **Blerës:** Etleda Çiftja. Objekti i kësaj kontrate është shitja e një sipërfaqe tokë arë prej 3440 m² në {***} që shitësat kanë në pronësi sipas Çertifikatës së Pronësisë lëshuar më datë 21.06.2006. Çmimi i kësaj kontrate fillimisht ishte 300.000 (treqind mijë) Lekë. Më pas sipas deklaramentit të shtetasve L.K mbi kërkesën e Emporiki Bank po këtë ditë është ndryshuar vlera e kontratës së shitjes nga 300.000 (treqind mijë) Lekë në 50.000 (pesëdhjetë mijë) Euro. **Sipas noteres çmimi 50,000 (pesëdhjetë mijë) Euro për pronën, u ndryshua po atë ditë, me mirëkuptim të palëve në kontratë të cilët e nënshkruan përsëri, dhe ky ndryshim u bë sepse banka nuk ja pranonte, këtë pronë si kolateral me çmimin 300, 000 (treqindë mijë) lekë. Në deklaramentimin e saj, shtetësja L.K thekson se ajo ka qenë notere e bankës Emporiki që nga themelimi i saj dhe këtë informacion e ka marrë nga banka.** Sipas deklaramentit të shtetasve R.K, S.K dhe të pandehurës Etleda Çiftja, si dhe nga të gjitha provat e administruara rezulton se, në fakt kjo pronë i është dhuruar të pandehurës, pasi nuk është paguar shuma e cituar në kontratën e shitjes. Qëllimi i lidhjes së kontratës është të ndihmonin vajzën e tyre për të marrë kredi dhe t'i jepnin tokën arë që asaj i takonte sipas Ligjit 7501. Shuma e përmendur në kontratën e shitjes është diktuar nga Emporiki Bank për të mundësuar disbursimin e kredisë në vlerën 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) Euro. Kjo pronë është regjistruar në ZVRPP Kavajë në emër të të pandehurës Etleda Çiftes. Kjo provohet me Çertifikatën Pronësie lëshuar më datë 15.09.2006, së bashku me hartën treguese të regjistrimit. Megjithatë, në ZVRPP Kavajë nuk rezulton të jetë regjistruar Kontrata e Shitjes me vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë)

Euro, por Kontrata e Shitjes me vlerë 300.000 (treqind mijë) lekë e lidhur paraprakisht, të cilës iu ndryshua vlera brenda të njëjtës ditë sipas kërkesës së Emporiki Bank. Sipas të pandehurës Etleda Çiftja ky fakt mund të jetë një ngatërresë e paqëllimtë në faqosjen e kontratës dhe dokumentat bashkalidhur, duke vendosur gabimisht fletën e dytë të kontratës shitblerjes së pronës me sipërfaqe 1450 m², e cila ka çmimin 300 000 lekë dhe që është nënshkruar në të njëjtin moment.

37.2.5. Gjithashtu, është lidhur Kontrata e Shitblerjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006, përpara Noteres L.K, me palë: **Shitësit:** R.K, S.K dhe E.K; **Blerës:** Etleda Çiftja. Objekti i kësaj kontrate është shitja e një sipërfaqe tokë arë prej 1450 m² me adresë: {***}, në vlerën 300.000 (treqind mijë) Lekë. Sipas kartelës së pasurisë rezulton se toka objekt i kontratës së shitjes është regjistruar që prej datës 28.05.1996. Po ashtu, sipas Çertifikatës Familjare lëshuar më datë 04.10.2021 nga Njësia Administrative Kryevidh, rezulton se më datë 01.08.1991, përbërja e familjare e shtetasit R.K ishte me pesë persona, ky i fundit, bashkëshortja S.K, si dhe fëmijët Etleda Çiftja, E.K dhe O.K. Ndodhur në këto kushte, sipas deklarimeve të shtetasve R.K dhe S.K, për këtë pronë nuk kanë përfituar ndonjë të ardhur nga vajza e tyre, e pandehura Etleda Çiftja, pasi sipas tyre Etledës i takonte të merte 5,000 m² nga toka që ata kanë marrë në bazë të Ligjit 750, gjithsej 27191 m² tokë. Pra, rezulton se në fakt kjo pronë i është dhuruar të pandehurës Etleda Çiftes nga familjarët e saj dhe jo shitur. Ky fakt pranohet edhe nga e pandehura.

37.2.6. Gjatë shqyrtimit të aplikimit për kredinë nga komiteti i miratimit të kredive në bankë, e pandehura u informua se banka nuk ishte plotësisht e bindur për kolateralin tokë arë, për shkak të llojit tokë bujqësore dhe kërkonte që të formalizohej Kontrata e Sipërmarrjes midis palëve, për apartamentin për të cilin kërkohet kredia. Për këtë arsye, në datë 8.09.2006 u nënshkrua Zgjidhja e Kontratës datë 08.09.2006 midis palëve: Shoqëria “{***} sh.p.k dhe 1. M.K; 2. M.Xh; 3. V.H; 4. M.M dhe 5. I.K, në cilësinë e trashëgimtarëve të të ndjerit R.K. Sipas këtij veprimi juridik zgjidhet Kontrata e Sipërmarrjes datë 21.08.2003 më palë: **Investitor:** Shoqëria “{***} sh.p.k dhe **Porositës:** R.K, për pronimin e një apartamenti me sipërfaqe 75.2 m² në vlerën 42.864 USD (Dyzetë e dymijë e tetëqind dollar”, e cila është likujduar tërësisht. Në këtë dokument thuhet se palët me marrëveshje e zgjidhin këtë kontratë pasi trashëgimtarët e R.K ja kalojnë këtë apartament z.D.Ç dhe znj.Etleda Çiftja si dhe deklarojnë se shoqëria “{***}” sh.p.k ka të drejtë që të lidhë një kontratë të re sipërmarrje me porositës D.Ç dhe Etleda Çiftja me shumë të likujduar. Kjo për faktin pasi tashmë nga familja Kamberi ishte bërë likujdimi i shumën tek shoqëria “{***}” sh.p.k. Po në këtë datë është lidhur Kontrata se Sipërmarrjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 08.09.2006, me palë: **Investitor:** Shoqëria “{***}” sh.p.k dhe **Porositës:** 1. Etleda Çiftja dhe 2. D.Ç. Sipas kësaj kontrate sipërmarrësi Shoqëria “{***}” sh.p.k merrë përsipër të ndërtoj për porositësin një apartament me sipërfaqe 75.2 m² së bashku me ambjentet e përbashkëta, e përbërë nga një dhomë dhe një guzhinë, pallati D1, kati i tetë i banimit. Çmimi i shitjes së apartamentit është 42. 864 USD (Dyzetë e dymijë e tetëqind dollar”, shumë e cila është likujduar jashtë zyrës noteriale. Vlera e kontratës i është likujduar shoqërisë “{***}”

sh.p.k nga familja K. dhe jo nga e pandehura Etleda Çiftja, fakt i konfirmuar me mandatet e arkëtimit të administruara gjatë gjykimit. Prandaj, është theksuar në këtë kontratë se është likuaduar jashtë zyrës noteriale.

37.2.7. Përpara Noteres L.K, është lidhur Kontrata e Hipotekës me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 28.09.2006 me palë: BANKA “EMPORIKI – SHQIPERI” sh.a; **Hipotekuesi:** Etleda Çiftja, ndërsa më datë 29.09.2006 është lidhur Kontrata e Huasë me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol, me palë: **Huadhënës:** BANKA “EMPORIKI – SHQIPERI” sh.a; **Huamarrës:** Etleda Çiftja; dhe **Dorëzanës:** D.Ç. Nga statement bankar i Bankës Emporiki, rezulton se më datë 29.09.2006 është kredituar në llogarinë bankare me nr {***} shuma e huasë e marrë pranë Bankës Emporiki në vlerën 35 000 euro. **Më datë 29.09.2006 e pandehura Etleda Çiftja, kalon për llogari të shtetases S.K shumën prej 34 000 euro me përshkrimin "Për shlyerje detyrimi për blerje toke".** Pra, rezulton sikur shtetases S.K i është bërë një pagesë prej 4 182 680 lekë të cilat e kanë burimin nga një kredi e marrë pranë ish Bankës Emporiki (34 000 X 123.02 kursi i këmbimit më datë 29.09.2006) ndërkohë që nuk rezulton të jetë paguar pjesa e mbetur nga 50 000 euro por as pagesa për parcelën tjetër të tokës me nr. {***} në vlerën prej 300 000 lekësh. **Po më datë 29.09.2006 këto para janë tërhequr nga shtetësja S.K, në vlerën 33 900 euro.** Nga deklarimi i kësaj të fundit mban mend që ka shkuar pranë bankës me vajzën e saj Etlendën dhe pasi ka tërhequr shumën ja ka dhënë kësaj të fundit për të bërë pagesën e apartamentit të porositur. Nga deklarimi i të pandehurës si dhe nga deklarimet e shtetasve M.Xh dhe I.K (trashëgimtarë të të ndjerit R.K) shuma e kredisë i është dhënë këtij të fundit jo më vonë se një muaj pas zgjidhjes së kontratës (Kontratës së Sipërmarrjes datë 21.08.2003 më palë: **Investitor:** Shoqëria “{***}” sh.p.k dhe **Porositës:** R.K) që është bërë më datë **08.09.2006**, që korrespondon pikërisht me datën e tërheqjes së shumës së kredisë (**datë 29.09.2006**) nga shtetësja S.K, në prani të të pandehurës.

37.2.8. E pandehura Etleda Çiftja, me vendimin Nr. 82/2017 datë 17.06.2017 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RiShqipërisë" është zgjedhur në institucionet e rivlerësimit si komisionere në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Ndodhur në këto kushte, në zbatim të Ligjit Nr. 9049, datë 10.4.2003 “PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË”, i ndryshuar, e pandehura Etleda Çiftja më datën 17.07.2017 ka dorëzuar pranë Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave Deklaratën e Interesave Private Para Fillimit të Detyrës. Në këtë deklaratë pasurie, e pandehura Etleda Çiftja ka deklaruar ndër të tjera pasuritë si më poshtë vijon: **i) Apartament** banimi me sipërfaqe 70.80 m², rruga “{***}”, Tiranë. Kontratë shitje datë 30.11.2016 me vlerë **42 864 USD**. Vlera e paguar në bazë të kontratës së sipërmarrjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 08.09.2006. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga **paga**. Pronësia 50 %; **ii) Tokë arë me sipërfaqe 1450 m²** në adresë {***}, blerë më datë **10.07.2006**, në vlerën 300 000 lekë.

Burimi i krijimit: Të ardhurat nga **paga**. Pronësia 100%; **iii) Tokë arë me sipërfaqe 3440 m² me adresë {***}, Kavajë, blerë më datë 10.07.2006.** **Burimi i krijimit:** Kredi nga Banka Amerikane e Investimeve (*American Bank of Investment SA*) ish Banka Emporiki - Shqiperi sh.a. në shumën prej **35 000 euro** dhe të ardhura nga **paga 15 000 euro** si Drejtoreshë Ligjore pranë {***}. Pronësia 100%. Ndërkohë pasi është thirrur nga ILDKPKI me shkresën Nr. {***} Prot., datë 31.08.2017, me lëndë: “*Ftesë për t’u paraqitur në ILDKPKI për të dhënë shpjegime lidhur me deklarin e interesave private*”, e pandehura Etleda Çiftja në procesverbalin e datës **02.10.2017** “*Mbi shpjegimet e subjektit deklarues*” pranë ILDKPKI-së ka dhënë shpjegime duke cituar saktësisht burimet e pasurive të mësipërme sikurse ka rezultuar në përfundim të hetimit të bërë nga prokuroria që burim për krijimin e tokavë arë është dhurimi nga familjarët, ndërsa si burim për apartamentin në pronësi të saj ka shërbyer kredia e marrë pranë Emporiki Bank. Pra, hetimit i plotë dhe i gjithanshëm i bërë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka konfirmuar edhe njëherë vërtetësinë e deklarimeve të të pandehurës Etleda Çiftja të bëra katër vite më parë pranë ILDKPKI-së.

37.2.9. Këstet e kredisë janë paguar rregullisht nga e pandehura Etleda Çiftja, kredi e cila është mbyllur përpara afatit të parashikuar në kontratë. Kështu, me Deklaratën Noteriale “Për fshirje hipoteke” me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 28.04.2020 lëshuar nga BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SH.A, është vendosur heqja e hipotekës mbi sendin e paluajtshëm tokë armë të vendosur si garanci nga e pandehura Etleda Çiftja, pasi kjo e fundit e ka shlyer kredinë para kësaj date.

37.3. Duke u rikthyer në çështjen objekt gjykimit, Gjykata çmon se pandehura Etleda Çiftja nuk ka konsumuar nga ana objektive figurën e veprës penale “*Falsifikim i dokumentave*” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penale, pasi fakti i atribuar nuk përbën veprë penale. Kjo për arsytet si më poshtë vijon:

37.4. Së pari, Gjykata çmon se në rastin konkret duhet bërë një cilësim i saktë i faktit që i atribuohet të pandehurës Etleda Çiftja për të konkluduar më pas nëse ky fakt hynë në sferën e juridiksionit gjyqësor penal, civil apo administrativ. Juridiksioni është e drejta e një organi për të ushtruar një veprimtari të caktuar në përputhje me ligjin, domethënë rrethi i çështjeve që i takon të zgjidhë në bazë të ligjit njëri ose tjetri organ.²⁷ Në nenin 69 të K.Pr.Penale nën titullin “**Juridiksioni penal**” parashikohet shprehimisht se: “*1. Juridiksioni penal ushtrohet nga gjykatat penale sipas rregullave të caktuara në këtë Kod. 2. Gjykata penale shqyrton gjithçka që është e nevojshme për marrjen e vendimit dhe vendos sipas rregullave të caktuara me ligj.*”, ndërsa në nenin 70 të këtij Kodi nën titullin “**Efektet e vendimit penal për gjykimin civil dhe administrative**” nën titullin “*1. Vendimi penal i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që shqyrton pasojat civile të veprës vetëm përse i përket faktit nëse vepra penale është kryer dhe nëse është kryer nga i gjykuari. 2. Vendimi penal që zgjidh rastësisht një fakt që lidhet me një çështje civile, administrative ose penale nuk ka efekt detyrues në asnjë proces tjetër.*”.

²⁷ Stavri Ceco, Ylber Maldini, Safet Hasani, E Drejta Procedurale Civile (1989), fq 129.

Gjithashtu, në nenin 71 të K.Pr.Penale nën titullin “**Pasojat e procedimit civil dhe administrativ për atë penal**”, parashikohet shprehimisht se: “1. Vendimi civil i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që gjykon çështjen penale vetëm për sa i përket faktit nëse vepra ka ndodhur ose jo, por jo për fajësinë e të pandehurit. 2. Kur vendimi penal varet nga zgjidhja e një mosmarrëveshje mbi gjendjen familjare ose mbi shtetësinë, për të cilën ka filluar një procedim pranë gjykatës kompetente, gjykata penale mund të vendosë, edhe kryesisht, pezullimin e shqyrtimit gjyqësor derisa mosmarrëveshja të zgjidhet me vendim të formës së prerë. Pezullimi nuk pengon kryerjen e veprimeve të ngutshme.”, ndërsa në nenin 72 të këtij Kodi nën titullin “**Mungesa e juridiksionit**” parashikohet shprehimisht se: “1. Mungesa e juridiksionit ngrihet, edhe kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të gjykimit. Gjykata jep vendim dhe urdhëron, kur është rasti, dërgimin e akteve organit kompetent. 2. Kur mungesa e juridiksionit ngrihet gjatë hetimeve paraprake prokurori që procedon vendos dërgimin e akteve gjykatës kompetente për të vendosur.”. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se në kuptim të K.Pr.Penale juridiksioni ndahet në juridiksion penal, civil dhe administrativ që sipas kuadrit ligjor gjykohen nga gjykatat penale, civile dhe administrative.

37.4.1. Gjithashtu, sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, **kompetenca** nuk është gjë tjetër veçse **sasia e juridiksionit ose masa e juridiksionit që i është dhënë në ushtrimin e funksioneve të saj çdo gjykate**. Kuptimi i kompetencës si kufi i juridiksionit lind nga shumëllojshmëria e organeve që ushtrojnë këtë juridiksion, të parashikuara nga rendi juridik si dhe nga kërkesa që rrjedh prej këtij të fundit për të ndarë këtë pushtet midis organeve shtetërore. Në këtë kuadër, kompetenca e gjyqtarit është kufiri i fundit që përcakton fushën e juridiksionit brenda të cilit ai është i detyruar që të procedojë për zgjidhjen e një çështjeje të caktuar. Kompetenca është një kusht procedural i vlefshmërisë së procesit gjyqësor dhe i akteve të realizuara gjatë tij, në kuptimin që “Një gjykatë jokompetente nuk mund të kryejë asnjë veprimtari procedurale”. Detyrimi i respektimit nga gjyqtari të kufirit të kompetencës është ndër të tjera parakusht për të mos lejuar që shumë gjyqtarë të ushtrojnë të njëjtin pushtet me vendime për një fakt të caktuar, duke cenuar parimin kushtetues të ligjshmërisë apo të gjykimit të një personi dy herë për të njëjtën vepër (*ne bis in idem*), të parashikuar përkatësisht në nenet 4/1 dhe 34 të Kushtetutës. Prandaj, për çdo rast dhe çështje të mundshme, ligji ka parashikuar një gjykatë kompetente për të gjykuar.²⁸ Po ashtu, në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet se “1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. 2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”. **Pra një ndër parimet e procesit të rregullt është dhe parimi se gjykata duhet të jetë e caktuar me ligj**. Kjo do të thotë se ajo kërkohet të jetë një gjykatë kompetente, të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit.²⁹

²⁸ Shih vendimin Nr. 11, datë 23.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese

²⁹ Shih vendimin Nr.7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

37.4.2. Në nenin 36 të **K.Pr.Civile** parashikohet shprehimisht se: **“Në juridiksionin e gjykatave hynë të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kode në ligje të vecanta. Juridiksioni gjyqësor civil ushtrohet sipas dispozitave të këtij Kodi dhe ligjeve të tjera. Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata. Është e pavlefshme çdo marrëveshje që lidhet në kundërshtim me këtë dispozitë. Juridiksioni përcaktohet në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë, pavarësisht ndryshimeve të mëpasshme të faktit apo të ligjit.”.** Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se në juridiksionin e gjykatave civile hynë të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe ato të parashikuara nga K.Pr.Civile. Gjykata çmon se, në kuadrin e çështjeve civile bëjnë pjesë dhe paditë për pavlefshmërinë e veprimeve juridike. Kështu, në vendimin unifikues Nr. 5, datë 30.10.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku ndër të tjera arsyetohet se: **“24. Konstatimi i pavlefshmërisë së një veprimi juridik nga gjykata ex officio është i lejueshëm vetëm kur ajo ka në shqyrtim një padi themeli. Vetëm në rastin, kur evidentohet zbatimi apo ekzekutimi i një veprimi juridik, në të cilin vlefshmëria është element konstitutiv i padisë, gjykata do të mund të konstatojë (në cilëndo gjendje apo shkallë të gjykimit) pavlefshmërinë e veprimit juridik, pavarësisht nga veprimet e ndërrmarra e të ushtruara nga palët. Nëse veprimi juridik është i pavlefshëm, nuk ka në fakt efekte juridike për t’u eliminuar, sepse nuliteti është pikërisht mohim, nga ana e rendit juridik, i efekteve të veprimit juridik që është goditur. 25. Sikundër kemi parashtruar më sipër ky rregull i përgjigjet përmbajtjes së nenit **92 të Kodit Civil të harmonizuar me kërkesat e neneve 6 e 28 të Kodit të Procedurës Civile, ose parimit të përputhjes të kërkesave të bëra nga palët me vendimin e dhënë nga gjykata. 26. Zgjedhja e llojit të padisë është në disponibilitetin e paditësit.**”.**³⁰ Pra, nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se juridiksion për të goditur dhe zgjidhur pasojat e veprimeve juridike absolutivisht të pavlefshëm, ku përfshihen dhe veprimet juridike “fiktive ose të simuluar” ka vetëm gjykata civile, për rrjedhojë **nuk bën pjesë në juridiksionin penal.** Në këtë situatë juridike, nëse prokuroria ka ngritur akuzë për “Falsifikim të dokumenteve” që lidhet me veprime juridike “fiktive ose të simuluar”, pasi sipas saj përmbajtja e këtyre veprimeve juridike nuk pasqyron realitetin, gjykata penale nuk ka kompetencë të disponojë me nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit. Kjo për faktin se goditja e veprimeve juridike absolutisht të pavlefshëm në gjykatën civile është në disponibilitetin e palëve të këtij veprimi juridik apo i çdo personi të interesuar që ka pësuar një dëm nga veprimi juridik. **Prandaj, në këtë situatë faktike - juridike, prokuroria gjatë hetimeve paraprake duhet të vendosi mosfillimin e procedimit penal, dhe nëse procedimi ka filluar, duhet të kërkoj pushimin e procedimit në**

³⁰ Në paragrafin 39.3 të këtij vendimi arsyetohet se: **“Pasojat e ardhura nga ekzekutimi (përbushja) e një veprimi juridik absolutisht të pavlefshëm zgjidhen vetëm mbi kërkesën e palëve ndërgjyqëse dhe në rastin kur gjykata kryesisht konstaton pavlefshmërinë e veprimit juridik ajo zgjidh vetëm ato pasoja që janë objekt kërkimi të padisë apo të kundërpadisë, pa u shprehur për pasojat për të cilat nuk ka kërkesë konkrete nga palët. Kjo nuk pengon po këto palë apo persona të tretë të mund të kërkojnë në një tjetër gjykim zgjidhjen e pasojave të lëna në heshtje nga gjykimi ku veprimi juridik është konstatuar absolutisht i pavlefshëm.”.**

gjykatë. Ndërkohë nëse çështja është kaluar për gjykim, gjykata penale duhet të disponojë me deklarin e pafajshëm të të pandehurit/ve, pasi fakti nuk përbën veprë penale, por një mosmarrëveshje juridiko-civile, pra që zgjidhet nga gjykata civile.

37.4.3. Gjithashtu, në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi, Gjykata çmon të sqarojë kuptimin e veprimeve juridike *fiktive ose të simuluar*. Gjykata çmon të theksoj se kjo analizë juridike nuk bëhet për të zgjidhur marrëdhënien juridiko-civile midis palëve, pasi kjo është kompetencë e gjykatës civile, për rrjedhojë gjykata penale nuk mund të zëvendësojë gjykatën civile, pasi nuk ka juridiksion për ta bërë këtë. Pra, qëllimi i gjykatës penale në sqarimin e kuptimi të veprimeve juridike fiktive ose të simuluar në çështjen objekt gjykimi, bëhet vetëm për të konkluduar nëse në rastin konkret jemi përpara një mosmarrëveshje civile apo përpara një fakti penal. Referuar të drejtës sonë materiale, veprimet juridike që bëhen në marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar), janë të pavlefshme dhe nuk krijojnë asnjë pasojë juridike (neni 92 i Kodit Civil).³¹ Simulimi në mënyrë të veçantë mund të shfaqet sipas rastit në dy forma: (i) simulim absolut; (ii) simulim relativ. Në rastin e simulimit absolut, duhet të ekzistojnë njëkohësisht dy kushte: (i) nga njëra anë palët kontraktuese lidhin një kontrate (*fiktive*), e cila duhet të shfaqet; (ii) nga ana tjetër, palët duhet të kenë lidhur një marrëveshje tjetër të fshehtë me anën e së cilës deklarojnë se dëshirojnë që kontrata e lidhur midis tyre (*ajo që shfaqet jashtë*), të mos sjellë asnjë pasojë. Ndërsa në rastin e simulimit relativ veprimi juridik i simuluar është një veprim i cili kryhet nga palët me qëllim për të mbuluar një veprim tjetër juridik, që palët dëshirojnë ta kryejnë. Të arrish në konkluzionin që një veprim juridik (kontratë) është fiktiv apo e simuluar gjykata duhet të arsyetojë e argumentojë mungesën e vullnetit të ndërsjellët dhe të qëllimit të palëve dhe, nga ana tjetër, ekzistencën e vullnetit të vërtetë të palës paditëse dhe të palës së paditur për të realizuar veprime të tjera në favor të tyre.³² Sipas kuadrit ligjor për të provuar ekzistencën e marrëveshjes së simulimit mundet të përdoren prova shkresore, pohim gjyqësor, si dhe me dëshmitarë kur për shkak të rrethanave në të cilat është kryer veprimi juridik ose të marrëdhënieve të posaçme të palëve, nuk ka qenë e mundur të merrej prova me shkresë.³³ Pamundësia e marrjes së provës me shkresë për shkak të marrëdhënies së posaçme është atëherë kur palët që kryejnë veprimin juridik kanë marrëdhënie familjare sepse janë gjini ose krushqi e afërt, ose edhe kur nuk janë të tillë por shkojnë shumë mirë me njëra tjetrën. Kjo quhet pamundësi morale. **Të tilla marrëdhënie të posaçme për shkak të lidhjeve familjare ka midis prindërve dhe fëmijëve, bashkëshortëve, vëllezërve, vjehrrit dhe dhëndrit ose nuses, kur këta nuk kanë shkur keq me njëri tjetrin. Marrëdhëni të posaçme të palëve jo për lidhje familjare, por për arsye se ato shkojnë shumë mirë njëra me tjetrën kuptojmë të**

³¹ Neni 92 i Kodit Civil: “Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: a) vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit; b) kryhen për të mashtruar ligjin; c) kryhen nga të mitur nën moshën katërbëdhjetë vjeç; ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa patur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar).”

³² Shiko vendimin Nr. 14, datë 21.01.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

³³ Shiko nenin 233 gërma “c” të K.Pr.Civile.

gjitha ato lloj marrëdhëniesh midis tyre, të cilat, për shkak të karakterit shumë shoqëror ose miqësor e kanë vënë palën tjetër në një pozitë të tillë morale sa ishte në pamundësi të marrë dokumentin shkresor.³⁴

37.4.4. Në vendimin Nr. 932, datë 22.06.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndër të tjera arsyetohet: *“Në rastet e fiktivitetit dhe të simulimit mospërputhjen midis vullnetit dhe çfaqes së tij e duan vetë palët e veprimit juridik. Veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me qëllim që të mbulojë një veprim tjetër juridik të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët kanë dashur ta kryejnë me të vërtetë dhe që rezulton prej kundërdeklarimit si marrëveshje e fshehtë midis tyre.”*, ndërsa në vendimin Nr. 8, datë 26.03.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndër të tjera arsyetohet: *“Sa sipër Kolegjet çmojnë se, kontratat e shitjes se kryera mes paleve të sipërcituara, kanë prodhuar pavlefshmëri absolute, pasi ka rezultuar mungesa e vullnetit të palëve pjesëmarrëse në veprimet juridike të kryera për krijimin, ndryshimin, shuarjen e të drejtave dhe detyrimeve juridike civile. Vullneti i palëve është rezultat i përputhjes së deklarimeve të vullnetit. Në rastin konkret vullneti i jashtëm i deklaruar nga palët prodhon efekte juridike, jo për faktin se, fjalët e caktuara thuhet ose shkruhen në kontratë, por në qoftë se, deklarimi i jashtëm i korrespondon vullnetit të brendshëm të deklaruesit, për kryerjen e veprimeve juridike të caktuara. Siç është provuar në gjykim dhe e argumentuar drejtë nga gjykata në vendim, në rastin konkret ka munguar vullneti i brendshëm i palëve, për të prodhuar pasoja juridike me veprimet juridike të kryera, të cilat me të drejtë, janë konstatuar të pavlefshme, duke u shprehur gjykata edhe për zgjidhjen e pasojave.”* Nga përmbajtja e këtyre vendimeve rezulton se në veprimet juridike simuluese qëllimi i palëve është t’u tregojnë të tretëve dukjen e një veprimi të ndryshëm nga ai që vërtet palët dëshirojnë. Në këto raste, mund të lidhet kontrata e simuluar ndërkohë nga palët tregohet sikur kanë lidhur kontratën tjetër si p.sh.kontratën e dhurimit, ndërsa në të vërtetë është lidhur kontrata e shitjes apo e kundërta sikurse mund të ndodhë për marrjen e një kredie simulohet një kontratë shitje për financimin e blerjes së saj, ndërkohë që në fakt sendi është dhuruar dhe marrjen e kredisë kërkohet për destinacion tjetër. Gjithashtu, mund të kemi dy kontrata të ndryshme përse i përket përmbajtjes: kështu në një shitje mund të simulohet çmimi që në kontratën e simuluar është treguar në një shumë më të vogël se ajo në realitet (arsyet për këtë mund të jenë nga më të ndryshmet, siç mund të jenë arsyet fiskale, pasi tatimi shkon në proporcion me nivelin e çmimit, por mund të jenë edhe të një natyre tjetër, si në rastin e një komisioneri shitjeje, që nga kontrata me prodhuesin, duhet të praktikojë çmimet e përcaktuara nga ky, por megjithatë për të afëruar sa më shumë klientë ai shet me çmime sa më të vogla).³⁵

37.4.5. Gjykata çmon se simulimi është vetëm shkak i paefektshmërisë relative të kontratës. Simulimi krijon pasoja krejtësisht të ndryshme midis palëve dhe të tretëve. Kështu, në nenin 93 të Kodit Civil parashikohet se: *“Kur veprimi juridik është bërë me qëllim për të mbuluar një veprim juridik tjetër, ky i fundit është i vlefshëm në qoftë se*

³⁴ Shiko Vaid Lama “Procedura Civile” Dispensa 1, faqe 166.

³⁵ Shiko Francesco GALGANO “E drejta private”, Botimi i Tretë, Botuar në gjuhën shqipe nga Luarasi, University Press, Tiranë, faqe 350.

përmbush gjithë kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e tij. Veprimi juridik fiktiv ose i simuluar nuk dëmton personat e tretë të cilët në mirëbesim kanë fituar të drejta në bazë të tij.”. Mbështetur në këtë dispozitë p.sh dhurimi jo i simuluar do të krijojë efekte midis palëve vetëm në qoftë se kontrata është redaktuar me akt noterial.³⁶ Këtë qëndrim ka mbajtur dhe praktika gjyqësore kur është kërkuar pavlefshmëria e kontratës së shitjes dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, pasi ajo është bërë në mashtrim të ligjit. Kështu, në vendimin Nr. 176, datë 01.04.2015 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ndër të tjera arsyeton: [...]

21. Kolegji Civil vlerëson se vendimi i gjykatës së apelit është marrë në zbatim të gabuar të dispozitave Kodit Civil, konkretisht nenit 93/1 të tij, i cili parashikon se “... kur veprimi juridik është bërë me qëllim për të mbuluar një veprim juridik tjetër, ky i fundit është i vlefshëm në qoftë se përmbush gjithë kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e tij,...”, si dhe nuk mbështetet në provat e administruara në gjykim.
22. Kolegji Civil, çmon se gjykata e shkallës së parë ka analizuar drejt natyrën e veprimit juridik dhe për zgjidhjen e çështjes është mbështetur në një analizë të saktë të provave konform ligjit të zbatueshëm për rastin konkret.
23. Gjykata e shkallës së parë arsyeton se :”...omissis... kontrata e shitjes e lidhur më datë 10.01.2007 me akt noterial Nr. 95 Rep., Nr.33 Kol, midis paditëses K.SH dhe të paditurit A.SH është një kontratë e simuluar, pasi palët në të vërtetë kanë dashur që të lidhin një kontratë dhurimi dhe në dukje kanë lidhur një kontratë shitje. Fakti që palët kanë dashur që të lidhin një kontratë dhurimi dhe jo shitje rezulton nga këto prova: Pohimi gjyqësor i paditëses, e cila ka pohuar se të paditurin e ka si birin e saj, si dhe ja ka dhënë të gjithë pasurinë me qëllim që i padituri A.SH t'a mbante në pleqëri. Nga marrëdhënia e posaçme që ka paditësja K.SH me të paditurin A.SH, ku nga pohimi gjyqësor i palëve rezultoi se paditësja K.SH e ka rritur të paditurin që 6 muajsh dhe kanë një marrëdhënie si nënë e bir. Në gjykim paditësja K.SH ka pranuar dhe pohuar se çmimi i kontratës së shitjes është fiktiv dhe se i padituri A.SH nuk i ka dhënë asnjë lek për këtë kontratë. Gjykata arrin në konkluzionin se kontrata e shitjes e lidhur midis palëve është e simuluar, pasi në të vërtetë palët kanë dëshiruar që të lidhin një kontratë dhurimi dhe nga çmimi i kontratës, i cili është simbolik rreth 30,000 lekë. Gjykata konstaton se ky çmim është vënë për të shmangur taksën për kalimin e pronësisë. Sipas nenit 92 gërma “ç” të Kodit Civil kontrata e shitblerjes Nr.95 Rep, Nr 33 Kol., datë 10.01.2007, e lidhur midis paditëses dhe të paditurit është e pavlefshme, pasi kjo kontratë është bërë në marrëveshje të palëve pa patur për qëllim që të sjellë pasoja juridike për palët, pra shitjen e sendeve të paluajtshme. Qëllimi i vërtetë i palëve në këtë kontratë ka qenë që sendet e paluajtshme tokë arë dhe shtëpia e banimit t'i dhurohen nga paditësja të paditurit A.S. **Paditësja**

³⁶ Po aty, faqe 352.

kontratën e dhurimit që është mbuluar e ka lidhur me vullnetin e saj të lirë.(...)”.

24. Gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin se kontrata e shitjes me nr. 95 Rep., nr. 33 Kol., datë 10.01.2007, të redaktuar nga notere O.Dani ndërmjet së cilës pala paditëse K.Sh i ka shitur të paditurit A.SH pasuritë e paluajtshme objekt material i këtij gjykimi është bërë me qëllimin të mbulojë veprimin juridik të dhurimit, i cili përmbush të gjitha kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e tij. Kolegji Civil vlerëson se ky përfundim është i drejtë, i bazuar në ligj dhe në provat e administruara në gjykim. [...]³⁷

37.4.6. E njëjta zgjidhje jepet edhe në legjislacionet e vendeve të tjera. Kështu, në nenin 40 të Ligjit “Për marrëdhëniet e detyrimeve” të Republikës së Kosovës, nën titullin “Konversioni i kontratës së pavlefshme”, parashikon se: “*Ku kontrata nule i plotëson kushtet për vlefshmërinë e ndonjë kontrate tjetër, atëherë midis kontraktuesve do të vlejë kjo e dyta, në qoftë se kjo do të ishte në përputhje me qëllimin të cilin kontraktuesit e kanë pasur parasysh kur e kanë lidhur kontratën dhe në qoftë se mund të merret se këta do ta lidhin këtë kontratë po të ishin në dijeni për nulitetin e kontratës së tyre.*”. Me konversion të kontratës së pavlefshme nënkuptojmë shndërrimin e kontratës fillestare të pavlefshme në një kontratë tjetër të vlefshme, nëse tregohet se kontrata fillestare nuk i ka prezumimet e duhura të një kontrate të vlefshme, por vetëm disa, por ato janë të mjaftueshme për vlefshmërinë e një kontrate tjetër lidhjen e së cilës bashkëkontraktuesit gjithashtu e duan, sepse me këtë arrihet ai qëllim të cilin ata e kanë dashur në momentin e lidhjes së kontratës së parë.³⁸

37.4.7. Duke u rikthyer në rastin konkret, Gjykata mbështetur në nenin 681 të Kodit Civil, ku parashikohet se: “*Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës.*”, si dhe në provat e administruara gjatë gjykimit, arrinë në përfundimin se Kontrata e Shitblerjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006, si dhe Kontrata e Shitblerjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006, të lidhur

³⁷ Lidhur me vlerën e jurisprudencën së Gjykatës së Lartë në interpretimin e dispozitave ligjore, si “*gjykatë ligji*”, në vendimin Nr. 6, datë 17.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese, ndër të tjera thuhet se: “9. Gjykata vlerëson t’i referohet konceptit të së “*drejtës së gjallë*”, e kuptuar përgjithësisht në sensin e ekzistencës së një “*jurisprudence konstante*”, “*të konsoliduar*” mbi një dispozitë të caktuar ligjore (duke pasur pra parasysh mënyrën se si ajo “*jeton*” në realitetin konkret). Përdorimi i formulës së “*të drejtës së gjallë*” e ndihmon Gjykatën të përcaktojë raportet me gjyqtarët e zakonshëm në terrenin e interpretimit të së drejtës (e njohur si detyrë që u takon posaçërisht këtyre të fundit) duke marrë në lidhje me këtë një qëndrim vetëkufizues (self restraint) në kuptimin që, nëse një e drejtë e tillë e gjallë ekziston, Gjykata e mban parasysh dhe (me disa përjashtime) nuk ndalet të bëjë një interpretim të ndryshëm, edhe atje ku i duket asaj më bindëse. Kompetenca e Gjykatës ndalet përpara interpretimit konstant jurisprudencial pasi, edhe në autonominë e saj të plotë të gjykimit Gjykata nuk mund të mos ketë parasysh një interpretim të tillë që i njej normës legislative vlerën e saj efektive në jetën juridike, duke qenë se normat janë jo ato që propozohen në mënyrë abstrakte por ato që zbatohen në punën e përditshme të gjyqtarit, që synon t’i bëjë konkrete dhe efektive (shih vendimin nr.350, datë 13-21 nëntor 1997, të Gjykatës Kushtetuese Italiane).”.

³⁸ Shiko Prof.Dr.Nerxhivate Dauti, Av.Ruzhdi Berisha, Av.Adem Vokshi, Prof.Dr. Avdulla Aliu, Komentari “Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve”, Prishtinë, Shtator 2013, faqe 108.

përpara Noteres L.K, me palë: **Shitësit:** R.K, S.K dhe E.K; **Blerës:** Etleda Çiftja hynë në kategorinë e veprimit juridike simuluese, pasi qëllimi i vërtetë i palëve në lidhjen e këtyre kontratave ka qenë të mbulojë veprimin juridik të dhurimit. Gjykata arrinë në këtë përfundim duke mbajtur në konsideratë këto fakte:

1) mbështetur në Ligji Nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar, si dhe në vendimin Nr. 255, datë 2.8.1991 “PËR KRITERET E NDARJES SË TOKËS BUJQËSORE”, i ndryshuar, ku ndër të tjera thuhet se: “2. Në të gjitha rastet toka ndahet përpjesëtimisht për çdo familje sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 1 gusht 1991. Në numrin e frymëve të familjes anëtarë të kooperativës bujqësore do të llogriten gjithë frymët e saj si, fëmijët, nxënësit, studentët, ushtarët, pensionistët, anëtarët e familjeve kooperativiste që punojnë me kontratë provizore dhe refugjatët, pavarësisht nga seksi, duke përjashtuar anëtarët e familjes që në momentin e ndarjes së tokës janë në marrëdhënie pune të përhershme me sektorin shtetëror ose privat.”, shtetasit R.K bazuar në Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi me Nr. {***}, datë 15.09.1995, i është dhënë në pronësi gjithsej **27191 m²tokë**. Më datë 21.06.2006 shtetasi R.K është pajisur me Çertifikatat e Pronësisë. Po ashtu, sipas Çertifikatës Familjare lëshuar më datë 04.10.2021 nga Njësia Administrative Kryeviidh, rezulton se më datë 01.08.1991, përbërja e familjare e shtetasit R.K ishte me pesë persona, ky i fundit, bashkëshortja S.K, si dhe fëmijët Etleda Çiftja, E.K dhe O.K. Pra, e pandehura Etleda Çiftja në datën 01.08.1991 bënte pjesë në trungun familjar të shtetasit R.K, për rrjedhojë ajo ka ndikuar në sasinë e tokës që është pajisur ky i fundit;

2) mbështetur në nenin 5, gërma “b” të Ligjit Nr. 8337, datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadhe dhe kullotave”, ku parashikohet shprehimisht se: “Familja bujqësore që i kalon pronësinë e saj mbi tokën bujqësore, pyjore, livadhet dhe kullotat çdo shtetasi, personi fizik dhe juridik vendas në përputhje me kërkesat ligjore për kalimin e pasurisë së paluajtshme, paraqet në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme dokumentet vijuese:b) Aktet që vërtetojnë përbërjen e familjes bujqësore në çastin e kalimit të pronësisë, të vërtetuar nga çertifikata e gjendjes civile, vërtetimi i pushtetit lokal dhe deklarata e përbashkët e anëtarëve të familjes...”, anëtarët e familjes bujqësore në çastin e kalimit të pronësisë konkretisht R.K, S.K dhe E.K, konfirmuar me çertifikatën familjare dhe vërtetimin e pushtetit lokal, i kaluan të pandehurës Etleda Çiftja tokën arë objekt i kontratave të shitjes;

3) Sipas deklarimit të shtetasve R.K, S.K dhe të pandehurës E.Ç, si dhe nga të gjitha provat e administruara rezulton se, në fakt kjo pronë i është dhuruar të pandehurës, pasi nuk është paguar shuma e cituar në kontratën e shitjes. Qëllimi i lidhjes së kontratës është të ndihmonin vajzën e tyre për të marrë kredi, pra vendosjen si kolateral dhe t’i jepnin tokën arë që asaj i takonte sipas Ligjit 7501 “Për tokën”. Pra, në rastin konkret jemi përpara një marrëdhënie të posaçme prind-fëmijë dhe vëlla-motër;

4) Sipas noteres L.K çmimi 50,000 (pesëdhjetë mijë) Euro për pronën e vendosur në kontratën e shitjes, u ndryshua po atë ditë, me mirëkuptim të palëve në kontratë të cilët e nënshkruan përsëri, dhe ky ndryshim u bë sepse banka nuk ja pranonte, këtë pronë si kolateral me çmimin 300, 000 (treqindë mijë) lekë. Në deklarin e saj, shtetësja L.K thekson se ajo ka qenë notere e bankës Emporiki që nga themelimi i saj dhe këtë informacion e ka marrë nga banka. Pra, vlera e kontratës ka qenë e diktuar nga Emporiki Bank, për rrjedhojë palët kanë dashur vetëm dukjen e këtij veprimi juridik për të tretët, pasi qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve ka qenë të kalojnë pronësinë tek e pandehura pa kundërshtim, pra për të lidhur kontratë dhurimi dhe më pas të vendosej si kolateral në bank për marrjen e kredisë;

5) u provua gjatë gjyqimit se shuma e kredisë nuk është përdorur për financimin e tokës arë, por për blerjen e apartamentit nga e pandehura Etleda Çiftja.

37.4.8. Në nenin 93 të Kodit Civil parashikohet se: *“Kur veprimi juridik është bërë me qëllim për të mbuluar një veprim juridik tjetër, ky i fundit është i vlefshëm në qoftë se përmbush gjithë kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e tij. Veprimi juridik fiktiv ose i simuluar nuk dëmton personat e tretë të cilët në mirëbesim kanë fituar të drejta në bazë të tij.”*. Mbështetur në këtë dispozitë p.sh dhurimi jo i simuluar do të krijojë efekte midis palëve vetëm në qoftë se kontrata përmbushë të gjitha kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e saj. Në vendimin unifikues Nr. 1, datë 06.01.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndër të tjera arsyetohet: *“Në nenin 79 të Kodit Civil është parashikuar shprehimisht: “Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”. Në analizë të kësaj dispozite që një veprim juridik të jetë i vlefshëm duhet që të plotësohen këto kushte: 1- Palët që kryejnë veprimin juridik duhet të kenë zotësinë për të vepruar; 2- Vullneti i brendshëm i palëve në një veprim juridik duhet të përputhet me shfaqjen e tij të jashtme; 3 - Veprimi juridik duhet të realizohet në formën e kërkuar nga ligji. Mjafton plotësimi i elementëve të mësipërme për të bërë të vlefshëm veprimin juridik. Fryma e legjislacionit tonë në fuqi është se vetëm në rast të mungesës së njërit prej këtyre elementëve do të ndodhemi përpara rastit të pavlefshmërisë së veprimit juridik.”*. Në rastin konkret, Gjykata çmon se Kontrata e Shitblerjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006, si dhe Kontrata e Shitblerjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006, të lidhur përpara noteres L.K, me palë: **Shitësit:** R.K, S.K dhe E.K; **Blerës:** Etleda Çiftja janë bërë me akt noterial si dhe vullneti i brendshëm i palëve është të lidhin kontratë dhurimi që është veprimi juridik i mbuluar në rastin e konkret. Ky i fundit duket se i plotëson kushtet e një veprimi juridik të vlefshëm, ndërsa kontrata e shitjes hynë në kategorinë e veprimeve juridike absolutisht të pavlefshëm.

37.5. Në nenin 79 të Kodit Civil nën titullin **“Përkufizimi i veprimit juridik”** parashikohet se: *“Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile.”*, ndërsa në nenin 659 të Kodit Civil parashikohet se: **“Kontrata është veprim juridik me**

anë të së cilës një ose disa **palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike**". Mbështetur në këto dispozita, Gjykata çmon se kontratat janë produkt i vullnetit të palëve që nënshkruajnë atë. Prandaj, nëse një kontratë është apo jo origjinale, varet nëse ajo është e nënshkruar dhe është shprehje e vullnetit të palëve që janë pjesë e saj. Sipas doktrinës të së drejtës penale **karakteristikë e veprës penale falsifikimi i dokumentit është ajo se dokumenti nuk rrjedh nga personi i cili është shënuar në të si lëshues (dhënës) i tij**. Atë e bën të rremë fakti se ai i atribuohet personit i cili nuk e ka lëshuar atë dhe tentohet që të krijohet përshtypja se pikërisht një person i caktuar është lëshues (dhënës) i tij (dokumentit), edhe pse në fakt ai nuk e ka lëshuar. **Dokumentit i rremë ekziston edhe atëherë kur përmbajtja e tij është e saktë, por atë nuk e ka lëshuar personi i cili në dokument është shënuar si lëshues (dhënës) i tij**. Veprimi i kryerjes është përcaktuar në mënyrë alternative dhe mund të qëndroj në *përpilimin e dokumentit të rremë apo në ndryshimin e dokumentit të vërtetë*, me qëllim që një dokument i tillë të përdoret si i vërtetë. *Përpilimi është hartim i plotë apo i pjesshëm i dokumentit të rremë. Përpilimi i ri i plotë i dokumentit do të ekzistonte atëherë kur ndonjë personi i atribuohet deklarata të cilën ai fare nuk e ka dhënë*. Vepra penale ekziston edhe në situatën ku personi i shënuar në dokument nuk ekziston fare apo ka vdekur. Përpilimi i rremë ekziston edhe atëherë kur është përpiluar pjesërisht dokumenti i rremë – në dokumentin ekzistues origjinal (*të vërtetë*) një pjesë fshihet, i jepet përmbajtje tjetër, i shtohet emri edhe i ndonjë personi, përpos dhënësit të dokumentit, apo shlyhet emri i ndonjë personi që është lëshues (dhënës) i dokumentit etj. Kështu, p.sh. ekziston vepra penale e përpilimit të dokumentit të rremë në situatën kur kreditori falsifikon nënshkrimin e debitorit në dokument me të cilën kinse ai pranon borxhin që vërtet ekziston, ndërsa kreditori ka përpiluar dokumentin e falsifikuar me qëllim që në kontestin civil, të cilin është duke e zhvilluar, ta dëshmojë më lehtë ekzistimin e borxhit (*dokumenti i falsifikuar me përmbajtje të vërtetë*), apo kur ndonjë person nënshkruan dokumentin me emrin dhe mbiemrin e tij të vërtetë, por përmbajtja e dokumentit dhe rrethanat e tjera flasin pa mëdyshje për atë se lëshues (dhënës) i dokumentit është një person tjetër me emër dhe mbiemër të njëjtë, (p.sh. *dokumentin për shitblerjen e ndonjë paluajtshmërie e ka nënshkruar një person me emrin dhe mbiemrin e tij, ndërsa pronar i asaj paluajtshmërie, sipas gjendjes në librat kadastral, është një person tjetër me të njëjtin emër dhe mbiemër*), ose kur kryerësi një ish-dokument të vërtetë, (dhënës i të cilit është ndonjë person tjetër), vlefshmëria e të cilit është anuluar, (duke iu vënë shenja-vula i anuluar), me bashkimin e pjesëve të tij apo me asgjësimin e shenjave me të cilat dokumenti ka qenë i anuluar, i jepet përsëri vlera e tij juridike. Përpilimi i dokumentit nënkupton krijimin e një dokumenti që nuk ka ekzistuar gjer në atë moment, ashtu që, me vendosjen e nënshkrimit të ndonjë personi në përmbajtjen e caktuar, krijohet përshtypja se personi i nënshkruar vërtet e ka lëshuar një deklaratë të tillë. Esenca e kësaj vepre penale qëndron në atë se personi që është i caktuar si lëshues dokumenti, këtë nuk e ka lëshuar fare dhe me këtë rast nuk është relevante nëse përmbajtja e dokumentit është ose jo e vërtetë. **Ndryshimi i dokumentit paraqet ndërrimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal (autentik), duke bërë ndryshimin pjesërisht të tij, ashtu që dokumenti**

merr kuptim tjetër nga ai që kishte dokumenti origjinal (autentik). Pra, bëhet fjalë për ndryshim të tillë të dokumentit që ka rëndësi për vlerën provuese të tij. Ky mund të bëhet me ndryshimin e përmbajtjes së dokumentit, (shtimin apo heqjen e numrave, korrigjimin, shlyerjen dhe shtimin e disa fjalëve) apo ndryshimin e nënshkrimit ose ndryshimin e të dyjave së bashku. **Për ekzistencën e veprës nuk është çështje relevante saktësia e përmbajtjes së dokumentit; me rëndësi është që dokumenti origjinal (autentik) është ndryshuar.** Dallimi mes përpilimit të dokumentit të rremë dhe ndryshimit të dokumentit origjinal (autentik) qëndron në atë se përpilimin e dokumentit e karakterizon fakti se ai nuk rrjedh nga personi i cili në dokument është shënuar si lëshues (dhënës) i tij, ndërsa ndryshimi i dokumentit autentik nënkupton ndryshimin e paautorizuar të përmbajtjes së dokumentit, i cili, pas kësaj, nuk shpreh më deklaratën e dhënësit.³⁹

37.5.1. Mbështetur në sqarimin e kuptimit të falsifikimit të dokumenteve, Gjykata çmon se Kontrata e Shitblerjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006, si dhe Kontrata e Shitblerjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006, të lidhur përpara Noteres L.K, me palë: **Shitësit:** R.K, S.K dhe **E.K;** **Blerës:** Etleda Çiftja, **nuk futen në kategorinë dokumenteve të falsifikuara, pasi këto dokumente janë origjinale dhe shprehje e vullnetit të palëve.** Do të ishim përpara falsitetit të tyre nëse ky dokument nuk do të rridhte nga palët. Sipas nenit 659 të Kodit Civil në rastin konkret, palët kanë të drejtë të krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike. Në rastin konkret, këto kontrata hyjnë në kategorinë e veprimeve juridike simuluese, pasi qëllimi i vërtetë i palëve në lidhjen e këtyre kontratave ka qenë *të mbulojë veprimin juridik të dhurimit*, i cili përmbush të gjitha kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e tij, me qëllim sigurimin e një kredie bankare nga e pandehura Etleda Çiftja për të financuar apartamentin e vetëm që ajo ka në pronësi.

35.5.2. Në vendimin Nr. 932, datë 22.06.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndër të tjera arsyetohet: *“Në rastet e fiktivitetit dhe të simulimit mospërputhjen midis vullnetit dhe çfaqes së tij e duan vetë palët e veprimit juridik”.* Në rastin konkret ekziston vullneti i jashtëm për të kryer veprimet juridike që është Kontrata e Shitjes por që nuk përputhet me vullnetin e brendshëm që është në fakt lidhja e Kontratës së Dhurimit. **Pasojat e mospërputhjes midis vullnetit të jashtëm me atë të brendshëm në kryerjen e veprimeve juridike janë të karakterit civile sikurse parashikohet në nenin 92 dhe 93 të Kodit Civil, duke mos sjellë pasoja juridike si veprim juridik absolutisht i pavlefshëm.** Nga studimi i praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë nuk ka ndodhur asnjëherë që kryerja e veprimeve juridike fiktive apo simuluese të shoqërohen me fillimin e ndjekjes penale për figurën e veprës penale të *“Falsifikimit të dokumenteve”* parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Kjo me të drejtë pasi **nuk ka sens logjik dhe juridik të mbash përgjegjësi penale për një mosmarrëveshje juridiko-civile, dhe për më tepër kur vetë Kodi Civil parashikon që i njëjti akt (dokument/kontrat) që është i pavlefshëm pasi është bërë me qëllim për të mbuluar**

³⁹ Shiko Prof.Dr.Ismet Salihu, Mr.Sc. Hilmi Zhitija, Dr.Sc.Fejzulla Hasani, Komentari “I Kodit Penal të Republikës së Kosovës”, Prishtinë, Mars 2014, faqe 128, 129 dhe 130.

një veprim juridik tjetër, ky i fundit mund të jetë i vlefshëm në qoftë se përmbush gjithë kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e tij.

35.5.3. Në vendimin Nr. 37, datë 25.07.2013 të Gjykatës Kushtetuese ndër të tjera arsyetohet se: **“32...Në vlerësimin e Gjykatës, kryerja e një vepre penale përbën formën më të rëndë të shkeljeve të ligjit..”**, për rrjedhojë nëse legjislatori do të donte të ngrinte në nivelin e kryerjes së një vepre penale të kryer një veprim juridik fiktiv apo simulues, nuk mund t'i jepte vlerë juridike veprimit juridik që është dashur nga palët **“veprimi juridik i mbuluar”**, pasi nga një veprim i paligjshëm që përbën vepër penale nuk mundet kurrësesi të rrjedhin të drejta të ligjshme. Madje nëse dokumenti, pra kontrata si veprim juridik i simuluar, do të bënte që të konsumohej figura e veprës penale **“Falsifikim i dokumenteve”**, gjykata në respektim të nenit 190 pika 1, gërma “c” të K.Pr.Penale⁴⁰ sikurse ka kërkuar prokuroria në përfundim të gjykimit, duhet të vendosë si rregull asgjësimin e dokumentit (kontratës së simuluar). Nëse dokumenti do të asgjësohej në kuadrin e një procedimi penal atëherë neni 93 i Kodit Civil, ku parashikohet se: **“Kur veprimi juridik është bërë me qëllim për të mbuluar një veprim juridik tjetër, ky i fundit është i vlefshëm në qoftë se përmbush gjithë kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e tij. Veprimi juridik fiktiv ose i simuluar nuk dëmton personat e tretë të cilët në mirëbesim kanë fituar të drejta në bazë të tij.”**, nuk do të gjente zbatim asnjëherë në praktikë. Kjo për faktin pasi mbështetur në këtë dispozitë nëse është lidhur një kontratë shitje e cila është bërë me qëllimin të mbulojë veprimin juridik të dhurimit, gjithmonë dhurimi jo i simuluar do të krijojë efekte midis palëve vetëm në qoftë se kontrata është redaktuar me akt noterial.⁴¹ Por nëse kontrata e shijes simuluese do të asgjësohej si provë materiale e veprës penale të **“Falsifikimit të dokumenteve”** do të mungonte akti noterial për të provuar ekzistencën e marrëdhënies juridike civile të **dhurimit të mbuluar** që i plotëson kushtet e vlefshmërisë pasi: **i)** përputhet vullneti i brendshëm dhe i jashtëm i palëve dhe **ii)** është respektuar forma për kryerjen e veprimit juridik me akt noterial.⁴² Pra, Kodi Civil njih shndërrimin e kontratës fillestare të pavlefshme (veprimin juridik simulues) në një kontratë tjetër të vlefshme. E njëjta situatë juridike është edhe për personat e tretë që në kushtet e mirëbesimit kanë fituar të drejta mbi bazën e një veprimi juridik fiktiv apo të simuluar.⁴³

⁴⁰ Në nenin 190 pika 1, gërma “c” të K.Pr.Penale, nën titullin **“Disponimi për provat material”** parashikohet shprehimisht se: **“1. Në vendimin përfundimtar ose në atë të pushimit të çështjes, gjykata ose prokurori caktojnë se çfarë duhet bërë me provat materiale duke urdhëruar: ...c) sendet që nuk kanë asnjë vlerë zhduken;..”**

⁴¹ Shiko Francesco GALGANO “E drejta private”, Botimi i Tretë, Botuar në gjuhën shqipe nga Luarasi, University Press, Tiranë, faqe 352.

⁴² Në nenin 83 të Kodit Civil thuhet shprehimisht se: **“Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohët, përndryshe nuk është i vlefshëm. Është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji.”**

⁴³ Shiko nenin 607 të Kodit Civil nën titullin **“Kundërshtimi i veprimeve juridike të debitorit”**, ku parashikohet shprehimisht se: **“Kreditori ka të drejtë të kërkojë që të deklarohen të pavlefshme veprimet juridike të kryera nga debitori me qëllim që të pakësojë sasinë ose vleftën e pasurisë së tij në dëm të kreditorit, me kusht që kredia të ketë lindur më parë se të jetë kryer veprimi juridik. Kur veprimi juridik është bërë me kundërshtim, duhet që edhe personi, me të cilin debitori ka kryer këtë veprim, të ketë**

37.6. Së dyti, nëse i referohemi praktikës së zhvilluar nga Gjykata Supreme e Kasacionit në Itali, ndonëse në një kontekst ligjor të ndryshëm, vëmë re se kjo gjykatë ka trajtuar me kujdes të veçantë temën e falsitetit të dokumenteve nga privatët. Gjykata Supreme e Kasacionit të Italisë, e klasifikon rastin e falsitetit të padobishëm (falso inutile) si atë falsitet që prek tërësisht apo pjesërisht një akt shkresor i cili në vetvete nuk ka aspak vlerë provuese. Kështu, në **vendimin Nr. 26511, datë 22 Shtator 2020 të Seksionit V Penal të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Italisë**, ndër të tjera arsyetohet se: *“1.2.3. Duhet theksuar që lidhur me falsifikimin e dokumenteve, falsifikimi i padëmshëm (lexo jo cenes) ndodh në rast të mosekzistencës së objektit tipik të falsifikimit, kur mosekzistenca ka të bëjë me mungesën absolute të vlerës provuese të dokumentit, si dokument inekzistent ose **absolutisht i pavlefshëm**. (Seksioni 5 nr. 28599 07/4/2017, Bautista, Rv. 270245; Seksioni 5, nr. 11498 05/07/1990. Casarola, Rv. 185132; Seksioni 54/41, nr. 205/ 1984, Marinelli, Rv. 164742).”*. Në nenin 92 të Kodit Civil parashikohet shprehimisht se: *“**Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike**. Të tilla janë ato që: ...ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa patur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar).*”. Ndërkohë në vendimin Unifikues Nr. 13, datë 9.3.2006 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndër të tjera arsyetohet se: *“**Veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët, për pasojë ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm**. Kur gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes, konstaton se një veprim juridik është absolutisht i pavlefshëm, ajo nuk jep vendim për deklarimin e tij të pavlefshëm, por kufizohet vetëm në vërtetimin e pavlefshmërisë dhe, duke u nisur nga kjo, zgjidh konfliktin e palëve ndërgjyqëse rreth marrëdhënies juridike përkatëse....”*. Nga analiza e jurisprudencës së mësipërme, konkludohet se veprimet juridike fiktive ose simuluese që janë absolutisht të pavlefshëm nuk përbëjnë vepër penale, por hyjnë në kategorinë e dokumenteve që sipas praktikës konsiderohen falsifikim i padëmshëm. Gjykata çmon se nëse do të penalizohej çdo pavërtetësi e materializuar në një dokument, atëherë do të ndëshkohej penalisht çdo kërkesë padi e rrëzuar në gjykatë, çdo kërkesë e ndërmjetme e palëve, e cila rrëzohet si e pabazuar nga gjykata, çdo ankim apo rekurs i pabazuar, çdo kërkesë e pambështetur drejtuar organeve të administratës shtetësore, çdo artikull i media të shkruara apo i portaleve elektronike që nuk pasqyrojnë të vërtetën,⁴⁴ si dhe çdo letër private me përmbajtje të pavërtetë, pavarësisht se sa e pavlerë mund të jetë për marrësin pavërtetësi e paraqitur.

*patur dijeni për qëllimin e dëmtimit të debitorit. Por kur ky person është bashkëshort, prind, gjysh, fëmijë ose fëmijë e fëmijës, vëlla ose motër e debitorit, dijenia e qëllimit të dëmtimit prezumohet, gjersa të provohet e kundërta. **Me deklarimin e veprimit juridik si të pavlefshëm, nuk cënohen të drejtat që kanë fituar me kundërshtim personat e tretë me mirëbesim para ngritjes së padisë për deklarimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik.**”*

⁴⁴ Në këtë rast gazetarët nuk mbajnë përgjegjësi penale për figurën e veprës penale “Falsifikim dokumenteve” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, por mbajnë përgjegjësi për figurat e veprës penale “Fyerje” ose “Shpifje” parashikuar nga nenet 119 dhe 120 të Kodit Penal. Ndërkohë nëse artikulli ka karakter fyesë për gjyqtarët, prokurorët ose avokatët mbahet përgjegjësi penale për figurën e veprës penale “Fyerja e gjyqtarit” parashikuar nga neni 318 i Kodit Penal, por kurrësi për figurën e veprës penale “Falsifikim i dokumentave”.

37.7. Së treti, Gjykata çmon se figura e veprës penale “*Falsifikim i dokumenteve*” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal nuk konkuron asnjëherë me figurën e veprës penale “*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë*”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, kur shërben si mjet për të provuar anën objektive të kësaj të fundit sikurse është deklarimi i rremë apo fshehja e pasurisë. Në vendimin unifikues Nr. 3, datë 02.11.2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë,⁴⁵ ndër të tjera arsyetohet se: “**28. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, në rast konkurrimi të normave penale, fakti që konsiderohet si vepër penale duket sikur parashikohet nga dy ose më shumë dispozita penale, por në të vërtetë kemi një vepër të vetme dhe nuk aplikohen dispozitat mbi bashkimin e veprave penale. Në këto raste, dispozitat e ndryshme që parashikojnë të njëjtën fakt si vepër penale, ose përjashtojnë njëra tjetrën, ose thithin njëra tjetrën, për arsye se marrëdhënia juridike që është cenuar, mbrohet nga dispozitat penale që parashikojnë si vepër penale të njëjtin fakt. Për të zgjidhur çështjen e zbatimit të saktë të normës ligjore, dhe si pasojë, cilësimin e saktë ligjor të veprës penale të parashikuar nga norma e zbatueshme, në rastin kur në pamje të parë (prima facie), në të njëjtën kohë duket sikur veprojnë më shumë se një dispozita penale, si kriteret logjike dhe juridike për zgjidhjen e kësaj çështjeje nga doktrina janë elaboruar këto parime: i) **parimi i specialitetit** (lex specialis derogat legi generali), ii) **parimi i subsidiaritetit** (lex primaria derogat legi subsidiariae), iii) **parimi i përthithjes** (lex consumens derogat legi consumptae). **29. i)** Në bazë të parimit të specialitetit, kur dy norma ligjore rregullojnë të njëjtën lëndë, zbatohet norma e posaçme, e cila ka përparësi dhe shmang normën e përgjithshme, kjo në përputhje me kriterin e përgjithshëm juridik për zgjidhjen e kundërshtive lex specialis derogat legi generali. **Raporti i specialitetit ekziston kur elementet përbërëse të një norme penale (të përgjithshme) janë të gjithë të pranishëm edhe në një normë tjetër (e posaçme), e cila përveç tyre, përmban edhe disa elemente më specifike që e cilësojnë normën e dytë, të posaçme në raport me normën e parë. Norma e përgjithshme përmbahet krejtësisht në normën e posaçme, kjo e fundit ka një përmbajtje më të gjerë dhe e përfshin të parën (marrëdhënie lloj dhe specie), prandaj shkelja e normës së posaçme (si normë me madhe) logjikisht përfshin edhe shkeljen e normës së përgjithshme (norma më e vogël), ndaj vetëm norma e posaçme do të zbatohet. Sa më e madhe të jetë prania e elementëve specifikues përbërës të një norme penale inkriminuese, aq më e ngushtë është fusha e veprimit dhe e zbatimit të saj, në raport me normën e përgjithshme, duke pasur kjo e fundit më pak elementë rrethorë që****

⁴⁵ Gjykata konstaton se, ky vendim unifikues nuk rezulton që të jetë ndryshuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë sipas nenit 438 të K.Pr.Penale nën titullin “**Ndryshimi i praktikës gjyqësore**” ku parashikohet shprehimisht se: “1. Gjykata e Lartë, kryesisht ose me kërkesë të palëve, kur lind nevoja për ndryshimin e praktikës gjyqësore, ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në kolegjet e bashkuara çështje të ardhura për gjykim në Kolegjin Penal. 2. Tërheqja e çështjeve bëhet me vendim të Kryetarit të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjit Penal. 3. Kolegjet e bashkuara gjykojnë sipas rregullave të caktuara për kolegjin kur marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Gjykatës së Lartë. **4. Vendimi i Kolegjit Penal dhe kolegjeve të bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme.**”. Ndodhur në këto kushte, Gjykata është e detyruar ta zbatojë vendimin unifikues edhe në rastet se do të kishte një qëndrim të ndryshëm mbi interpretimin e ligjit që është bërë objekt i unifikimit.

e kufizojnë fushëzbatimin e normës së përgjithshme, e cila rrjedhimisht gjen një zbatim më të gjerë. Meqenëse norma e përgjithshme ka një fushëzbatim më të gjerë nga ajo e posaçme, një fakt që përbën veprën penale që hyn në fushëzbatimin e normës së posaçme, do të hyjë edhe në fushëzbatimin e normës penale të përgjithshme. Megjithatë, po t'i zbatonim të dyja normat penale do dyfishoheshin efektet dhe do të shkelej parimi i ndalimit të gjyqimit dy herë mbi të njëjtin fakt. Prandaj, vetëm njëra normë inkriminuese do të gjejë zbatim, ajo e posaçme, sepse norma e përgjithshme do përfshihet nga norma e posaçme. Baza e zbatimit të këtij parimi mbështetet në faktin se kemi të bëjmë me të njëjtën lëndë, domethënë me të njëjtin objekt; pra me të njëjtën marrëdhënie juridike të mbrojtur nga norma penale inkriminuese.”⁴⁶ Gjykata çmon se pasqyrimi i të dhënave të rreme në dokumente që përbën anën objektive të “Falsifikimit të dokumenteve” janë të pranishme edhe në një figurë të posaçme të veprës penale sikurse është “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, ku ndër të tjera thuhet se: “Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive...” Deklarimi i rremë në këtë rast bëhet në deklaratat e pasurisë dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet atyre. Ndodhur në këto kushte, Gjykata çmon se këto dy vepra penale nuk duhet të konkurrojnë me njëra tjetrën, pasi në rastin konkret duhet të zbatohet parimi i specialitetit të konkurrimit të normave penale “lex specialis derogat legi generali”⁴⁷ duke gjetur zbatim vetëm nënin 257/2 i Kodit Penal. Pra, edhe nëse do të ishte konsumuar figura e veprës penale “Falsifikim i dokumentave” në rastin konkret, prokuroria, duhet të ngrinte akuzë vetëm për figurën e veprës penale të parashikuar nga neni 257/2 i Kodit Penal si figurë e posaçme e veprës penale në raport me nënin 186 të Kodit Penal që është një figurë e përgjithshme e veprës penale. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në raste të ngjashme.⁴⁸ Ndodhur në këto kushte, Gjykata çmon se prokuroria bazuar në nenet 328 pika 1, gërma “d” dhe 329/a të K.Pr.Penale duhet të kishte kërkuar tek gjyqtari i seancës paraprake pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurës Etleda Çiftja për figurën e veprës penale të “Falsifikim i dokumenteve” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, pasi ndjekja penale nuk duhej filluar, dhe me qënë se ka filluar, ajo duhej pushuar.

⁴⁷ Gjykata Kushtetuese e Republikë së Shqipërisë me vendimin Nr. 2, datë 03.02.2010, ndër të tjera ka theksuar se: “Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër (lex superior derogat inferiori). Parimet, se norma specifike ka përparësi nga norma e përgjithshme (lex specialis derogat generali) dhe se norma që ka hyrë në fuqi më vonë ka përparësi nga norma e mëparshme, nuk veprojnë në raste të tilla.”

⁴⁸Shiko Vendimin Nr. 354, datë 20.12.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ku ndër të tjera arsyetohet se: “Në nenin 145 të Kodit Penal parashikohet se: “Paraqitja e rrethanave të rreme në lidhje me objektin që sigurohet ose krijimi i rrethanave të rreme dhe paraqitja e tyre në dokumentet duke përfutuar padrejtësisht sigurime, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet”....Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se i gjykuari nuk duhet të mbajë përgjegjësi penale për falsifikimin, jo për faktin se nuk provohet ta ketë kryer, por se veprimet e tij në lidhje me përdorimin e dokumenteve të falsifikuar janë pjesë përbërëse e realizimit të qëllimit kriminal të mashtrimit në sigurime. Kolegji Penal çmon se falsifikimi nëpërmjet përdorimit dhe vepra penale e mashtrimit në sigurime për të gjykuarin nuk konkurrojnë si vepra penale më vete.”.

37.8. Së katërti, Gjykata çmon të theksojë fakti se pavarësisht se veprimet juridike fiktive ose të simuluara nuk plotësojnë elementët e figurës së veprës penale të “*Falsifikimit të dokumenteve*” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, përpilimi dhe përdorimi i tyre në praktikë mund të passjellë përgjegjësi penale për vepra të tjera penale. Kështu, nëse këto veprime juridike bëhen me qëllim mospagimin e taksave në vlerën e parashikuar nga kuadri ligjor në fuqi atëherë mund të konsumohet figura e veprës penale “**Fshehja e të ardhurave**” parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal. Në datën kur janë përpiluar kontratat e shitjes së tokave⁴⁹ arë nga e pandehura Etleda Çiftja, më datë 10.07.2006 kjo vepër penale ka pasur këtë përmbajtje: “*Fshehja apo tregimi i rremë i të ardhurave ose i objekteve që i nënshtrohen tatimeve dhe taksave, kur më parë janë marrë masa administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.*”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se që të konsumohet kjo vepër penale duhet më parë të jetë marrë masë administrative nga organet tatimore. Në rastin konkret nuk rezulton që të jetë marrë ndonjë masë e tillë ndaj familjarëve të të pandehurës Etleda Çiftja, pasi kjo e fundit në kontratat e shitjes nuk paraqitet në pozicionin e shitësit që të mund të përfitonte të ardhura. Megjithatë në rastin konkret nuk është konsumuar kjo vepër penale pasi nuk është marrë masë administrative më parë. Për këto arsye, Gjykata e konsideron të drejtë analizën juridike të bërë nga prokuroria në kërkesën për gjykim se nuk është konsumuar në rastin konkret kjo vepër penale.

37.8.1. Gjithashtu, përpilimi dhe përdorimi i veprimeve juridike fiktive ose të simuluara mund passjellë përgjegjësi penale për figurën e veprës penale “**Mashttrim në kredi**” parashikuar nga neni 146 i Kodit Penal, ku parashikohet shprehimisht se: “*Mashtrimi në dokumentet e paraqitura, duke përfituar padrejtësisht kredi duke regjistruar në mënyrë fiktive në hipotekë objekte që nuk ekzistojnë, ose tej vlerës së tyre reale, ose në pronësi të një tjetri, të bëra me qëllim për të mos kthyer më kredinë e marrë, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.*”. Objekti i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar administrimin dhe përdorimin e rregullt të kredive të marra nga banka, kthimin e tyre, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal, nga veprimet kriminale. Nga ana objektive kjo vepër kryhet me veprime aktive të cilat renditen në dispozitën e sipërcituar dhe konsistojnë në mashttrim në dokumentet e paraqitura, i cili mund të kryhet në forma të ndryshme si: **i)** Duke regjistruar në mënyrë fiktive në hipotekë objekte që nuk ekzistojnë; **ii)** Duke paraqitur pranë bankës të dhëna për objektet që do vihen si garanci tej vlerës reale të tyre; ose **iii)** duke regjistruar objekte në pronësi të të tjerëve. Veprime këto të cilat kryhen me qëllim përfitimin padrejtësisht të kredisë.⁵⁰ Në rastin konkret, Gjykata çmon se kjo vepër penale nuk është konsumuar nga e pandehura Etleda Çiftja. Kjo për këto arsye: **Së pari,** e pandehura nuk rezulton që të ketë regjistruar në hipotek sende të paluajtshme që nuk

⁴⁹Në nenin 2 të Kodit Penal nën titullin “**Mosdënimi pa ligj**” parashikohet shprehimisht se: “*Askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale.*”, ndërsa në nenin 3 të këtij Kodi nën titullin “**Veprimi në kohë i ligjit penal**” parashikohet shprehimisht se: “*Askush nuk mund të dënohet për një vepër që, sipas ligjit të kohës kur është kryer, nuk përbënte vepër penale.*”.

⁵⁰ Shiko vendimin Nr. 70, datë 13.04.2016 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

ekzistojnë si kolateral për përmbushjen e detyrimit ndaj bankës. **Së dyti**, toka arrë që është vendosur si garanci ndaj bankës nuk është paraqitur tej vlerës së tyre reale. Përkundrazi gjatë gjykimit u provua se, të pandehurës Elteda Çiftja dhe familjarëve të saj i është diktuar vendosja e vlerës së kontratës nga vetë Emporiki Bank që të përputhej me vlerësimin e bërë nga kjo e fundit në mënyrë të pavarur. Pra, kanë qenë kërkesa e bankës që kanë detyruar të pandehurën e famijarët e saj të kryejë një veprim juridik simulues, kontratën e shitjes, ndërkohë që qëllimi i palëve ka qenë për kalimin e pronësisë nëpërmjet dhurimit. **Së treti**, gjatë gjykimit nga e pandehura Etleda Çiftj nuk është kryer asnjë veprim për të arritur në përfundimin se kredinë e marrë pranë Emporiki Bank e ka bërë me qëllim për të mos kthyer më. Përkundrazi, gjatë gjykimit u provua se e pandehura e ka paguar rregullisht kredinë dhe e ka mbyllur përpara afatit të parashikuar në kontratë. Sipas akteve rezulton se kredia është shlyer tërësisht në vitin 2020, pra një vit më parë se të bëhej kallëzimi penale ndaj saj më datë 28.06.2021 dhe gjashtë vite më parë nga afati i parashikuar në kontratë. Për këto arsye, Gjykata e konsideron të drejtë analizën juridike të bërë nga prokuroria në kërkesën për gjykim se nuk është konsumuar në rastin konkret kjo vepër penale.

38. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale. Në nenin 14 të Kodit Penal thuhet se: *“Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quket me faj personi që e ka kryer veprën me dashje ose me pakujdesi.”* Këto forma të zbatimit të parimit të fajësisë në të drejtën penale përbëjnë edhe qëndrimin psikologjik apo subjektiv që shfaq autori ndaj veprës penale dhe nuk mund të atribuohet veprimi kriminal në mënyrë objektive apo absolute pa pasur një lidhje psikologjike me anën objektive të veprës penale. Gjykata vlerëson se shoqëria dhe e drejta penale nuk kanë asnjë interes në ndëshkimin e atyre fakteve të pamenduara, që nuk mund të dihen apo të njiheshin apo të reflekseve mekanike, apo pasojave të pa përfytyruara nga ana e subjektit aktiv të veprës penale. Ligji penal parashikon vetëm ndëshkimin e atyre veprimeve a mosveprimeve që kryen me faj (në formën e dashjes apo pakujdesisë) të individit. Parimi i fajësisë në të drejtën penale mund të kuptohet në dy mënyra: i) si ndalim i atribuimit të përgjegjësisë penale për faktin e kryer nga të tjerë; si edhe ii) në kuptimin e pranisë së detyrueshme të formës së dashjes apo pakujdesisë, në elementet e veprës penale, pra të ndalimit të atribuimit të përgjegjësisë penale në mungesë të elementit subjektiv (për përmendjen e të dy mënyrave shih Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 3/2015, datë 02.11.2015, § 66, 71). Kësisoj subjekti aktiv i veprës penale duhet të jetë i vetëdijshëm; pra, të ketë dijeni se sjellja e tij ka përbërë një rrezik për shoqërinë dhe ai, të paktën me pakujdesi, apo me dashje nuk ka respektuar parashikimin ligjor që ndalon kryerjen e veprës penale, edhe pse ishte në gjendje, duke mos respektuar detyrimin për t’iu shmangur kryerjes së veprës penale. Detyrimi për të mos kryer veprën penale i është ngarkuar subjektit si anëtar i shoqërisë, me qëllim që të nxitet kontributi personal dhe i përgjegjshëm i tij për bashkekzistencën paqësore në shoqëri të tij. Në disa rrethana të caktuara subjekti aktiv, mund të mos jetë në dijeni të cenueshmërisë apo rrezikut të qenësishëm, që sjellja e tij mund të përbëjë për shoqërinë dhe rendin e saj juridik, për

shkaqe të moshës së tij, zhvillimit mendor, dhe arsyeve të tjera objektive të pashmangshme. Parimi i fajësisë në të drejtën penale parashikon një sërë kushtesh që lejojnë atribuimin e fajit për kryerjen e një veprë penale ndaj një subjekti të caktuar që duhet të jetë në gjendje dhe i aftë për të kuptuar. Pra, parimi i fajësisë është i lidhur, jo vetëm me parimin e ligjshmërisë dhe cenueshmërisë, por sidomos me parimin e parandalimit dhe të riedukimit të autorit të veprës penale, si dhe me parimin e përpjesëtueshmërisë. Pasi që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, ai duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën.

38.1. Gjykata vlerëson se parimi i fajësisë ka të bëjë me gjendjen e brendshme psikike të subjektit aktiv të veprës penale, dhe pasqyron qëndrimin dhe pozicionin e tij ndaj kryerjes së veprës penale në botën e jashtme. Elementi subjektiv i veprës penale përbëhet nga dy aspekte, në atë se çfarë duhet të jetë në mendjen e subjektiv aktiv të veprës penale, kur plotësohet ana objektive e veprës penale (aspekti pozitiv) dhe në aspektin negativ, që konsiston në atë se çfarë nuk duhet të jetë në mendjen e subjektiv aktiv të veprës penale. I tillë mund të jetë për shembull: prania e një lajthimi në fakt, i cili e shpie subjektin aktiv të veprës penale në gabim dhe në një përfytyrim të shtrembëruar të realitetit dhe si rezultat, atij nuk mund t'i atribuohet qortim penal edhe pse është plotësuar ana objektive e veprës penale. Rast tjetër mund të përbëjë për shembull edhe lajthimi i pashmangshëm i ligjit penal, kur mosnjohja është objektivisht e paevitueshme sipas nenit 5 të Kodit Penal. Aspekti pozitiv i anës subjektive të veprës penale përbëhet nga dy elementë: vetëdija dhe dashja, pra elementi i dijenisë (intelektual) dhe elementi volitiv. Vetëdija është ndërgjegjësimi i brendshëm që individi krijon mbi faktet, domethënë mbi realitetin faktik, duke analizuar të dhënat e realitetit nga e shkuara, apo nga e tashmja dhe parashikuar të ardhmen. Të ardhmen ai nuk mund ta dijë apo ta njohë më siguri absolute. Ndërsa elementi volitiv ka të bëjë me përcaktimin e vullnetit të subjektit dhe nuk është i lidhur me realitetin faktik, në kuptimin që subjekti mund të dojë si gjëra të shkuara, të tashme, por edhe të ardhme. Elementi volitiv është i përbërë nga shkallë të ndryshme dhe të ndërmjetme, midis të cilave ndahet dashja (*dolus*) dhe pakujdesia (*culpa*). Shkalla më e lartë e elementit volitiv është dashja e drejtëpërdrejtë, në të cilin subjekti ka vetëdije të plotë të realitetit faktik, domethënë të anës objektive të veprës penale, duke e reflektuar dhe e vënë atë në qendër të analizës psikologjike të subjektit. Shkalla më e ulët e elementit volitiv është pakujdesia, në të cilën subjekti, ndonëse nuk ka vetëdije të plotë të elementit faktik, për rrethanat e faktit dhe cilësitë e tjera të tij, ai duhet dhe mund të kishte qenë i ndërgjegjshëm, domethënë në gjendje për të parashikuar realitetin faktik dhe pasojat e sjelljes së tij. Në lidhje me sjellje kriminale që nuk mund të dihen, sa i takon parimit të fajësisë në të drejtën penale, edhe pse ky parim nuk është parashikuar shprehimisht nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ky fakt nuk e ka ndaluar Gjykatën Evropiane të shprehet në lidhje me këtë parim të rëndësishëm e themelor të së drejtës penale. Kështu, në rastin *Salabiaku k. Francës*⁵¹, në vendimin e datës 7 tetor 1988,

⁵¹ Ankimi nr. 10519/83, *Salabiaku k. Francës*.

Gjykata Europiane në një rast lidhur me mbajtjen e sendeve të paligjshme nga një individ që pretendonte mosdijeninë e tij rreth përmbajtjes së sendit (valixhe) nuk vërejti shkelje të nenit 6/2 të Konventës Europiane. (*Shiko Vendimin Njësues Nr. 125, datë 25.10.2017 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

38.2. Gjykata vlerëson se, vepra penale e falsifikimit të dokumenteve, parashikon si formë faji, vetëm atë të dashjes, në kuptimin që autori i veprës penale, e parashikon dhe e dëshiron faktin e falsifikimit, apo përdorimin e dokumentit të falsifikuar. Çka nënkupton se **dashja konsiston në dijeninë e subjektit jo vetëm për të falsifikuar, por edhe për të cenuar marrëdhënien juridike që dokumenti, objekt falsifikimi, ka për qëllim të kryejë.**⁵² Në këto kushte, një qëllim i padëmshëm apo i ndryshëm, qoftë edhe i supozuar në mënyrë të gabuar se qëllimi i të vepruarit **nuk ishte falsifikimi, nuk mund të përbëjë objekt inkriminimi nga norma penale për veprën e falsifikimit të dokumenteve të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.** Rrjedhimisht, falsifikimi përjashtohet kur subjekti vepron për qëllime të tjera nga ato për të përfituar padrejtësisht (*animus nocendi*) duke synuar të veprohet në të mirë të institucionit, si dhe nëse subjekti nuk cenon funksionin konkret që dokumenti kryen. Pra, nuk mjafton vetëm dashja e krijimit të një dokumenti fals (*intentio decipiendi*), kur autori beson se po vepron me një qëllim jo penal, i udhëhequr nga mbarëvajtja e punës, qoftë edhe në mënyrë të gabuar, por kërkohet edhe cenimi konkret i funksionit të aktit. Nëse subjekti nuk është i ndërgjegjshëm për cenimin dhe kompromentimin e interesit që dokumenti luan në rastin konkret, atëherë nuk mund të ketë një qëndrim psikik në dashjen e anës objektive të kësaj vepre penale.⁵³ Kështu, në plotësim të këtij elementi gjykata çmon se gjatë gjykimit u provua se nuk është konsumuar nga ana objektive kjo vepër penale. **Në këto kushte, përderisa nuk ekziston ana objektive, pra veprime të paligjshëm në kuptimin penal, atëherë nuk kemi as faj, pasi mungon si elementi intelektual ashtu dhe ai volutiv, që të ekzistojë faji si element thelbësor i përgjegjësisë penale.**

39. Në lidhje me subjektin e veprës penale, Gjykata vlerëson se, duke iu referuar paragrafit të parë dhe të dytë të nenit 186 të Kodit Penal, subjekti i veprës penale të “*Falsifikimi i dokumenteve*” është i përgjithshëm, që do të thotë mjafton që të plotësohen dy kushtet e përgjithshme, pra mosha dhe të jetë i përgjegjshëm. Ndërkohë që paragrafi i tretë i nenit 186 të Kodit Penal, ku thuhet shprehimisht se: “*Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin...*”, kërkon që subjekti të jetë i posaçëm. Sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë subjekti i kësaj figure vepre penale mund të jetë subjekti i posaçëm i cili është i ngarkuar me ligj me një detyrë publike apo shtetërore. **Përveç cilësive të veçanta** që duhet të ketë subjekti duhet që akti të jetë **lëshuar gjatë ushtrimit të detyrës në bazë të kompetencave** që i njeh ligji si dhe akti të prodhojë pasojën juridike të dëshiruar. Pra, sipas Gjykatës së Lartë subjekti i posaçëm janë vetëm **zyrtarët publik**. Funksioni publik sipas përkufizimit të doktrinës u njihet personave të cilët kontribuojnë në formimin e vullnetit të entit publik ose e përfaqësojnë në marrëdhëniet me të tretët; të gjithë ata që kanë pushtet autoritar; të gjithë ata që kanë

⁵² Shiko vendimin Nr. 57, datë 19.04.2017 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

⁵³ Shiko vendimin Nr. 24, datë 09.02.2017 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

pushtet vërtetues.⁵⁴ Në rastin konkret, e pandehura Etleda Çiftja i plotëson kushtet formale për të qenë subjekt i kësaj vepre penale, pavarësisht se në rastin konkret, nuk plotësohen tre kushtet e tjera të figurës së veprës penale, objekti, ana objektive dhe ana subjektive.

40. Sa më sipër u arsyetua, Gjykata bazuar në nenin 388 pika 1, gërma “b” të K.Pr.Penale çmon se e pandehura **Etleda Çiftja** duhet deklaruar e pafajshme për figurën e veprës penale “*Falsifikim i dokumenteve*” parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, pasi fakti nuk përbën vepër penale.

B. Lidhur me figurën e veprës penale të “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”.

41. Gjithashtu, prokuroria e akuzon të pandehurën **Etleda Çiftja** për veprën penale të “*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë*”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, ku parashikohet shprehimisht se: “*Refuzimi për deklarimin ose mosdeklarimi i pasurisë së personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë sipas ligjit, kur më parë janë marrë masa administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj. Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.*”.

42. Në lidhje me objektin e veprës penale “*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë*”. Gjykata thekson se **objekti** i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar saktësinë e burimeve të pasurisë së personave të zgjedhur ose nëpunësve publike, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet e kundraligjshme, të parashikuara në Ligjin Nr. 9049 date 10.04.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike*”, i ndryshuar, ku një nga qellimet kryesore të këtij ligji sanksionuar në nenin 1 është pikërisht “*përcaktimi i rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta*”, me objekt mbrojtjen e shtetit të së drejtës dhe funksionimin normal të shërbimit publik **për të parandaluar përfitimet e padrejta** dhe ushtrimin prej funksionarëve publikë të detyrave në përputhje me ligjin. Në këtë mënyrë, rritet transparencja e administratës në tërësi por edhe rritet besueshmëria e publikut, ndaj administratës publike, dhe ndaj politikave të ndjekura nga kjo e fundit, në funksion të përmbushjes së detyrës me efektivitet. Në të kundërt, mosbërja e këtyre deklarimeve dhe moslejimi i publikimit të tyre, do të shtonte në mënyrë të konsiderueshme rrezikun e fshehjes apo manipulimit të të dhënave mbi pasurinë e subjektit deklarues, duke zbehur kështu dukshëm zbatimin me efikasitet të këtij ligji në praktikë.

⁵⁴ Shiko Vendimin Nr. 288, datë 07.11.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

42.1. Gjithashtu, për të përcaktuar objektin e kësaj figure të veprës penale, Gjykata mban parasysh jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila në vendimin Nr. 16, datë 11.11.2004, ndër të tjera ka theksuar: “... Gjykata Kushtetuese konstaton se qëllimi kryesor për miratimin e ligjit nr. 9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” ka qenë marrja e masave sa më efektive për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, rritja e besimit në institucionet shtetërore, transparenca, parandalimi i rasteve të abuzimit me pushtetin shtetëror dhe pasurimit të paligjshëm të personave të zgjedhur ose të atyre që kryejnë funksione të caktuara shtetërore. Këto fenomene të dëmshme pengojnë zhvillimin e vendit, mirëqënien e përgjithshme dhe ndërtimin e një shteti të lirë e demokratik. Prandaj ligjvënësi ka synuar që në këtë betejë të rëndësishme për fatet e demokracisë në Shqipëri t’i sigurohet një pjesëmarrje aktive dhe publikut. Kjo pjesëmarrje garantohet përmes transparencës, njohjes dhe vlerësimit të publikut të gjerë edhe me të dhënat mbi deklaratimet e pasurisë së personave të zgjedhur apo zyrtarë. ... Në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve zyrtare, personi i zgjedhur apo nëpunësi publik nuk duhet të ndikohet nga interesat e ngushta personale. Në këtë kuptim, përmes veprimeve, mosveprimeve apo vendimmarrjes së tij, ai nuk mund të krijojë përfitime apo avantazhe për vete, për familjarët, të afërmit apo personat e tjerë fizike dhe juridike, me të cilët ndan interesa ekonomike ose politike. Deklarimi dhe regjistrimi i pasurisë së personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, verifikimi i tyre si dhe mundësia e bërjes publike të të dhënave që kanë këto deklarime ndikojnë pozitivisht në identifikimin ose shmangien e rasteve të konfliktit të interesave, pra edhe të rasteve korruptive.... Transparenca dhe besimi i publikut në këtë kategori njerëzish luajnë rol të rëndësishëm në shtetin e lirë e demokratik. Pikërisht për këtë arsye, në jurisprudencën e vendeve të ndryshme demokratike është deklaruar se “publikimi i detajeve mbi të ardhurat ose pasurinë personale nuk përbën ndërhyrje në jetën private, veçanërisht nëse personi ushtron funksione publike ose kuazi – publike”. Pra, qëllimi i Ligjvënësit në sanksionimin e kësaj vepre penale është për të luftuar korrupsionin dhe për të kontrolluar pasuritë e vëna në mënyrë abuzive nga funksionarët e zgjedhur dhe nëpunësit publike, të cilët mund të vënë pasuri të cilat rrjedhin nga përfitime të paligjshme duke abuzuar me funksionin e tyre, si dhe për të parandaluar që persona që kanë vënë pasuri në mënyrë të jashtëligjshme, të mund të fillojnë punë në administratën e lartë shtetërore.

43. Në lidhje me anën objektive (actus rea) të figurës së veprës penale të “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”. Gjykata thekson se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idetë e tij. Pra, ana objektive paraqet sulmin kriminal të shqyrtuar nga ana e tij e jashtme, nga pikëpamja e zhvillimit gradual dhe konsekuent të ngjarjeve dhe fenomeneve, të cilat fillojnë të vihen në lëvizje me kryerjen nga subjekti i veprimit ose mosveprimit dhe përfundojnë me ardhjen e një rezultati të caktuar kriminal. Nga teoria e së drejtës penale dhe praktika gjyqësore rezulton se, element të anës objektive të figurës së veprës penale

janë: i) veprimi ose mosveprimi i kundërligjshëm; ii) mënyra e kryerjes së veprës penale, me të cilën kuptohet renditja e veprave, metodat e përdorura, karakteri kronologjik dhe specifika e lëvizjeve që bën personi për kryerjen e veprës penale. Mënyra e kryerjes së veprës penale lidhet ngushtësisht me mjetet e përdorura nga personi për realizimin e saj; dhe iii) Koha, vendi dhe ambjenti i kryerjes së veprës penale, me të cilën kuptohet grumbullimi dhe unitetit i kushteve konkrete, në të cilat kryhet veprimi ose mosveprimi kriminal, në të cilat zhvillohet lidhja shkakësore dhe vjenë rezultati (pasoja) kriminale. Këto kushte ekzistojnë objektivisht dhe pavarësisht nga vullneti i subjektit i veprës penale.

43.1. Në kuptim të nenit 257/a/1 të Kodit Penal, vepra penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë” nga ana objektive kryhet në disa forma, konkretisht sipas paragrafit të parë kjo veprë kryhet nëpërmjet i) refuzimit për deklarimin ose ii) nëpërmjet mosdeklarimit të pasurisë së personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë sipas ligjit. Kusht *sine qua non* për ekzistencën e përgjegjësisë penale sipas nenit 257/a/1 është ekzistenca e një mase të mëparshme administrative ndaj subjektit që ka kryer shkeljen. Në mënyrë që të ekzistojë përgjegjësia penale sipas kësaj dispozite kërkohet plotësimi i disa kushteve kumulative: **Së pari**, duhet që subjekti të ketë konsumuar veprën penale nga ana objektive, konsumim që në bazë të dispozitës kryhet me mosveprim; pra të mos jetë kryer deklarimi i pasurisë ose interesave privatë; **Së dyti**, subjekti është penalisht përgjegjës kur ka qenë i detyruar në bazë të ligjit të kryejë deklarimin e pasurisë ose interesave privatë dhe nuk e ka përmbushur një detyrim të tillë; **Së treti**, ndaj subjektit duhet të jetë marrë më parë një masë administrative nga organi kompetent si dhe kërkohet që masa administrative të jetë marrë për të njëjtën shkelje. Që të ketë përgjegjësi penale sipas dispozitës së mësipërme është e nevojshme që më parë ndaj subjektit të jetë marrë masë administrative dhe subjekti pavarësisht se ka dijeni për masën, vazhdon të mospërmbushë detyrimet e tij të cilat pasjellin përgjegjësi penale për të.⁵⁵

43.2. Gjykata çmon se neni 257/a i Kodit Penal është një dispozitë blankete, prandaj për të përcaktuar kuptimin dhe qëllimin e kësaj dispozite penale duhet t’i referohemi Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar. Kështu, në nenin 4 të këtij ligji nën titullin “**Afati dhe objekti i deklarimit**” parashikohet shprehimisht: “*Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë:..*”, ndërsa në nenin 5/1 të këtij ligji nën titullin “**Deklarimi para fillimit të punës**” parashikohet se: “1. Të gjitha subjektet, që mbartin detyrimin për deklarim, sipas këtij ligji, duhet të deklarojnë para fillimit të punës: a) të gjitha pasuritë e

⁵⁵Shiko vendimin Nr. 631, datë 30.09.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

grumbulluara, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji, përfshirë **burimet e krijimit të tyre**; b) angazhimet në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, që ekzistojnë në datën e fillimit të punës, përfshirë çdo lloj të ardhure të krijuar nga këto angazhime ose veprimtari, nga data 1 janar deri në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit. **2. Deklarimi para fillimit të punës dorëzohet jo më vonë se 30 ditë nga data e fillimit të detyrës.**”

43.3. Gjithashtu, në nenin 7 të Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, nën titullin “**Deklarimi periodik vjetor**” parashikohet se: “1. Në deklarimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë, të deklaruar më parë, sipas nenit 6 të këtij ligji, ata të lindur gjatë vitit që deklarohet dhe çdo e ardhur e fituar dhe shpenzim i deklarueshëm, i kryer gjatë gjithë vitit për të cilin bëhet deklarimi. **2. Deklarimi para fillimit të punës, sipas nenit 6, dhe ai pas largimit nga funksioni, sipas nenit 8 të këtij ligji, janë raste të veçanta të deklarimit periodik.** 3. Të gjithë zyrtarët dhe personat e tjerë të lidhur, që mbartin detyrim për deklarim, detyrohen të paraqesin deklaratën e tyre, të mbyllur në zarf, deri më 31 mars të çdo viti, pranë autoritetit ose strukturës përgjegjëse të institucionit publik, të parashikuar në shkronjën “b” të pikës 2 të nenit 41 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”,⁵⁶ të ndryshuar. ...5. Për qëllim të deklarimit periodik vjetor, sipas pikave të mësipërme të këtij neni, ndër personat e lidhur me zyrtarin, mbartin detyrim për deklarim vetëm bashkëshortilja dhe fëmijët madhorë.”, ndërsa në nenin 7/1 të këtij ligji nën titullin “**Deklarimi pas largimit nga funksioni**” parashikohet se: “1. Deklarimi pas largimit nga funksioni kryhet vetëm një herë për periudhën nga deklarimi i fundit deri në datën e largimit, me përjashtim të rastit kur zyrtari fillon punë në një detyrë tjetër, që, sipas këtij ligji, vazhdon të mbartë detyrimin për deklarim. 2. Në deklarimin pas largimit nga funksioni jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë, për periudhën nga deklarimi i fundit deri në datën e largimit nga funksioni. **3. Deklarimi kryhet jo më vonë se 15 ditë nga data e largimit nga funksioni.**”

43.4. Më tej në Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, parashikohen sanksionet që vijnë nga mosdeklarimi në afat dhe refuzimi për deklarimin e pasurisë. Kështu në nenin 5 të këtij ligji nën titullin “**Refuzimi për**

⁵⁶Në nenin 41 të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, nën titullin “**Autoritetet përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave**” parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe që përmendet në këtë ligj me shkurtimin “Inspektorati i Lartë”. Inspektorati i Lartë, vihet në lëvizje me kërkesë të institucioneve publike, palëve të interesuara dhe kryesisht me nismën e tij. 2. Autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji në institucionet publike janë: a) eprorët e zyrtarëve, sipas hierarkisë, brenda një institucioni publik; b) drejtoritë, njësitë e burimeve njerëzore apo njësi të ngarkuara a të ngritura posaçërisht, sipas nevojës dhe mundësive të çdo institucioni publik; c) institucionet eprore.”

deklarim” parashikohet shprehimisht: **“1. Refuzimi për deklarim sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me Kodin Penal. Inspektori i Përgjithshëm, brenda 30 ditëve, i dërgon organit përgjegjës njoftimin e motivuar për largimin nga puna të personit që refuzon të deklarojë. Organi përgjegjës, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar të marrë masa për largimin nga puna të punonjësit që ka refuzuar deklarimin. 2. Kur deklarimi refuzohet nga personat e zgjedhur ose nga ata me imunitet, Inspektori i Përgjithshëm vë në dijeni Kuvendin dhe, kur është rasti, edhe organin epror të personit. Në të gjitha rastet e refuzimit të deklarimit, me kalimin e 30 ditëve nga njoftimi i organit përgjegjës, Inspektori i Përgjithshëm detyrohet t’i bëjë publike rastet e refuzimit të deklarimit.”**, ndërsa në nenin 40 të këtij ligji nën titullin **“Kundërvajtjet administrative”** parashikohet shprehimisht: **“1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, kur nuk përbën veprë penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas kufijve të përcaktuar më poshtë: a) Për mosdeklarim periodik apo me kërkesë, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, zyrtari ose personi i lidhur me të, që mbart detyrimin për deklarim, dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë; ...”**.

43.5. Nga përmbajtja e dispozitave të mësipërme rezulton se figura e veprës penale **“Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”** sipas paragrafit të parë të nenit 257/a të Kodit Penal, konsiderohet e kryer nga ana objektive nëse subjektet e deklarimit të parashikuar nga neni 3 i Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 **“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”**, i ndryshuar apo personat e lidhur me ta bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhor të tyre: **i)** refuzojnë në mënyrë të hapur duke deklaruar se nuk dëshirojnë të paraqesin deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës, deklaratën periodike të pasurisë dhe deklaratën pas largimit nga detyra edhe pas paralajmërimit të detyrimit për deklarim nga ana e ILDKPKI; **ose ii)** nuk plotësojnë deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës brenda 30 ditëve nga fillimi i punës, deklaratën periodike të pasurisë brenda datë 31 mars të çdo viti apo dorëzimit e deklaratës pas largimit nga detyra brenda jo më vonë se 15 ditë nga data e largimit nga funksioni pranë autoritetit ose strukturës përgjegjëse të institucionit publik dhe pa shkaqe të arsyeshme; **dhe iii)** në çdo rast duhet që nga ILDKPKI të jetë marrë masa administrative e gjobës ndaj subjektit të deklarimit dhe/ose personave të lidhur të tyre, gjobë e cila duhet t’i jetë komunikuar këtyre të fundit së bashku me paralajmërimin për plotësimin e deklaratës së pasurisë.

43.6. Ndërkohë sipas paragrafit të dytë të nenit 257/a i Kodit Penal vepra konsiderohet e konsumuar kur subjekti i deklarimit apo personi i lidhur me të bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhor kryejnë **fshehje të pasurisë** apo bëjnë **deklarim të rremë të pasurisë**. Do të kishim të bënim me kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 257/a paragrafi i dytë i Kodit Penal, **nëpërmjet fshehjes së pasurisë**, në rastin kur personi, ka kryer veprime të caktuara, si këmbim të pasurisë, transferim të saj, fshehje apo mbulim të natyrës së vërtetë të burimit, vendosjes, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave të tjera pasurore, fitim të pronësisë, posedim apo përdorim, që do të çonin në moslidhjen

dot të pasurisë me pronarin e vërtetë të saj, duke e vendosur atë në emër të një personi tjetër, të ndryshëm nga rrethi i personave për të cilët i pandehuri është i detyruar që të deklarojë pasurinë. Subjekti në këtë rast ndërmerr veprime të caktuara, shoqërisht të rrezikshme, për t'i humbur gjurmët e pasurisë, apo duke e gëzuar atë, me ndërmjetësinë e personave të tretë. Të gjitha këto veprime të ndërmarra nga ana e një të pandehuri bëhen me një qëllim të mirëpërcaktuar, për t'u mos u evidentuar dhe deklaruar në ILDKPKI, sepse këto pasuri rrjedhin nga përfitime të paligjshme duke abuzuar me funksionin e tyre, pasi në të kundërt nuk do të kishte sens logjik dhe juridik për t'u fshehur pasuritë që vijnë nga burime të ligjshme e të justifikuara. Në këtë përfundim arrijmë duke bërë interpretimin historikë, logjik dhe sistematik të legjislacionit që ka rregulluar deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe funksionarëve publik ndër vite. Kështu, në nenin 8 të Ligjit Nr. 7903, datë 08.03.1995 “Për deklarimin e pasurive të zgjedhura dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik”, thuhet shprehimisht se: “Shkeljet e parashikuara në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji nga persona të tjerë me përjashtim të atyre të përmendur në nenin 7, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen: - Për mosparaqitjen në kohën e duhur pa shkaqe të arsyeshme të deklaratës me gjobë në masën 1000 deri në 50000 lekë nga inspektorët e tatimeve të rrethit. - **Për daklarata të rreme me dashje** me gjobë në masën 500 000 deri në 1 000 000 lekë për çdo rast nga kryetari i degës së policisë financiare, si dhe me heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit deri në 5 vjet. Kundër vendimeve të dënimit mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit deri brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes së vendimit. Kur shkelja përbën vepër penale, bëhet kallëzim në organet e prokurorisë.”, ndërsa në nenin 9 të këtij ligji parashikohet se: “Organet e ngarkuara me gjykimin e kundërvajtjeve administrative sipas këtij ligji, krahas dënimit me gjobë vendosin **edhe për pasurinë e fituar nga burime të paligjshme prej personave të përcaktuar në nenet 1 dhe 4 të këtij ligji. Kjo pasuri konfiskohet nga policia financiare dhe kalon në dobi të shtetit.**”. Pra, nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se masa administrative merret për deklarata të rreme me dashje dhe vetëm për pasuritë e deklaruara të cilat janë fituara nga burime të paligjshme, sepse nuk ekziston logjika juridike që bëhet deklaratë e rreme me dashje për pasuritë e deklaruara apo edhe të padeklaruara e që janë fituar në mënyrë të ligjshme nga burime të ligjshme e të justifikuara. Në këtë konkluzion arrihet duke bërë interpretimin gramatikor të nenit 9 të këtij ligji, konkretisht lidhësa “edhe” për pasurinë e fituar nga burime të paligjshme, nënkupton që dënimi me gjobë shoqërohej gjithmonë me konfiskimin e pasurisë të fituar nga burime të paligjshme, për rrjedhojë nuk mund të kemi deklarim të rremë pa pasur pasuri të paligjshme. Të njëjtin qëllim ndjek dhe Ligji Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar. Kështu, në nenin 1 të këtij Ligji nën titullin “Qëllimi” parashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, **të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta.**”. Pra, qëllimi i këtij ligji ndër të tjera është të garantojë ekzistencën e burimeve të ligjshme, në të kundërt në kuptim të nenin 27 të këtij ligji të

pandryshuar, Inspektori i Përgjithshëm njoftonte prokurorinë, duke bërë kallëzim penal. Kjo përforcohet edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, e cila në vendimin Nr. 16, datë 11.11.2004, ndër të tjera thekson: “... Gjykata Kushtetuese konstaton se qëllimi kryesor për miratimin e ligjit nr. 9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” **ka qenë marrja e masave sa më efektive për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, rritja e besimit në institucionet shtetërore, transparenca, parandalimi i rasteve të abuzimit me pushtetin shtetëror dhe pasurimit të paligjshëm të personave të zgjedhur ose të atyre që kryejnë funksione të caktuara shtetërore.**”⁵⁷

43.7. Gjithashtu, nga ana objektive kjo veprë penale konsumohet nëpërmjet veprimeve që përbëjnë **deklarim të rremë të pasurisë** që përmendet në deklaratën e pasurisë. Sikurse theksuam më lartë në neni 257/a i Kodit Penal “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë” është një dispozitë blankete. Prandaj për të përcaktuar kuptimin e kësaj figure të veprës penale, duhet t’i referohemi Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar. Kështu, në nenin 38 të këtij ligji nën titullin “**Deklarimi i rremë**” parashikohet shprehimisht se: “**Deklaratat dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë ato janë dokumente zyrtare. Paraqitja në to e të dhënave të rreme përbën veprë penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.**” Nga përmbajtja e kësaj dispozitë që të kemi deklarim të rremë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte: së pari, subjekti i deklarimit dhe bashkëshorti/ja e fëmijët madhor të kenë plotësuar deklaratën e pasurisë dhe së dyti, në deklaratën e pasurisë dhe dokumentet justifikues të jenë paraqitur të dhëna të rreme që nuk i përgjigjen realitetit. Gjykata çmon se nga interpretimi *a contrario* i kësaj dispozite arrihet në konkluzionin se nuk do të kemi deklarim të rremë të pasurisë, nëse subjekti i deklarimit për shkak të neglizhencës, harresës apo për shkak të paqartësisë se plotësimit të deklaratës së pasurisë, që vjen nga mungesa e trajnimit nga organet kompetente, nuk pasqyron në deklaratën e pasurisë një ose disa nga interesat privat, burimet e krijimit apo detyrimet financiare të parashikuar nga neni 4 i Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar. Kjo për faktin pasi nuk mund të flitet për deklarim të rremë kur “nuk ka deklarim” për një pasuri, por kemi deklarim të rremë kur paraqiten të dhëna të rreme me pasurinë e deklaruar, me qëllim për të mbuluar një të ardhur të paligjshme nga burime të paligjshme e të pajustificuara. Gjykata çmon se në këtë përfundim arrihet duke bërë interpretimin logjik të paragrafit të parë dhe të dytë të nenin 257/a të Kodit Penal. Kështu, sipas paragrafit të parë të këtij

⁵⁷ Në vendimin Nr. 5, datë 2 Shkurt 2001 të Gjykatës Kushtetuese ndër të tjera thuhet se: “Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjithë organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, **fuginë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj.** Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale.”

neni refuzimi për bërë deklarin e të gjithë pasurisë apo mosdeklarimin e të gjithë pasurisë në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme (ku mund të përfshihen edhe pasuri të paligjshme që vijnë si rrjedhojë e akteve korruptive apo abuzimit me detyrën), përbën kundërvajtje penale, ndërsa paragrafi i dytë i këtij neni ku përfshihet dhe deklarimi i rremë i pasurisë përbën krim. Ndodhur në këto kushte, Gjykata çmon se nëse në deklarin e rremë të pasurisë do të përfshihej dhe mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë të një ose disa nga interesat privat, burimet e krijimit apo detyrimet financiare, kjo do të binte në kundërshtim me qëllimin e ligjvënësist, pasi do të sillte që një person që refuzon dhe nuk e paraqet fare deklaratën e pasurisë, ku mund të përfshihen edhe pasuri të paligjshme që vijnë si rrjedhojë e akteve korruptive apo abuzimit me detyrën, të dënohet më pak se një person që deklaron në mënyrë të saktë një pjesë të pasurisë dhe nuk deklaron një pjesë tjetër, e cila vjen nga burime të ligjshme e që mund të justifikohet me dokumente ligjor nga subjektet e deklarin. **Nëse do të rezultonte se pasuria e padeklaruar në deklaratë dhe e konstatuar pas hetimit nga organet kompetente sikurse është ILDKPKI nuk justifikohet me burime të ligjshme atëherë do të ishim përpara fshehjes së pasurisë dhe jo përpara deklarin të rremë.**

43.8. Gjykata çmon se do të ishin përpara deklarin të rremë të pasurisë që është pasqyruar në deklaratë nga subjekti i deklarin, kur funksionari fillon punë dhe bëhet subjekt i deklarin të pasurisë, ai deklaron më tepër pasuri se sa ka, në mënyrë që me vonë të mund të justifikojë shtimin e pasurisë nga ndonjë veprim i mundshëm korruptiv dhe jo të lërë pa dekluar pasuri që janë përfituar në mënyrë të ligjshme. Gjithashtu, do të ishim përpara deklarin të rremë të pasurisë, të pasqyruar në deklaratën e pasurisë nëse subjekti i deklarin pasqyron si fakt fitimin e një pasurie nëpërmjet dhurimit, ndërkohë që provohet që ky akt është fiktiv, pasi realisht subjekti e ka blerë nga burime të paligjshme, si dhe rastet kur subjekti i deklarin deklaron blerjen e një pasurie në një vlerë më të vogël se vlera reale e blerë apo shitjen e një pasurie me një vlerë më të lartë se vlera reale e shitur. Të gjitha deklarinet e rreme duhet të bëhen nga subjekti i deklarin me qëllim futjen e pasurive të vëna në mënyrë të paligjshme në sistemin e rregullt fiskal dhe pasqyrimi në formularët e deklarin të interesave privat duke përdorur forma të ndryshme justifikimi. Pra, Gjykata thekson se deklarata e rreme e pasurisë bëhet me dashje dhe vetëm për pasuritë e deklaruara të cilat janë fituara nga burime të paligjshme, sepse nuk ekziston logjika juridike që bëhet deklaratë e rreme me dashje për pasuritë e deklaruara e që janë fituar në mënyrë të ligjshme nga burime të ligjshme e të justifikuara. Në këtë rast do të ishin përpara një deklarate pasurie të paplotë dhe të parregullt që korrigohej në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji.

43.9. Gjithashtu, Gjykata çmon të theksoj se duhet bërë dallimi midis deklarin të rremë të pasurisë që është pasqyruar në deklaratën e pasurisë nga subjekti i deklarin, nga gabimet materiale, pasaktësitë, plotësimet e gabuara dhe parregullsitë që evidentohen në deklaratë, për shkak të neglizhencës, harresës apo për shkak të paqartësisë se plotësimet të deklaratës së pasurisë, që vjen nga mungesa e trajnimit nga organet kompetente. Kështu, në nenin 24 të Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve

publikë”, i ndryshuar, nën titullin “Përpunimi paraprak” parashikohet shprehimisht se: “Inspektorati i Lartë bën përpunimin paraprak të deklaratave, i cili përfshin juridiksionin, rregullsinë e plotësisht të deklaratës dhe të anekseve të saj. Kur nga përpunimi paraprak vërtetohen gabime materiale ose plotësimet të gabuara, Inspektorati njofton subjektin që ka paraqitur këto deklaratime, i cili, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, është i detyruar t’i ndreqë ato. Deklaratat e interesave private pas dorëzimit dhe regjistrimit kalojnë menjëherë në skanimin fizik dhe ruhen në sistemin e programuar elektronik të ILDKPKI-së. Vetëm pas përfundimit të procedurave të skanimit deklaratat e interesave private kalojnë në përpunimin paraprak, kontrollin aritmetik e logjik dhe me pas në kontroll të plotë. Procedurat e pranimit, skanimit dhe përpunimit paraprak miratohen nga Inspektori i Përgjithshëm.”, ndërsa në nenin 25 të këtij ligji nën titullin “Llojet e kontrollit”, parashikohet se: “1. Kontrolli i deklaratave përfshin kontrollin, aritmetik e logjik, dhe verifikimin e miratimit të deklaratës (kontrolli i plote). Kontrollin, aritmetik dhe logjik, kryhen për çdo deklaratim për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara. Verifikimi i miratimit të deklaratës (kontrolli i plote) bëhet për ato deklaratime, të cilat, nga kontrollin e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, paraqesin probleme, papajtueshmëri dhe parregullsi në justifikimin e burimeve të mbulimit të pasurisë ose në pasurinë e deklaruar dhe në deklaratime të tjera, sipas skemës së kontrollit. Në kuptim të këtij ligji, janë parregullsi në justifikimin e burimeve rastet kur burimet dhe pasuritë e krijuara nuk përputhen për shumën mbi 1 000 000 lekë për deklaratimet vjetore dhe për shumën mbi 2 000 000 leke për deklaratimet e bëra sipas neneve 6 dhe 9 të këtij ligji. Skema e kontrollit të deklaratave duhet të përfshijë kontrollin e plote të deklaratave, jo me pak se një herë në dy vjet. 2. Verifikimi dhe kontrolli i pasurisë, i detyrimeve financiare kryhet i plote, për çdo vit, për Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, Zëvendëskryeministrin, ministrat dhe drejtuesit, funksionet e të cilëve barazohen me ta. 3. Metodikat dhe manualët e ushtrimit të kontrollit miratohen nga Inspektori i Përgjithshëm.”. Pika 1, paragrafi i tretë, i katërt e i pestë, dhe pika 2 e këtij neni është shfuqizuar me nenin 50 të Ligjit 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Gjithashtu, në nenin 27 të këtij ligji nën titullin “Thirrja e subjektit për të dhënë shpjegime” parashikohet se: “Kur gjatë kontrollit zbulohet se deklaratimet nuk janë të sakta ose burimet e deklaruar nuk identifikohen dhe nuk mbulojnë pasuritë e deklaruar, Inspektorati i Lartë thërret subjektin për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse, të cilat paraqiten kurdoherë me shkrim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.”, ndërsa në nenin 28 të këtij ligji nën titullin “Pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme” parashikohet shprehimisht se: “Kur edhe nga procedurat e përcaktuara në nenin 27 nuk mund të justifikohen me burime të ligjshme pasuritë e krijuara dhe kur këto mospërputhje janë mbi 2 000 000 lekë për deklaratimet vjetore dhe mbi 3 000 000 lekë për deklaratimet sipas neneve 6 dhe 9 të këtij ligji, atëherë vlerësohet se pasuritë janë krijuar në mënyrë të paligjshme dhe Inspektori i Përgjithshëm njofton menjëherë prokurorinë.”. Kjo

dispozitë është shfuqizuar nga neni 17 i Ligjit 9475, datë 09.02.2006 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Gjykata çmoj të evidentojë këto dispozita ligjore në kuadrin e interpretimit historik të këtyre normave për të përcaktuar më drejt qëllimin e ligjvënësit në parashikimin e figurës së veprës penale **“Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”** parashikuar nga neni 257/a të Kodit Penal, e cila është parashikuar me Ligjin Nr. 9030, datë 13.3.2003 “Për një shtesë në Ligjin Nr. 8204, datë 10.04.1997 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me Ligjin Nr. 8279, datë 15.01.1998 dhe me Ligjin Nr. 8733, datë 24.01.2001”, duke pasur parasysh faktin që këto dispozita kanë plotësuar njëra-tjetrën, përderisa kanë ekzistuar në të njëjtën kohë. **Prandaj, Gjykata arrinë në konkluzionin se nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se nuk konsiderohet deklarimi i rremë i pasurive kur kemi të bëjmë me gabime materiale, parregullsi ku futen dhe mosplotësimi i të gjitha rubrikave të deklaratës, duke lënë pasuri të ligjshme të padeklaruara apo plotësime të gabuara të deklaratës së pasurisë, për të cilat subjekti i deklaramit thirret nga ILDKPKI-ja për t’i ndrequr ato. Gjithashtu, neni 28 i këtij ligji ka përcaktuar qartësisht se ILDKPKI-ja bën kallëzim penal në prokurori vetëm atëherë kur konstatohet se pasuritë që subjekti i deklaramit ka deklaruar apo që nuk ka deklaruar dhe që janë konstatuar gjatë hetimit administrativ janë krijuar në mënyrë të paligjshme, ku përshihen rastet e korrupsionit apo abuzimit me detyrën shtetërore. Ky qëllim i Ligjvënësit ka ekzistuar që me miratimit e Ligjit Nr. 7903, datë 08.03.1995 “Për deklarin e pasurive të zgjedhura dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik”, ku në nenin 9 të këtij ligji parashikohej se: “Organet e ngarkuara me gjykimin e kundërvajtjeve administrative sipas këtij ligji, krahas dënimit me gjobë vendosin edhe për pasurinë e fituar nga burime të paligjshme prej personave të përcaktuar në nenet 1 dhe 4 të këtij ligji. Kjo pasuri konfiskohet nga policia financiare dhe kalon në dobi të shtetit.”. Pra, nëse nuk provohet se pasuritë janë krijuar në mënyrë të paligjshme, ILDKPKI nuk mund të bëjë kallëzim penal, përse kohë ligji e ka përcaktuar qartësisht se kush është pasuri e paligjshme dhe kush konsiderohet parregullsi apo pasaktësi në plotësimin e deklaratës. Ndërkohë nëse provohet se pasuritë janë fituar nga burime të ligjshme, por subjekti deklarues nuk ka paguar detyrimet fiskale, atëherë veprohet sipas nenit 32 të Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, nën titullin **“Pasuritë e fituara nga fshehja e detyrimeve fiskale”**, ku parashikohet shprehimisht se: “Kur pasuritë e fituara gjykohen se janë rrjedhojë e fshehjes së detyrimeve fiskale, Inspektori i Përgjithshëm njofton organet tatimore të cilët detyrohen të njoftojnë rast pas rasti Inspektoratin e Lartë për masat e marra.”.**

43.10. Më tej në Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar se kush përbën kundërvajtje administrative në kuptim të këtij ligji. Kështu, në nenin 40 të këtij ligji të pandryshuar parashikohej se: **“Në kuptim të këtij ligji, kur**

veprimi ose mosveprimi nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe kundërvajtësit dënohen si me poshtë: a) kur deklaratat dhe dokumentet shoqëruese nuk paraqiten në afatin e caktuar, pa shkaqe të arsyeshme, subjekti që mbart detyrimin për deklarim gjobitet me 25 000 lekë. Në qoftë se edhe pas 15 ditëve të komunikimit të gjobës subjektet e përcaktuara në nenet 3 dhe 7 vazhdojnë të mos deklarojnë, gjoba dyfishohet. Në këtë rast njoftohen menjëherë organet përkatëse; b) për mosngritjen e inspektoratit të ulët, sipas nenit 18 të këtij ligji, titullari i subjektit gjobitet me 50 000 leke; c) kur kryetari i inspektoratit të ulët nuk dërgon në afat në Inspektoratin e Lartë të dhënat për deklarimin, ai gjobitet me 20 000 lekë; ç) kur nuk jepen të dhënat e kërkuara sipas nenit 26 të këtij ligji, subjektet gjobiten me 50 000 lekë; d) kur ekspertët refuzojnë kryerjen e ekspertimit ose kur ata nuk paraqiten, pa shkaqe të arsyeshme, për kryerjen e ekspertimit, sipas nenit 29 të këtij ligji, gjobiten me 100 000 lekë; dh) kur, pa shkaqe të arsyeshme, organet e ngarkuara për këtë qellim nuk ekzekutojnë gjobat, sipas nenit 41 të këtij ligji, ato gjobiten me 50 000 lekë. Të drejtën e këtyre gjobave e ka Inspektori i Përgjithshëm, me propozimin e personelit të Inspektoratit të Lartë. Ndërsa kryetari i inspektoratit të ulët ka të drejtën e gjobave vetëm për shkronjat "a", "d" e "dh" të këtij neni, kryesisht ose me propozimin e anëtarëve të inspektoratit të ulët. Kundër vendimit të gjobës së vënë nga Inspektori i Përgjithshëm mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së njoftimit, ndërsa për vendimet e gjobës së vënë nga inspektorati i ulët mund të bëhet ankim tek Inspektori i Përgjithshëm brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit dhe më pas, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatë.”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se ILDKPKI-ja kishte të drejtë të vendoste masën administrative gjobë ndaj subjektit të deklarimit vetëm nëse nuk paraqeste deklaratën dhe dokumentat shoqërues brenda afatit ligjor dhe jo për ndonjë parregullsi apo pasaktësi në plotësimin e saj, për të cilën ligji parashikonte se subjekti thirret për t’i korrigjuar gabimet ose pasaktësitë. Pra, deri më datë 26.10.2012 përbënte kundërvajtje administrative për subjektin e deklarimit vetëm mos dorëzimi i deklaratës brenda afatit ligjor.

43.10.1. Megjithatë me Ligjin Nr. Nr. 85/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve finaciare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, i botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 132, datë 11 Tetor 2012, i cili ka hyrë në fuqi **më datë 26.10.2012** neni 40 i këtij ligji ka ndryshuar, duke pasur aktualisht këtë përmbajtje: “1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas kufijve të përcaktuar më poshtë: a) Për mosdeklarim periodik apo me kërkesë, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, zyrtari ose personi i lidhur me të, që mbart detyrimin për deklarim, dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë; b) Për moslëshim autorizimi, sipas nenit 10 të këtij ligji, zyrtari dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë; c) Kur nuk jepen të dhënat e kërkuara nga Inspektorati i Lartë, sipas nenit 26 të këtij ligji, personat përgjegjës të institucioneve publike dhe private dënohen me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind

mijë) lekë. ç) Kur ekspertët refuzojnë kryerjen e ekspertimit ose kur ata nuk paraqiten, pa shkaqe të arsyeshme, për kryerjen e ekspertimit, sipas nenit 29 të këtij ligji, dënohen me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë; d) **Për shkelje të tjera të këtij ligji, të përcaktuara me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm e të konstatuara gjatë veprimtarisë kontrolluese të Inspektoratit të Lartë, Inspektori i Përgjithshëm dënon personat përgjegjës me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.** 2. Të drejtën për vendosjen e masave administrative për rastet e shkeljeve të mësipërme e ka Inspektori i Përgjithshëm. 3. Procedurat për zbatimin e masave administrative dhe ankimin ndaj tyre rregullohen sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe dispozitave të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. 4. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative të konstatuara gjatë kryerjes së inspektimeve të Inspektoratit të Lartë bëhet jo më vonë se 6 muaj pas konstatimit të shkeljes.”. Duke bërë interpretimin logjik dhe sistematik të pikës 1 gërma “d” të kësaj dispozite arrihet në përfundimin se është Inspektori i Përgjithshëm që përcakton se kush nga shkeljet e tjera të dispozitave të parashikuara në këtë ligj, do të përbëjë kundërvajtje administrative. Pra, në vetvete rastet e tjera të shkeljes së këtij ligji e që do të përbëjnë kundërvajtje administrative, do të përcaktohen me aktin nënligjor, të cilin ky ligj e përcakton “udhër” i të Inspektorit të Përgjithshëm. Gjykata konstaton se kjo dispozitë ndonëse i referohet Ligjit Nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” është në kundërshtim me nenin 4 të këtij ligji nën titullin “**Kundërvajtja administrative**” ku parashikohet se: “Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ligji parashikon dënim administrativ.”, dhe me nenin 6 të këtij ligji nën titullin “**Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative**” ku thuhet se: “Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative parashikohen: a) me ligj; b) me akte të këshillit bashkiak apo të këshillit të komunës, për shkelje që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të veçanta, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre në njësitë territoriale përkatëse, ku, sipas ligjit, ushtrojnë funksionet e veta.”. Pra, kur ligji ja delegon përcaktimin e kundërvajtjeve administrative aktit nënligjor nënkupton vetëm aktet e këshillit bashkiak. Gjithashtu, Gjykata konstaton se urdhri i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, si drejtues i një institucioni qendror, në zbatim të nenit 119 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se: “1. Rregulloret e Këshillit të Ministrave, të ministrave e të institucioneve të tjera qendrore, si dhe urdhrat e Kryeministrit, të ministrave e të drejtuesve të institucioneve qendrore kanë karakter të brendshëm dhe janë të detyrueshme vetëm për njësitë administrative që varen prej tyre. 2. Këto akte nxirren në bazë të ligjit dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për të marrë vendime në lidhje me individët dhe subjektet e tjera. 3. Rregulloret dhe urdhrat nxirren në bazë dhe për zbatim të akteve që kanë fuqi juridike të përgjithshme.”, nuk mund të shërbejë si bazë për të marrë vendimet për subjekte të tjerë që nuk bëjnë pjesë në njësinë administrative që varen prej tij, pra në rastin konkret personelin e ILDKPKI-së. Pra, urdhri ka karakter të brendshëm dhe nuk mund të përcaktojë rregulla sjellje të përgjithshme sikurse janë përcaktimi i rasteve që përbëjnë shkelje administrative, për

subjektet e deklarimit dhe personat e lidhur të tyre, parashikuar nga neni 3 i Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve finaciare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, përsa kohë që këto subjekte nuk bëjnë pjesë në njësine administrative që varen prej ILDKPKI-së. Prandaj, në kuadrin e përcaktimit të fuqisë juridike për të përcaktuar nëse një fakt do të përbëjë veprë penale apo kundërvajtje penale, në respektim të nenit 119 të Kushtetutës dhe në respektim të parimit të hierarkisë së akteve normative (parimi i shtetit të së drejtës),⁵⁸ Gjykata çmon se përsa i përket shkeljeve administrative duhet të marrë për bazë vetëm ato raste që parashikohen në mënyrë eksplicite në ligj dhe jo ato shkelje që mund të përcaktohen me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm, pasi me urdhër nuk mund të përcaktohen rregulla të përgjithshme sjellje, për rrjedhojë nuk mund t’i kundrejtohet subjekteve të deklarimit, por **mund të kundrejtohet vetëm personave që janë nën varësinë administrative të ILDKPKPI-së, pra personelit të saj.**

43.10.2. Gjithashtu, në rastin konkret, Gjykata çmon të evidentojë faktin se në zbatim të pikës 1 germa “d” të nenit 40 Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve finaciare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, ka dalë urdhri Nr. 27, datë 13.03.2014 i Inspektorit të Përgjithshëm të ILKPKI-së “Për përcaktimin e shkeljeve të tjera të Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve finaciare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 29, datë 13 Mars 2014. Në këtë urdhër parashikohet shprehimisht: **“URDHËROJ: Përcaktimin e shkeljeve të tjera të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve finaciare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, që konstatohen gjatë veprimtarisë kontrolluese të Inspektoratit të Lartë, të cilat do të sanksionohen sipas masës së parashikuar në pikën 1, germa “d”, të nenit 40 të këtij ligji, në rastet kur: 1. Deklarimi i pasurive, burimeve të krijimit të tyre dhe detyrimeve finaciare nga subjekti apo personi i lidhur me të, nuk bëhet sipas kërkesave të parashikuara në ligj: a) Zyrtari nuk ka plotësuar formularin e duhur të deklaratës së interesave privatë, sipas llojit të detyrimit për deklarim ose sipas modelit të formularit të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm dhe të botuar në Fletoren Zyrtare. b) Zyrtari, apo personat e lidhur me të, nuk kanë nënshkruar të gjitha fletët e formularit të deklaratës së interesave privatë ku janë pasqyruar të dhëna lidhur me objektin e deklarimit. c) Zyrtari nuk ka plotësuar autorizimin dhe nuk ka pasqyruar në deklarimin e tij të interesave privatë faktin nëse ka ose jo persona të tjerë të lidhur me të, sipas kërkesave të nenit 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar. d) Zyrtari deklaron të dhënat edhe për personat e lidhur, kur këto të fundit disponojnë pasuri të**

⁵⁸ Në vendimin Nr. 22, datë 24.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese ndër të tjera thuhet se: “Neni 4/3 i Kushtetutës parashikon se, dispozitat kushtetuese zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Sipas këtij parimi themelor kur rregulli kushtetues parashikohet shprehimisht, ai nuk mund të mënjanohet dhe as të tejkalohet, por duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti.” Neni 119 i Kushtetutës është një dispozitë që mund të zbatohet drejtpërdrejtë, pasi nuk i është deleguar Ligjvënësit për të përcaktuar se çfarë fuqie kanë urdhrat e institucioneve qendrore, por e ka përcaktuar vetë Kushtetuta qartësisht se çfarë fuqie juridike kanë.

regjistruar veçmas dhe për pasojë detyrohen ligjërisht të plotësojnë fletët përkatëse të këtij formulari. e) Zyrtari, apo personat e lidhur me të, nuk deklarojnë sipas kërkesave të formularit të interesave privatë vlerën e të ardhurave neto. f) Zyrtari nuk ka pasqyruar saktë vlerën e asetëve, të ardhurave apo të detyrimeve sipas monedhës përkatëse. g) Zyrtari, në deklarimin e interesave privatë periodikë vjetorë apo pas largimit nga funksioni, nuk pasqyron sipas kërkesave ligjore shtesa dhe ndryshime të gjendjes pasurore, por deklaroi gjendjen e tyre. 2. **Subjekti deklarues, apo personat e lidhur me të, nuk marrin masa për të rregulluar brenda afatit ligjor pasaktësitë e konstatuara gjatë përpunimit paraprak të deklaratës së interesave privatë, sipas kërkesave të parashikuara në nenin 24 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar.** 3. Subjekti deklarues, apo personat e lidhur me të, nuk paraqitet brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar, për të dhënë shpjegime mbi deklarimin e interesave privatë. 4. Subjekti deklarues apo personat e lidhur me të nuk depoziton dokumentet justifikues për pasuritë, detyrimet financiare dhe burimet e krijimit të tyre, gjatë kontrollit dhe hetimit administrativ. **Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.”**⁵⁹ Pra, edhe sikur të pranohet faktin se ky urdhër do të kishte fuqi të përgjithshme edhe pse nenin 119 i Kushtetutës e ndalon, përsëri shkeljet e evidentuara në këtë urdhër do t'i kundrejtoheshin subjekteve të deklarimit dhe personave të lidhur vetëm nga data 13 Mars 2014 e në vijim dhe nuk mund të ketë fuqi prapaveprues, pasi në të kundërt do të cenohet parimit i sigurisë juridike. Kështu, Gjykata Kushtetuese në jurispradencën e saj ka theksuar në fakt, ashtu si edhe në fushat e tjera të së drejtës, edhe në të drejtën penale parim i përgjithshëm është ai i ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit. Një gjë e tillë diktohet para së gjithash për shkak të domosdoshmërisë së garantimit të stabilitetit dhe të sigurisë së marrëdhënieve juridike që vendosen ndërmjet subjekteve të ndryshme të së drejtës. Në rastin e ligjit penal dhe administrativ, i cili si rregull kufizon lirinë individual dhe pasurinë, është mëse e nevojshme që çdo qytetar, të dijë paraprakisht kufijtë e lirisë së tij si dhe sanksionet që mund t'i vijnë për shkak të kapërcimit të këtyre kufijve. Ai nuk duhet të ndjejë për asnjë çast rrezikun që një ligj i ri dhe për më tepër një akt nënligjor (urdhër) që mund të parashikojë si të dënueshëm një veprim apo mosveprim të caktuar, do të ketë në të ardhmen fuqi prapavepruese. (**shiko vendimin Nr. 35, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese**). Pra, nga data 01.06.2003 që ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 31, datë 15.05.2003 deri më datë 26.10.2012 përbënte kundërvajtje administrative për subjektin e deklarimit vetëm mos dorëzimi i deklaratës brenda afatit ligjor dhe nga data 26.10.2012 deri më datë 13.03.2014 (gjithmon nëse pranojmë logjikën që urdhri i Inspektorit të Përgjithshëm do të ketë status të ndryshëm nga neni 119 i

⁵⁹Ky urdhër është shfuqizuar me urdhrin nr. 475, datë 11.05.2017 “Për përcaktimin e shkeljeve të tjera të Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar edhe me Ligjin Nr. 42/2017, datë 06.04.2017. Ky urdhër pothuajse ka të njëjtin parashikim si urdhri i vitit 2014.

Kushtetutës, duke përcaktuar rregulla të përgjithshme sjellje edhe pse është thjesht një urdhër që duhet të ketë fuqi vetëm për vartësit e tij) përbënte kundërvajtje administrative për subjektin e deklarimit refuzimi për të deklaruar, mos dorëzimi i deklaratës brenda afatit ligjor dhe moslëshim autorizimi, sipas nenit 10 të këtij ligji. Ndodhur në këto kushte, Gjykata vlerëson se pasaktësitë që lidhen dhe me mos plotësimin si duhet të deklaratës së pasurisë, ku përfshihen dhe rastet e mos deklarimit të plotë të pasurisë së ligjshme si dhe gabimet materiale apo pasaktësitë e ndryshme në lidhje me burimin e krijimit të pasurive, vlerën e aseteve në deklaratën e pasurisë nuk përbëjnë as kundërvajtje administrative, për rrjedhojë nuk kanë se si të përbëjnë vepër penale në formën e fshehjes dhe apo të deklarimit të rremë të pasurisë.

43.11. Duke u rikthyer në çështjen objekt gjykimit, Gjykata çmon se, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se e pandehura Etleda Çiftja ka burime të ligjshme për të justifikuar pasurit në pronësi të saj dhe të bashkëshortit, si subjekt deklarues të pasurive sipas Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar. Kjo për arsye si më poshtë vijon:

43.12. Së pari, gjatë gjykimit u provua se e pandehura Etleda Çiftja në zbatim të Ligjit Nr. 9049, datë 10.4.2003 “**PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË**”, i ndryshuar, më datën 17.07.2017 ka dorëzuar pranë Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave Deklaratën e Interesave Private Para Fillimit të Detyrës. Sipas nenit 5/1 të këtij Ligji të gjitha subjektet, që mbartin detyrimin për deklarim, sipas këtij ligji, duhet të deklarojnë para fillimit të punës deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, apo në bashkëpronësi me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur si dhe angazhimet në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, që ekzistojnë në **datën e fillimit të punës, përfshirë çdo lloj të ardhure të krijuar nga këto angazhime ose veprimtari, nga data 1 janar deri në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit.** Duke listuar pasuritë që janë objekt deklarimi, sipas përcaktimeve të mësipërme ligjore, ato rezultojnë si më poshtë: **a)** pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil; **b)** pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë, dhe të drejtat reale mbi to sipas Kodit Civil; **c)** sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 (treqindmijë) lekë; **ç)** vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim; **d)** vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj; **dh)** detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj; **e)** të ardhurat personale, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale nga data 1 janar deri në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit; **ë)** licencat dhe patentat që sjellin të ardhura; **f)** dhuratat dhe trajtimet

preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale. Nuk deklarohen dhurata ose trajtim preferencial kur vlera e tyre është më e vogël se 10 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi; **g)** angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, përfshirë çdo lloj të ardhure, të krijuar nga kjo veprimtari ose ky angazhim; **gj)** interesa privatë të subjektit, që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës; **h)** çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 300000 (treqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezulton se objekt i deklarimit në Deklaratën e Interesave Private Para Fillimit të Detyrës është deklarimi i pasurive që i përkasin subjektit deklarues në momentin e dorëzimit të kësaj (ex nunc) dhe jo të atyre pasurive që kanë ekzistuar më parë, por që nuk ekzistojnë ditën e dorëzimit të deklaratës. E njëjta situatë është dhe për deklarimin e detyrimeve.

43.12.1. Duke u rikthyer në rastin konkret, Gjykata çmon se në Deklaratën e Interesave Private Para Fillimit të Detyrës, e pandehura Etleda Çiftja ka deklaruar ndër të tjera pasuritë si më poshtë vijon: **i) Apartament** banimi me sipërfaqe 70.80 m², rruga "{***}", Tiranë. Kontratë shitje datë 30.11.2016 me vlerë **42 864 USD**. Vlera e paguar në bazë të kontratës së sipërmarrjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 08.09.2006. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga **paga**. Pronësia 50 %; **ii) Tokë arë me sipërfaqe 1450 m²** në adresë {***}, blerë më datë **10.07.2006**, në vlerën 300 000 lekë. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga **paga**. Pronësia 100%; **iii) Tokë arë me sipërfaqe 3440 m² me adresë {***}, Kavajë, blerë më datë 10.07.2006.** **Burimi i krijimit:** **Kredi nga Banka Amerikane** e Investimeve (*American Bank of Investment SA*) ish Banka Emporiki - Shqiperi sh.a. në shumën prej **35 000 euro** dhe të ardhura nga **paga 15 000 euro** si Drejtoreshë Ligjore pranë {***}. Pronësia 100%. Ndërkohë pasi është thirrur nga ILDKPKI me shkresën Nr. {***} Prot., datë 31.08.2017, me lëndë: "*Ftesë për t'u paraqitur në ILDKPKI për të dhënë shpjegime lidhur me deklarimin e interesave private*", e pandehura Etleda Çiftja në procesverbalin e datës **02.10.2017** "*Mbi shpjegimet e subjektit deklarues*" pranë ILDKPKI-së ka dhënë shpjegime duke cituar saktësisht burimet e pasurive të mësipërme sikurse ka rezultuar në përfundim të hetimit të bërë nga prokuroria, pra burim për krijimin e tokavë arë është dhurimi nga familjarët, ndërsa si burim për apartamentin në pronësi të saj ka shërbyer kredia e marrë pranë Emporiki Bank. Ndodhur në këto kushte, Gjykata çmon se prokuroria në respektim të neneve 24 dhe 27 të Ligjit Nr. 9049, datë 10.4.2003 "**PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË**", i ndryshuar, duhet ta kishte konsideruar të korrigjuar Deklaratën e Pasurisë Para Fillimit të Detyrës, **që prej datës 02.10.2017**. Si gjatë hetimit administrativë pranë ILDKPKI-së ashtu dhe gjatë hetimeve paraprake u provua vërtetësia e shpjegimeve të dhëna nga e pandehura Etleda Çiftja më datë 02.10.2017. Për këto arsye, Gjykata çmon se, prokuroria do të ishte në kushtet për të ngritur akuzë ndaj të pandehurës vetëm nëse në përfundim të hetimit do të provohej e kundërta e asaj që ka

shpjeguar e pandehura pranë ILDKPKI-së më datë 02.10.2017. Pra, në respektim korrekt të dispozitave të mësipërme, shpjegimet e të pandehurës për burimet e ligjshme janë pjesë përbërëse e Deklaratës së Pasurisë Para Fillimit të Detyrës. Ligji nuk njeh përpilimin e një deklarate të re, por ajo konsiderohet e korrigjuar me shpjegimet që japin subjektet deklarues në procesverbalin e mbajtur nga Inspektorët e ILDKPKI-së e që i bashkëlidhet deklaratës së pasurisë.

43.13. Së dyti, Gjykata çmon të sqarojë kuptimin e togëfjalëshit **“burimi i ligjshëm i krimit të pasurive”**, në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi. Për të përcaktuar se kush do të konsiderohet burim i ligjshëm i të ardhuravë në legjislacionin shqiptar, duhet t’i referohemi Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Në nenin 4 të këtij ligji nën titullin **“Burimi i të ardhurave”** parashikohet shprehimisht se: **“Të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë, pa u kufizuar vetëm në to, do të përfshijnë të ardhurat si vijon: a) Të ardhurat nga marrëdhënia e punës së ushtruar në Republikën e Shqipërisë; b) të ardhurat nga veprimtari kulturore apo sportive, si dhe nga veprimtari të tjera, personale në Republikën e Shqipërisë; c) të ardhurat nga veprimtaria e zhvilluar nga një person jorezident, nëpërmjet një personi me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë; d) të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi sendet e paluajtshme, që i përfiton një person me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë; dh) të ardhurat nga: i) pasuria e paluajtshme, aksesorët dhe frytet e tyre, si dhe të ardhurat që rrjedhin nga të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme që ndodhen në Republikën e Shqipërisë; ii) të drejtat për shfrytëzimin e pasurive minerale, të drejtat për shfrytëzimin e pasurive hidrokarbure ose të drejta të tjera për shfrytëzimin e burimeve natyrore tokësore dhe ujore, përfshirë detin në Republikën e Shqipërisë, si dhe informacionit që u përket këtyre të drejtave; Të drejtat dhe informacioni i përmendur në nënndarjet “i” dhe “ii”, më sipër, për qëllime të këtij ligji, trajtohen si pasuri e paluajtshme. e) të ardhurat nga tjetërsimi i: i) pasurisë, të drejtave dhe informacionit të përmendur në shkronjën “dh” të këtij neni; ii) aksioneve ose interesave të ngjashëm, të tillë si interesat në ortakëri ose truste, sipas përkufizimeve në legjislacionet përkatëse, kudo që ndodhen, në qoftë se, në çdo kohë gjatë 365 ditëve para tjetërsimit, këtyre aksioneve ose interesave të ngjashëm u buron më shumë se 50 përqind e vlerës direkt ose indirekt nga pasuria e paluajtshme, të drejtat ose informacioni, të përmendura në shkronjën “dh” të këtij neni. ë) të ardhurat nga dividendët e shpërndarë nga një person juridik, rezident; f) të ardhurat nga pjesët e fitimit, të paguar nga një ortakëri rezidente; g) të ardhurat nga interesat e paguar nga organet e qeverisjes qendrore apo vendore ose nga një rezident i Republikës së Shqipërisë, ose që paguhet nga një jo rezident, nëpërmjet një personi që ka seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë; gj) të ardhurat nga e drejta e autorit dhe pronësia intelektuale, qiraja dhe enfiiteoza; si dhe të ardhurat nga lojërat e fatit. h) të ardhurat e një personi jorezident, të përftuara si rezultat i shërbimeve të kryera për një person resident. i) të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen.”.** Parashikimi i rasteve të përshkruara në këtë nen, lehtësisht lexohet si një mënyrë për të përshkruar në terma të përgjithshëm e përshkrues çdo aktivitet ligjor të lejuar në territorin e vendit, i cili, i

normuar me rregulla të posaçme, do të konsiderohet si burim i krijimit të të ardhurave, të cilat do të jenë objekt i tatimit mbi të ardhurat personale. Përcaktimi i këtyre burimeve do të duhej të kuptohej si përcaktimi i aktiviteteve të ligjshme apo burimeve të ligjshme të cilat krijojnë të ardhura të ligjshme për subjektin e rivlerësimit. Në kuptim të dispozitave të mësipërme, subjekti deklarues duhet të provojë se si burim i krijimit të të ardhurave që do të konsiderohen të ligjshme duhet të jetë një nga marrëdhëniet e përshkruara në nenin 4 të ligjit nr. 8438/1998 ose ndonjë formë tjetër, e cila jo vetëm nuk është e ndaluar nga legjislacioni, por duhet njëkohësisht të ketë një parashikim ligjor për lejimin e atij lloj aktiviteti.

43.13.1. Mbështetur në analizën e mësipërme, arrihet në përfundimin se, të ardhurën e ligjëron burimi i krijimit. Një e ardhur nuk klasifikohet në sistemin financiar si e paligjshme, nëse mbi të nuk janë paguar taksa. Për më tepër, ligji tatimor shqiptar vendos detyrimin për tatimin e të ardhurave të jashtëligjshme. Detyrimi tatimor lind edhe kur personi realizon të ardhura, kryen pagesa, në formë të jashtëligjshme ose bëhet zotëruar i një sendi në forma të jashtëligjshme. Kur personi bëhet zotëruar i një sendi në forma të jashtëligjshme, ky detyrim përllorarit për të gjithë periudhën në të cilën personi ka gëzuar frytet e kesaj pasurie.⁶⁰ Nga ana tjetër, pagesa tatimore nuk e bën të ardhurën të ligjshme, ajo vazhdon të mbetet e paligjshme, sepse burimi i krijimit është i tillë. Për të përllorariten tatime, sepse sidoqoftë është e ardhur. Ka një sërë të ardhurash që janë të përjashtuara nga tatimi.⁶¹ Në këtë drejtim nuk do të kishte sens logjik e juridik

⁶⁰ Shiko nenin 6, pika 2, i Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nën titullin “Detyrimi tatimor”, ku parashikohet shprehimisht se: “1. Detyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kryen pagesa, të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit tatimor. 2. Detyrimi tatimor lind edhe kur personi realizon të ardhura, kryen pagesa, në formë të jashtëligjshme, apo bëhet zotëruar i një sendi, në forma të jashtëligjshme. Kur personi bëhet zotëruar i një sendi në forma të jashtëligjshme, ky detyrim përllorarit për të gjithë periudhën në të cilën personi ka gëzuar frytet e kesaj pasurie. 3. Detyrimi tatimor përshin tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjokat, për rastet e parashikuara nga ky ligj.”

⁶¹ Në nenin 8/1 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nën titullin “Të ardhura të përjashtuara”, parashikohet shprehimisht se: “Përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale: 1. Të ardhurat e përfituara si rezultat i sigurimit në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe ndihmat ekonomike për individët pa të ardhura ose me të ardhura të ulta, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi. 1/1. Të ardhurat nga pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të shtetasve të huaj me origjinë shqiptare apo të atyre nga vendet e Bashkimit Evropian, me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, si dhe të shtetasve të huaj që kanë marrë shtetësinë shqiptare e janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë dhe që i përfitojnë këto të ardhura sipas legjislacionit të vendit ku përfitojnë pensionin apo shpërblimet e tjera të ngjashme. Mënyra e përfitimit për kategoritë sipas kesaj pike përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. 2. Bursat e nxënësve dhe të studentëve. 3. Shpërblimet e marra në raste sëmundjesh, fatkeqesish, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës në fuqi. 4. Të ardhurat e përfituara, përshirë të ardhurat në formë monetare ose në natyrë, nga pronarët si shpërblim për shpronësimet që i bëhen nga shteti për interesa publike. 5* Shfuqizohet 6. Të ardhurat që përjashtohen në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë. 7. Të ardhurat e përfituara si rezultat i kompensimit financiar, për ish-pronarët dhe ish të dënuarit politikë.. 8. Kontributet e bëra nga punëdhënësi për sigurimin e jetës dhe të shëndetit të punëmarrësve. 9. Përfitimet për dëmshpërblime, të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave, si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore. 10. Të ardhurat e përfituara nga institucionet shtetërore për arritjet në shkencë, sport, kulturë. 11. Të ardhurat e realizuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore nga një fermer i regjistruar te një fermer tjetër apo një person fizik a juridik që kryen aktivitetet

nëse ligjshmëria e këtyre të ardhurave do të lidhej me pagesën faktike të tatimit. Pra, pagimi i taksave nuk ligjëron pasurinë/të ardhurën, sikurse mospagimi i taksave nuk e cilëson pasurinë/të ardhurën të paligjshme. **Ligjshmëria e pasurisë, përgjate gjithë legjislacionit fiskal të kontrollit të pasurive ose të pastrimit të parave, lidhet me burimin e krijimit dhe jo me pagesën tatimore mbi këto të ardhura.** Ndërkohë nëse provohet se pasuritë janë fituar nga burime të ligjshme, por subjekti deklarues nuk ka paguar detyrimet fiskale, atëherë veprohet sipas nenit 32 të Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, nën titullin “**Pasuritë e fituara nga fshehja e detyrimeve fiskale**”, ku parashikohet shprehimisht se: “*Kur pasuritë e fituara gjykohen se janë rrjedhojë e fshehjes së detyrimeve fiskale, Inspektori i Përgjithshëm njofton organet tatimore të cilët detyrohen të njoftojnë rast pas rasti Inspektoratin e Lartë për masat e marra.*”. Në këto raste veprohet sipas Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” i ndryshuar, ku subjektit të deklarimit pas kontrollit tatimor i bëhet njoftimi i vlerësimit tatimor. Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit.

43.13.2. Duke u rikthyer në rastin konkret, Gjykata çmon se burimet e krijimit të pasurive të të pandehurës Etleda Çiftja janë të ligjshme. Kjo për këto arsye: **së pari**, pasuria **tokë arë me sipërfaqe 1450 m²** në adresë {***} dhe pasuria **tokë arë me sipërfaqe 3440 m²** me adresë {***}, i është kaluar të pandehurës Etleda Çiftja nëpërmjet **veprimit juridik të mbuluar** që është **dhurimi**, pasi Kontrata e Shitjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006, si dhe Kontrata e Shitblerjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 10.07.2006, janë veprime juridike simuluese, për të gjitha arsyet që përmenden në paragrafët **37.4.3, 37.4.4, 37.4.5, 37.4.6, 37.4.7, 37.4.8 dhe 37.5.1** të këtij vendimi. Pra, burimi për krijimin e këtyre pasurisë është dhurimi dhe jo shitblerja. Kjo për shkak të marrëdhënie të posaçme të të pandehurës me familjarët e saj. Familjarët e të pandehurës e kanë fituar pronësinë mbi këto pasuri bazuar në Ligjin 7501 “Për tokën”, fakt i cili bën që mos të vihen në dyshim mënyra e fitimit të pronësisë. **Së dyti**, gjatë gjykimit u provua tej çdo dyshimi të arsyeshëm se si burim për krijimin e

bujqësor. Përfshihen, gjithashtu, rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë brenda lidhjes gjinore burrë, grua, fëmijë, nëpërmjet dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria, kur pasuria rrjedh nga bashkëpronësia e detyrueshme e fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, të ndryshuar. Këshilli i Ministrave përcakton kushtet dhe procedurën që garanton mosndryshimin e destinacionit të tokës së blerë.

11.1 Kalimi i së drejtës së pronësisë për banesën dhe/ose truallin, brenda lidhjes gjinore në familje, bashkëshort, bashkëshorte, fëmijë, vetëm një herë ndaj një përfituesi, nëpërmjet dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria. 12. Kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi të pensionit vullnetar deri në masën e përcaktuar në ligjin për fondet e pensionit vullnetar, si dhe kontributet e bëra nga punëdhënësi ose çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të fondit të pensionit vullnetar. 13. Kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e fondit të pensioneve, gjatë administrimit nga shoqëria administruese.”

pasurisë **Apartment** banimi me sipërfaqe 70.80 m², rruga "{***}", Tiranë, është kredia e marrë pranë Emporiki Bank, që sipas kuadrit ligjor konsiderohet burim i ligjshëm për krijimin e pasurive. Po ashtu, gjatë gjykimit u provua se kredia është paguar rregullisht duke i likuaduar përpara afatit të parashikuar në Kontratën e Kredisë.

43.14. Së treti, Gjykata çmon të theksojë se pasaktësitë në deklarin e pasurisë të pa shoqëruara me mungesë të burimeve të krijimit të pasurive, në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk passjellin as përgjegjësi disiplinore, për rrjedhojë nuk ka sens logjik e juridik të sjellë përgjegjësi penale.⁶² Kështu, në vendimin Nr. 37, datë 24.11.2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ndër të tjera arsyetohet se: *“10.12. Në përfundim të kësaj analize, Kolegji arriti në konkluzionin se pretendimi i Komisionerit Publik lidhur me faktin se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar shumën prej 18.000 eurosh në vitin 2004, nuk është i saktë. Pavarësisht deklarimeve jo të plota të subjektit në vitet 2003-2004 për pasurinë likuiditet, nga leximi dhe analiza logjike e deklarimeve të bëra prej tij qoftë në DPV-në e vitit 2004, qoftë në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, në çdo rast, subjekti justifikon me burime të ligjshme pasurinë e deklaruar prej tij edhe në version e pranuar prej Komisionerit Publik se ai zotëron me bashkëshorten të gjithë shumën. Në lidhje me këtë çështje, Kolegji nënvizon qëndrimin e tij të konsoliduar tashmë se pasaktësitë në deklarime periodike të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi...”*

44. Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale. Gjykata vlerëson se, vepra penale e “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë” parashikuar nga neni 257/a/1 i Kodit Penal kërkon si formë faji dashjen e drejtpërdrejtë. Pra, që të ketë përgjegjësi penale sipas dispozitës së mësipërme është e nevojshme që më parë ndaj subjektit të jetë marrë masë administrative dhe subjekti pavarësisht se ka dijeni për masën, vazhdon të mospërbushë detyrimet e tij të cilat pasjellin përgjegjësi penale për të. Element i rëndësishëm i përgjegjësisë penale është faji, pra qëndrimi subjektiv i subjektit aktiv për veprimet/mosveprimet e tij dhe pasojat e ardhura. Në mënyrë që ndaj subjektit të lindë përgjegjësia penale sipas dispozitës së mësipërme është e nevojshme që jo vetëm që ai më parë të jetë ndërrshkuar administrativisht, por edhe të ketë pasur dijeni për masën administrative. Vetëm nëse ai ka dijeni për masën administrative, ai konsiderohet se vepron me faj sepse ka dijeni për detyrimin dhe nuk e përbush atë.⁶³ Gjithashtu, Gjykata vlerëson se paragrafi i dytë i nenit 257/a/2 i Kodit Penal si një dispozitë blankete,

⁶²Shiko vendimin Nr. 37, datë 25.07.2013 të Gjykatës Kushtetuese, ku ndër të tjera arsyetohet se: *“32....Në vlerësimin e Gjykatës, kryerja e një vepre penale përbën formën më të rëndë të shkeljeve të ligjit..”*. Gjykata çmon të theksoj se një shkelje disiplinore dhe një kundërvajtje administrative përbëjnë rrezikshmëri shoqërore më të ulët se një kryerja e një vepre penale. Prandaj, kur një veprim ose mosveprim nuk ngrihet as në nivelin e një përgjegjësie disiplinore nuk ka sesi të passjelli përgjegjësi penale e cila përbën formën më të rëndë të shkeljes së ligjit.

⁶³ Shiko vendimin Nr. 631, datë 30.09.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

duke e interpretuar në mënyrë logjike dhe sistematike me Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve finaciare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, ka si qëllim fshehjen e pasurisë të cilat rrjedhin nga burime të paligjshme e të pajistifikuara, për shkak të veprimet të paligjshme duke abuzuar me detyrën apo sii rezultat i veprimeve korruptive, qëllim i cili nxirret nga veprimet konkrete rast pas rasti, si këmbim të pasurisë, transferim të saj, fshehje apo mbulim të natyrës së vërtetë të burimit, vendosjes, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave të tjera pasurore, fitim të pronësisë, posedim apo përdorim, që do të çonin në moslidhjen dot të pasurisë me pronarin e vërtetë të saj, duke e vendosur atë në emër të një personi tjetër, të ndryshëm nga rrethi i personave për të cilët i pandehuri është i detyruar që të deklarojë pasurinë. Subjekti në këtë rast ndërmerr veprime të caktuara, shoqërisht të rrezikshme, për t’i humbur gjurmët e pasurisë, apo duke e gëzuar atë, me ndërmjetësinë e personave të tretë. Të gjitha këto veprime të ndërmarra nga ana e një të pandehuri bëhen me një qëllim të mirëpërcaktuar, për t’u mos u evidentuar dhe deklaruar në ILDKPKI. Ndërkohë, deklaratimet e rreme në deklaratën e pasurisë duhet të bëhen nga subjekti i deklaratimit me qëllim futjen e pasurive të vëna në mënyrë të paligjshme në sistemin e rregullt fiskal dhe pasqyrimi në formularët e deklaratimit të interesave privat duke përdorur forma të ndryshme justifikimi. Pra, **Gjykata thekson se si fshehja e pasurisë ashtu dhe deklaratata e rreme e pasurisë bëhet me dashje për të fshehur pasuritë e padeklaruara dhe/ose për pasuritë e deklaruara të cilat janë fituara nga burime të paligjshme e të pajustificuara, sepse nuk ka sens logjik dhe juridik që bëhet deklaratë e rreme me dashje për pasuritë e deklaruara e që janë fituar në mënyrë të ligjshme nga burime të ligjshme e të justifikuara. Në këtë rast do të ishin përpara një deklaratë pasurie të paplotë dhe të parregullt që korrigohet në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji.**⁶⁴

44.1. Duke u rikthyer në rastin konkret, Gjykata çmon se e pandehura më datën 17.07.2017 ka dorëzuar pranë Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave Deklaratën e Interesave Private Para Fillimit të Detyrës. Në këtë deklaratë pasurie, e pandehura Etleda Çiftja ka deklaruar ndër të tjera pasuritë si më poshtë vijon: **i) Apartament** banimi me sipërfaqe 70.80 m², rruga “{***}”, Tiranë. Kontratë shitje datë 30.11.2016 me vlerë **42 864 USD**. Vlera e paguar në bazë të kontratës së sipërmarrjes me Nr. {***} Rep., dhe Nr. {***} Kol., datë 08.09.2006. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga **paga**. Pronësia 50 %; **ii) Tokë arë me sipërfaqe 1450 m²** në adresë {***}, blerë më datë **10.07.2006**, në vlerën 300 000 lekë. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga **paga**. Pronësia 100%; **iii) Tokë arë me sipërfaqe 3440 m² me adresë {***}**, Kavajë, blerë më datë **10.07.2006**. **Burimi i krijimit:** **Kredi nga Banka Amerikane** e Investimeve (*American Bank of Investment SA*) ish Banka Emporiki - Shqiperi sh.a. në shumën prej **35 000 euro** dhe të ardhura nga **paga 15 000**

⁶⁴ I njëjti qëndrim është mbajtur nga e njëjta gjykatë (trup gjykues) me vendimin Nr. 2551, datë 11.12.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe me vendimet Nr. 73, datë 12.10.2021; Nr. 17/96, datë 07.01.2022; Nr. 43, datë 16.02.2022 dhe Nr. 84, datë 29.06.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

euro si Drejtoreshë Ligjore pranë {***}. Pronësia 100%. Gjykata çmon se, nga provat e administruara rezulton se pandehura Etleda Çifta **ka bërë deklarin të pasaktë për burimin e krijimit të pasurisë.**

44.2. Gjatë gjykimit u provua se, pasuritë që përmenden në paragrafin e mësipërme rrjedhin nga burime të ligjshme e të justifikuara. Gjykata çmon se, **nuk konsiderohet deklarimi i rremë i pasurive kur kemi të bëjmë me gabime materiale, parregullsi ku futen dhe mosplotësimi i të gjitha rubrikave të deklaratës, duke lënë pasuri të ligjshme të padeklaruara apo plotësime të gabuara të deklaratës së pasurisë lidhur me burimin apo vlerën e pasurisë, për të cilat subjekti i deklarinimit thirret nga ILDKPKI-ja për t'i ndrequr ato. Gjithashtu, neni 28 i Ligjit Nr. 9049, datë 10.4.2003 ka përcaktuar qartësisht se ILDKPKI-ja bën kallëzim penal në prokurori vetëm atëherë kur konstatohet se pasuritë që subjekti i deklarinimit ka deklaruar apo që nuk ka deklaruar dhe që janë konstatuar gjatë hetimit administrativ janë krijuar në mënyrë të paligjshme, ku përsihen rastet e korrupsionit apo abuzimit me detyrën shtetërore. Ky qëllim i Ligjvënësit ka ekzistuar që me miratimit e Ligjit Nr. 7903, datë 08.03.1995 “Për deklarinimin e pasurive të zgjedhura dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik”, ku në nenin 9 të këtij ligji parashikohet se: “Organet e ngarkuara me gjykimin e kundërvajtjeve administrative sipas këtij ligji, krahas dënimit me gjobë vendosin edhe për pasurinë e fituar nga burime të paligjshme prej personave të përcaktuar në nenet 1 dhe 4 të këtij ligji. Kjo pasuri konfiskohet nga policia financiare dhe kalon në dobi të shtetit.”. Pra, nëse nuk provohet se pasuritë janë krijuar në mënyrë të paligjshme, ILDKPKI nuk mund të bëjë kallëzim penal, përse kohë ligji e ka përcaktuar qartësisht se kush është pasuri e paligjshme dhe kush konsiderohet parregullsi apo pasaktësi në plotësimin e deklaratës. Ndodhur në këto kushte, Gjykata çmon se në rastin konkret mungon ana subjektive e të pandehurës Etleda Çiftja për të bërë deklarinim të rremë.**

44.3. Gjykata çmon se, fakti objekt gjykimi nuk përbën vepr penale por përbën kundërvajtje administrative. Kështu, në nenin 40 të Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, nën titullin “**Kundërvajtjet administrative**”, parashikohet shprehimisht se: “1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, kur nuk përbën vepr penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas kufijve të përcaktuar më poshtë: ...; d) Për shkelje të tjera të këtij ligji, të përcaktuara me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm e të konstatuara gjatë veprimtarisë kontrolluese të Inspektoratit të Lartë, Inspektori i Përgjithshëm dënon personat përgjegjës me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë. 2. Të drejtën për vendosjen e masave administrative për rastet e shkeljeve të mësipërme e ka Inspektori i Përgjithshëm. 3. Procedurat për zbatimin e masave administrative dhe ankimin ndaj tyre rregullohen sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe dispozitave të ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. 4. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative të konstatuara gjatë kryerjes së inspektimeve të Inspektoratit të Lartë bëhet jo më vonë se 6 muaj pas

konstatimit të shkeljes.”. Në zbatim të pikës 1 germa “d” të nenit 40 të këtij Ligji, ka dalë Urdhri Nr. 475, datë 11.05.2017 i Inspektorit të Përgjithshëm të ILKPKI-së “Për përcaktimin e shkeljeve të tjera të Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve finaciare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar edhe me Ligjin Nr. 42/2017, datë 6.4.2017. Në këtë urdhër parashikohet shprehimisht: **“URDHËROJ: Përcaktimin e shkeljeve të tjera të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, që konstatohen gjatë veprimtarisë kontrolluese të Inspektoratit të Lartë, të cilat do të sanksionohen sipas masës së parashikuar në pikën 1, germa “d”, të nenit 40 të këtij ligji, në rastet kur: 1. Deklarimi i pasurive, burimeve të krijimit të tyre dhe detyrimeve financiare nga subjekti apo personi i lidhur me të, nuk bëhet sipas kërkesave të parashikuara në ligj:..... e) Subjekti deklarues, apo personat e lidhur me të, nuk kanë pasqyruar saktë vlerën e asetëve, të ardhurave apo të detyrimeve shë/ose sipas monedhës përkatëse.2. Subjekti deklarues, apo personat e lidhur me të, nuk paraqiten brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar për të dhënë shpjegime mbi deklarimin e interesave privatë. 3. Subjekti deklarues, apo personat e lidhur me të, nuk depozitojnë dokumentacionin justifikues për pasuritë, detyrimet financiare dhe burimet e krijimit të tyre, gjatë kontrollit dhe/ose hetimit administrativ....Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.”.** Në rastin konkret, e pandehura Etleda Çiftja nuk ka pasqyruar saktësisht burimin e krijimit të pasurive të paluajtshme në pronësi të saj në momentin e plotësimit të Deklaratës së Interesave Private Para Fillimit të Detyrës më datë 17.07.2017 pavarësisht se kjo është korrigjuar sipas ligjit më datë 02.10.2017 nëpërmjet shpjegimeve të dhëna më datë **02.10.2017**, ku është mbajtur procesverbali “Mbi shpjegimet e subjektit deklarues” midis të pandehurës Etleda Çiftja dhe shtetases V.K, me detyrë Inspektore në Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Bashkëlidhur këtij procesverbali është depozituar dokumentacioni ligjor që provon vërtetësinë e shpjegimeve të të pandehurës. Në përfundim të hetimit administrativ, ILDKPKI duke prezumuar të korrigjuar Deklaratën e Pasurisë Para Fillimit të Detyrës dhe duke i konsideruar të sakta shpjegimet e të pandehurës Etleda Çiftja nuk ka marrë masa administrative ndaj saj. Ky fakt konfirmohet me shkresën Nr. {***} Prot., datë 14.04.2022 të Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

45. Në lidhje me subjektin e veprës penale, në nenin 12 të Kodit Penal thuhet shprehimisht se: “Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç”. Kështu, personi fizik që të konsiderohet subjekt i figurës së veprës penale, dhe si rrjedhojë të plotësojë kushtin paraprak për fajin dhe përgjegjësinë penale, duhet të plotësojë dy kritere ekskluzive ligjore (*condicio sine qua non*): **i**) Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe **ii**) të jetë i përgjegjshëm. Kështu, neni 17 i Kodit Penal parashikon se: “Nuk ka përgjegjësi

penale personi që në kohën e kryerjes së veprës vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen veprë penale”. Ky kusht ka të bëjë me domosdoshmërinë për të proceduar penalisht vetëm personat e përgjegjshëm, që kanë të paktën një ndërgjegje minimale sa për t’i bërë ato të aftë të kuptojnë rëndësinë e veprimeve që kryejnë, në mënyrë që realisht të ekzistojë ana subjektive e autorit të veprës penale, që për organin procedues do të thotë të jetë i mundur të identifikohet forma e fajësisë. Megjithatë, që të përjashtohet nga përgjegjësia penale, për shkak të gjendjes mendore, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte. **Së pari:** personi të vuajë nga një turbullim psikik ose neuropsikik. **Së dyti:** ky turbullim të ketë prishur tërësisht ekuilibrin mendor të personit. **Së treti:** turbullimi të ketë ekzistuar në kohën e kryerjes së veprës. Ky kusht buron nga rregulli se përgjegjësia penale përcaktohet në momentin e kryerjes së veprës penale. Në rastin konkret, subjekt i kësaj vepre penale janë **subjektet që mbartin detyrimet për deklarimin sipas neneve 3, 3/1 dhe 9** të Ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar. E pandehura Etleda Çiftja i plotëson kushtet formale për të qenë subjekt i kësaj vepre penale, pavarësisht se në rastin konkret, nuk plotësohen tre kushtet e tjera të figurës së veprës penale, objekti, ana objektive dhe ana subjektive.

46. Sa më sipër u arsyetua, Gjykata bazuar në nenin 388 pika 1, gërma “b” të K.Pr.Penale çmon se e pandehura **Etleda Çiftja** duhet deklaruar e pafajshme për figurën e veprës penale “*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë*” parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, pasi fakti nuk përbën veprë penale.

2. Lidhur me shpenzimet procedurale.

47. Në bazë dhe për zbatim të nenit 393 paragrafi 1 dhe 485 të Kodit të Procedurës Penale shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 112, 190, 332/dh pika 1, gërma “b”, 379 pika 2, 380, 388 pika 1 gërma “b”, 403, 405 dhe 406 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe neneve 186/1 dhe 257/a/2 të Ligjit Nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurës **Etleda Rustem Çiftja**, për kryerjen e veprës penale “*Falsifikim i dokumenteve*” parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, pasi fakti nuk përbën veprë penale.
2. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurës **Etleda Rustem Çiftja**, për kryerjen e veprës penale “*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë*” parashikuar

nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, pasi fakti nuk përbën veprë penale.

3. Në aplikim të nenit 190 të K.Pr.Penale provat materiale të sekuestruara dhe të përshkruara në Urdhrin e datës 21.06.2022 “Për bashkimin e provave materiale me fashikullin e gjykimit” të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, t’i kthehen noteres L.K; ASHK, Tirana Veri, Arkiva vendore; ASHK, Dega Kavajë dhe Bankës Amerikane të Investimeve.
4. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda **15 (pesëmbëdhjetë) ditëve**, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall sot në Tiranë, më datë 16.09.2022

SEKRETARE
ENKELEDA LUGA

GJYQ TAR
ERJON BANI